	<input type="radio"/> auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi tri zgjidhjet e para do t'i eliminojë menjëherë si të pasakta. Nga përgjigjia me mundësi të shumta të zgjedhjes nuk do të mbetet asgjë. Ndërtimi dhe formulimi nuk guxon t'ia lehtësojë nxënësit zgjidhjen.

Das Auto	<input type="radio"/> steht unter der Straßen.
	<input type="radio"/> stehen über der Straßen.
	<input type="radio"/> steht auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi do të mund të zgjedhë mundësinë e tretë shumë shpejtë si të vetmën të saktë, sepse vetëm tek kjo mundësi kallëzuesi në njëjës përputhet me kundrinën e cila gjithashtu qëndron në njëjës.

## 1.2. Përgjigjet rregulluese

Karakteristikë e përgjigjeve rregulluese është se nxënësi duhet të rregullojë një sistem të dhënë. Këtu ekzistojnë dy mundësi :

- Klasifikim
- Rradhitje

- **përgjigjet klasifikuese**

Nxënësit i jipen dy grupe fjalësh apo fjalishë. Ata kanë për detyrë që një pjese të grupit të parë t'i shtohet pjesa përkatëse e grupit të dytë.

**Shembull** : Klasifiko.

1. Peter 2. Armend 3. Giuseppe	a) Griechenland b) Deutschland c) Spanien d) Kosova e) Türkei f) Italien
--------------------------------------	---

**Shembull:** Çka përshtatet? Klasifiko.

1. die Schule 2. der Spielplatz 3. die Fabrik	a) der Lehrer b) die Arbeit c) die Rutsche	d) das Geld e) die Maschine f) das Tor	g) der Sandkasten h) der Schüler i) der Meister
--	---	---	---

Përgjigjet klasifikuese kanë përparësinë, sepse mësuesi mundet shumë mirë të vërtetojë, se a e ka kuptuar nxënësi logjikisht një problem.

- **përgjigjet rradhitëse**

Detyrë e nxënësve është që t'i vëjë në rradhë të duhur fjalitë, shkronjat dhe fjalët.

**Shembull:**

Vëri fjalitë në rradhën e duhur.

1. Es ist acht Uhr. 2. Liridon geht bei Rot über die Kreuzung. 3. Der Wecker klingelt. 4. Liridon kommt zu spät zur Schule. 5. Liridon hat verschlafen. 6. Der Autofahrer bremst scharf. 7. Er springt aus dem Bett. 8. Der Fahrer schimpft Liridon. 9. Er läuft schnell Weiter.
--

Zgjidhjen e drejtë të kësaj detyre mund ta lehtësojë një rradhë fotografishë.

**Shembull:** rradhiti shkronjat.

schueRt	
hrreeL	
Seluch	
mbsret	

Edhe tek ky shembull mund të paraqiten fotografi për lehtësimin e gjetjes së zgjidhjes.

**Shembull:** Rradhiti shkronjat drejtë.

Der	bremst	Autofahrer	Scharf
a	B	c	D

**Shembull:**

Rradhiti shkronjat drejtë në kutitë e rendit të parë.

Shkruaj shkronjën e fjalës joadekuate në kuti.

a) Der b) bremst c) Autofahrer d) groß e) scharf


Në këtë shembull shihet problematika. Si të bëhët vlersimi nëse dy nxënës vijnë me këto zgjidhje:

Nxënësi 1: *Der Autofahrer scharf bremst.*

Nxënësi 2: *Der Autofahrer bremst groß.*

Asnjëra nga dy zgjidhjet nuk është e saktë. Përderisa tek nxënësi 1. renditja e fjalëve është gabim nxënësi 2. ka zgjedhur ndajfoljen e gabuar. A nuk merr asnjëri nxënës pikë? Apo, a mund të thuhet se njëra nga të dy zgjidhjet është “më e saktë” kurse tjetra “më pak e pasaktë”?

Nëse mësuesi dëshiron të testojë renditjen e drejtë të fjalëve në fjali: A mundet atëherë nxënësi 2 ta marrë njerën nga dy pikët e mundshme?

### 1.3. Përgjigjet e lira

Përgjigjja e lirë karakterizohet përmes asaj, që nxënësi duhet të reagojë në detyrën e dhënë të mësuesit, pa pasur mundësi zgjedhjeje.

- **Përgjigjet plotësuese**

Përgjigjet plotësuese, të ashtuquajtura gjithashtu përgjigje ë shkurtëra, praktikohen shpesh në shkollë.

**Shembuj:**

Viele Dinge sind schneller, schöner usë. als andere. Setze die richtige Form ein.

(langsam)	Ein Fahrrad ist ... als ein Auto.
(schöer)	Fünf Kilo sind ... als ein Kilo.
(teuer)	Fleisch ist ... als Brot.

Trage das Gegenteil in die Lücke ein.

Dieses Buch ist spannend. Es ist nicht ...  
Elona ist groß. Sie ist nicht ...  
Latra ist ein Mädchen. Sie ist kein ...

Setze die richtige Zeit in die Lücke ein.

Heute Nachmittag ... (gehen) ich auf den Spielplatz.  
Morgen ... (spielen) ich Tennis.  
Gestern ... (sein) ich im Kino.

- **Përgjigjet e shkurtëra hartuese**

Ky nocion mund të sjellë keqkuptime. Më këtë janë menduar përgjigjet e nxënësve sipas udhëzimit të mësuesit, të cilat paraprakisht nuk mund të vlerësohen qartë si të sakta apo të pasakta.

**Shemull:**

Formo një fjali prej këtyre dy fjalive.

Elira weint. Eine Wespe hat sie gestochen.  
\_\_\_\_\_

Te ky shembull nuk shfaqen probleme të mëdha gjatë vlerësimit. Më vështirë është të tregimet me fotografi, të cilat gjithashtu numërohen si përgjigje të shkurtëra hartuese. Për të gjithë nxënësit detyra është e njëjtë, sepse të gjithë i kanë në dispozicion fotografitë e njëjta. Megjithatë nuk mund të vlerësohet vetëm numri i informacioneve, sepse kriteret tjera luajnë një rol të rëndësishëm, psh. radhitja, zgjedhja e fjalëve, lidhjet, etj. Këto e vështirësojnë një vlerësim objektiv.

## Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

### LITERATURA

1. **Beste Freunde**, Stufe A 1.2 (gjysma e parë e nivelit A1/2; leksionet 10-14, Kursbuch und Arbeitsbuch, Hueber, Ismaning).



# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## Gjuhë frënge

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Gjuha frënge, si gjuhë e huaj e dytë, vazhdon të mësohet në klasën e 8 të Shkollës së Mesme të Ulët, me të njejtin status, zakonisht me të njejtin mësimdhënës, me të njejtën metodë për mësimin e saj dhe, kryesisht, në të njejtat kushte dhe rrethana të punës me ato në klasën paraprake, por tani me nxënës jofillestarë. Ata tashmë janë më të rritur, me kapacitete të rritura intelektuale, me një përvojë edhe në mësimin e një gjuhe të huaj të dytë dhe kanë përvetësuar një fjalor fillestar të gjuhës frënge i cili do të zgjerohet dhe pasurohet në mënyrë progresive. Fjalori paraprak i nxënësve në këtë gjuhë të huaj, me kohë, do të pasurohet gradualisht edhe me një qasje ndërdisiplinare të mësimdhënies së kësaj lënde me lëndët e tjera mësimore. Ky synim mbështetet në krijimin e një atmosfere pozitive dhe garuese gjatë orës së mësimin dhe në identifikimin e mënyrave dhe strategjive të të mësuarit. Ajo do t'u shërbejë jo vetëm si mundësi komunikimi në këtë gjuhë të huaj në botë, por edhe si mundësi ndërtimi e karrierës, e punësimit, e studimeve, etj. Nxënësit e kësaj klase do të përvetësojnë një fjalor më të zgjeruar të kësaj gjuhe të huaj, të domosdoshëm për komunikim; do të avancojnë më tutje shkathtësitë kryesore gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe do të zhvillojnë kapacitetet intelektuale të tyre në këtë fushë.

## Qëllimet

Mësimi i gjuhës frënge në klasën e 8 kërkon arritjen e njohurive gjuhësore sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (1/4 e nivelit A1), të përcaktuara në bazë të numrit të orëve mësimore në javë, të cilat janë të matshme nga institucione përkatëse të kësaj fushe, që përfshijnë përvetësimin e një fjalori më të zgjeruar të gjuhës frënge nga nxënësit dhe përdorimin elementar të tij për nevoja personale; njohjen dhe dallimin e formave të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë); përforcimin e mëtejme të shkathtësive gjuhësore receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe shkathtësive produktive (të folurit dhe të shkruarit); rritjen e kapaciteteve intelektuale të tyre; konsolidimin dhe integrimin e njohurive; formimin e të menduarit kritik dhe krijues; njohje e mëtejme të një kulture të re, formimin e gjykimit të drejtë për botën; formimin e një personaliteti tolerues, respektues, bashkëpunues dhe human dhe formimin e një qytetari të dobishëm dhe të përgjegjshëm për shoqërinë.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

1 orë në javë, 37 orë në vit

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Tekste letrare dhe joletrare  Pjesët skenike, teatri, dramatizimi, etj  Sistemi i gjuhës	Profesionet	<p><b>TË DËGJUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton fjali të thjeshta kur flitet për profesione.</li> <li>• Arrin të kuptojë tema të thjeshta rreth rrobave dhe stileve të të veshurit.</li> <li>• Kupton udhëzime rreth orientimit nese flitet ngadal dhe rrjedhësëm.</li> </ul>
	Shijet dhe preferencat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton biseda të thjeshta kur flitet për shije dhe preference.</li> <li>• Kupton informata të thjeshta reth motit dhe stinëve.</li> </ul>
	Veshëmbathjet	<p><b>TË FOLURIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Formon fjali të thjeshta për të trguar profesione.</li> <li>• Përshkruan mënyrën e vet të veshjes dhe të tjerëve.</li> <li>• Flet për shijet dhe preferencat duke formuar fjali të thjeshta dhe të izoluara.</li> </ul>
	Përshkrimi i një personi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyet dhe përgjigjet në pyetje për një adresë, nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë dhe qartë.</li> <li>• Flet për pushimet (vendi, përshtypjet, aktivitetet, moti, etj.)</li> </ul>
	Moti dhe stinet	<p><b>TË LEXUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton një tekst të thjeshtë ku flitet për profesione.</li> <li>• Kupton tekste të thjeshta rreth rrobave dhe stileve të të veshurit</li> <li>• Kupton fletushka informuese rreth aktiviteteve të lira.</li> <li>• Kupton udhëzime për gjetjen e një adrese me kusht që fjalitë janë të thjeshtë.</li> </ul>
Orientimi në hapësirë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton ilustrime me të dhëna bazike për motin</li> </ul> <p><b>TË SHKRUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkruan të dhëna rreth profesinit kryesore.</li> <li>• Përshkruan një itinerar.</li> <li>• Shkruan një letër duke ftuar të tjeret dhe duke propozuar aktivitete.</li> <li>• Di të përshkruajë veshëmbathjen e vet.</li> </ul>	

## Udhëzime metodologjike

Procesi i mësimdhënies për fushën Gjuhët dhe Komunikimi duhet të bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve, në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetit të tyre. Nxënësit e kësaj klase që mësojnë gjuhën frënge duhet të arrijnë kompetencat e tyre nëpërmjet mësimit dhe qasjes së integruar. Suksesi i tyre arrihet përmes rezultateve të fushës kurrikulare. Metodot, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë çelës kryesor për arritjen e këtyre kompetencave. Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare si: edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, formën dhe strategjinë e duhur.

### Parimet didaktike-metodike

Të mësosh frëngjishten si gjuhë e huaj do të thotë të përvetësosh njohuri të caktuara dhe të jesh në gjendje t'i përdorësh në situata të jetës reale. Për këtë qëllim duhet ndjekur dy parime kryesore: 1) përqendrimi në komunikim dhe jo si deri më tani përqendrim në gjuhë; 2) përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij. Përvetësimi i shkathtësive gjuhësore zë vend parësor në mësimin e gjuhëve të huaja.

### Forma komunikative e mësimdhënies

Mësimdhënia më e mirë e kësaj gjuhe të huaj të gjallë bëhet në formë komunikuese, prandaj komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Kjo formë e mësimdhënies ua mundëson nxënësve arritjen e mjeteve gjuhësore që u nevojiten për t'u shprehur në klasë, kurse më vonë edhe në situata të caktuara të jetës së përditshme. Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja e një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

### Metodat e mësimdhënies

Për mësimin e gjuhës frënge mësimdhënësi duhet të përdorë metoda bashkëkohore sepse vetëm ato nxisin komunikimin e drejtpërdrejtë në këtë gjuhë dhe jo metodën tradicionale (megjithëse ajo mund të mbetet si një metodë ndihmëse në një fazë të parë të mësimit të saj). Puna në grupe ose në qifte, dialogjet e shkurtra, lojërat në role, tekstet e shkurtra, materialet pamore dhe format e punës që nxisin punën e pavarur, kreativitetin dhe frymën garuese të nxënësve në klasë, po ashtu, janë shumë të rëndësishme. Duhet përdorur metodologji të punës që nxitin aktivitetet prodhuese të nxënësve.

### Renditja e veprimeve

Për një mësim të efektshëm të frëngjishtes si gjuhë e huaj e dytë është e nevojshme të respektohet kjo renditje e shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit dhe të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit. Puna aktive dhe konkrete: mësimdhënësit duhet të kenë parasysh

kushtet dhe rrethanat e punës (si një mes jofrankofon) që dallohen shumë nga ato të Francës ose të një vendi tjetër frankofon. Ushtrimet duhet të zënë vend meritore, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

#### Korrigjimi i gabimeve të nxënësve

Mënyrat e korrigjimit të gabimeve të nxënësve diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërtshënës në rrethin e mësimitshënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimitshënësies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërsa disa prej tyre mendojnë që ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përseriten, të tjerët mendojnë që ato nuk duhet të korrigjohen me çdo kusht. Sido që të jetë, nxënësit nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra.

#### Mësimdhënia / nxënia e diferencuar

Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake nga gjuha frënge dhe aftësive psikofizike dhe intelektuale të tyre, prandaj mësimdhënësit duhet të organizojnë orën mësimore mbi këtë bazë. Kjo nënkupton që nxënësit që kanë aftësi për nxënie më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

#### Teknikat e punës

Një ndër detyrat e mësimitshënësies në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të përgatiten dhe të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënësies së gjuhës frënge dhe të organizojnë procesin e të mësuarit të saj në grup, zakonisht arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore dhe të vazhdojnë proceset e mësimin të gjuhës.

#### Përdorimi i mediave

Kompjuteri dhe interneti përbëjnë një mjet shumë të dobishëm dhe të përhershëm që duhet shfrytëzuar si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge të ne, programet e filmit dhe ato të dramës dhe emisionet e ndryshme televizive të jashtme në gjuhën frënge janë një mjet i fuqishëm që do të ndihmojë dhe përshpejtojë përvetësimin e saj nga nxënësit tanë.

Filmi, teatri, muzika, po ashtu, përbëjnë mjete të rëndësishme motivuese për arritjen e rezultateve më të mira në përvetësimin e gjuhës frënge. Fotografitë ndihmojnë sajimin e teksteve kreative dhe përshkruese. Ato tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan fotografia. Videoprojektori rrit interesimin e nxënësve për mësimin e saj. Kjo arrihet me: prezentimin e fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara dhe të teksteve përmes folive dhe projektorit. Materiali auditiv mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit e nxënësve përmes dëgjimit. Videomateriali u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë. Shfaqja e

një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose përralle nxit krahasimin me tregimin ose me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Mësimi i një gjuhe të huaj ofron mundësi të shumta për lidhje ndërlëndore dhe ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje do të përfshijnë sidomos ato të gjuhëve (gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj të parë dhe gjuhës së huaj të dytë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, në njërën anë, përmes njohurive nga lëndët e tjera, nxënësit do të ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata do të zgjerojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët e tjera. Përbajtjet e çështjeve ndërkurrikulare dalin nga temat lidhur me paqen, të drejtat e njeriut, zhvillimin e mediave, barazinë gjinore, shkathtësitë për jetë, kujdesin ndaj mjedisit, shëndetin dhe mirëqenien etj. Çështjet ndërkurrikulare mund të realizohen nëpërmjet projekteve të natyrave të ndryshme, debateve për tema të caktuara, diskutimeve, hulumtimeve lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, vizitave të institucioneve shëndetësore, etj. Kjo do të arrihet përmes një çasjeje të integruar të mësimdhënies së gjuhës frënge me çështje, aspekte dhe fusha të ndryshme të lëndëve të ndryshme. Kjo çasje e bën më të lehtë dhe më të shpejtë përvetësimin e njohurive nga kjo gjuhë dhe njëkohësisht ato integrohen mes vete dhe bëhen shumë më të qëndrueshme. Prandaj, gjatë përgatitjes së planit vjetor caktohen temat mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore. Për të ndihmuar këtë kërkohet që planet vjetore të kenë formatin e njëjtë në të cilin shënohet korrelacioni i cili do të ndihmojë funksionimin e lidhjes ndërmjet fushave dhe lëndëve.

## **Udhëzime për vlerësim**

Për fushën Gjuhët dhe Komunikimi vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimnxënies. Vlerësimi i rezultateve të arritura të nxënësve në mësimin e gjuhës frënge u siguron nxënësve informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së kompetencave. Vlerësimi duhet të përqëndrohet në njohjen e fjalorit të gjuhës frënge, në të kuptuarit e tij në një kontekst të caktuar dhe në përdorimin e tij në komunikimin e përditshëm, duke zbatuar njohuritë e tyre nga fonetika, gramatika dhe përvojën e tyre paraprake në komunikimin në gjuhën angleze. Gjatë të shprehurit gojor dhe shkrimor vlerësohet përvetësimi i drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit. Natyrisht, për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive gjuhësore të nxënësve duhet të mbështetemi në qëllimin e

vlerësimit, në informatat cilësore për vlerësim, në vlerësim të balancuar, në shkallën e saktë të arritshmërisë së nxënësve dhe në përdorimin e instrumente adekuate për vlerësim (vrojtimi, pyetësi, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, testi i bazuar në kriteret dhe objektiva dhe testi i arritshmërisë sipas kërkesave).

*Llojet e vlerësimeve:* ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit të njohurive të nxënësve si: vlerësimi diagnostik (identifikimi i aftësive dhe vështirësive të nxënësve në mësim); vlerësimi i jashtëm (vlerësim nëse njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi të kalojë në klasën e radhës); vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë); vlerësimi parashikues (parashikim i dështimeve dhe sukseseve potenciale të nxënësve); vlerësimi përfundimtar (përparimi i nxënësve dhe rezultatet e arritura në mësim); vlerësimi selektiv (vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe problemeve të tyre në mësim); vlerësimi somativ (mundëson vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara nga nxënësi në fund të një viti shkollor, klasifikimin e nxënësve dhe konstatimin nëse nxënësi i ka arritur kompetencat për të kaluar në klasën vijuese); vlerësimi formativ (konsiston në vlerësime interaktive që tregojnë të arriturat dhe progresin ose mangësitë e nxënësve gjatë të nxënësve).

*Çfarë duhet të vlerësohet?* Të kontrollohen njohuritë e fituara; përparimi i nxënësve; shkalla e zhvillimit të nxënësve; shkalla e zotërimit të gjuhës frënge; shkalla e integritetit të njohurive të fituara; aktivitetet jashtëshkollore.

*Mënyrat e vlerësimit:* kontrolli i vazhdueshëm; vlerësimi i drejtpërdrejtë (me tabelë); vlerësimi i tërthortë (me test); vlerësimi objektiv (me tabelë); vlerësimi subjektiv (pa tabelë); vlerësimi nga nxënësit (vlerësimi i njëri-tjetrit); vlerësimi në grupe nxënësish brenda klase (me tabelë); vetëvlerësimi i nxënësve (secili nxënësi vlerëson vetveten).

*Kriteret e vlerësimit:* aktivitetet e të shprehurit; të shprehurit gojor; të shprehurit me shkrim; aktivitetet e receptimit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim); aktivitetet e riprodhimit (të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Notat numerike jepen sipas shkallësive gjuhësore: të dëgjuarit; të folurit; të lexuarit; të shkruarit (5, 4, 3, 2, 1).

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për arritjen e rezultateve të nxënësve të klasës së 8 në gjuhën frënge, në rend të parë është i rëndësishëm përdorimi i literaturës didaktiko-metodike të kësaj gjuhe të huaj (në gjuhën shqipe dhe frënge), i materialeve të pasura didaktike nga burime (linqe) të ndryshme përmes internetit për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe për arritjen e suksesshme të rezultateve për lëndë, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve. Metoda franceze për mësimin bashkëkohor të gjuhës frënge, "Merci" (pjesa e tretë nga 4 pjesët e

barabarta të saj), e lejuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë për përdorim në ShMU të Republikës së Kosovës, bashkë me pjesët përbërëse të saj, përbën mjetin kryesor të punës dhe burimin kryesor të informatave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por jo edhe të vetmin mjet dhe burim që mësimdhënësi i i kësaj gjuhe të huaj dhe nxënësit e tij mund dhe duhet të përdorin. Ata kanë në dispozicion mundësi shumta për sigurimin e mjeteve mësimore të pasura nga burime të ndryshme për marrjen e informacionit, me kusht që ato të përzgjedhen me kujdes, varësisht nga njësia mësimore, qëllimi i saj, moshën e nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre dhe të përdoren në mënyrë të përshtatshme për nxënës.



# **FUSHA KURRIKULARE: ARTET**

**Kurrikulat lëndore/programet mësimore**

Art figurativ

Art muzikor

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## Art figurativ

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Lënda Art figurativ për klasën e tetë është një nga lëndët e rëndësishme brenda fushës kurrikulare Artet, e cila së bashku me lëndët e tjera të kësaj fushe ka një ndikim dhe rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve dhe kultivon kulturën artistike, intelektuale, shpirtërore dhe emocionale tek ata.

Përmes artit zhvillohen vlerat shoqërore dhe formimi i personalitetit dhe identitetit personal e kulturor, duke kontribuar në arritjen e kompetencave e të nxënit të Kurrikulës Bërthamë.

Lënda Art figurativ në klasën e tetë fokusohet në zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të njohurive dhe shkathtësive të artit dhe përdorimin e tyre në krijimtari artistike duke zhvilluar kreativitetin, imagjinatën, mendimin kritik dhe shijen estetike.

Arti figurativ iu jep mundësi shprehëse dhe komunikuese nxënësve për të pasqyruar idetë dhe qëndrimet e tyre përmes veprave artistike.

Lënda e artit synon të vë në pah rolin dhe rëndësinë e artit për shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe zhvillimin e shkathtësive krijuese dhe talentit artistik të nxënësve me prirje artistike si një mundësi për studime të mëtutjeshme në krijimin e individualitetit të tyre artistik e profesional.

## Qëllimi

Lënda e artit figurativ për klasën e tetë, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas tematikave, ka si qëllim:

- Zgjerimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve në art figurativ;
- Zhvillimin dhe formimin estetik, artistik, personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve;
- Njohjen e rolit dhe rëndësisë së artit për individin dhe shoqërinë;
- Zhvillimin e shkathtësive kreative e artistike për të komunikuar ndjenjat, idetë dhe mendimet përmes punimeve artistike;
- Shkathtësinë e përdorimit të elementeve dhe parimeve të artit në punime artistike;
- Njohjen dhe përzgjedhjen e materialeve, teknikave dhe mjete të ndryshme artistike dhe përdorimi i tyre në vepra arti;
- Kultivimin e shijes dhe përjetimit estetik të veprave të artit;
- Zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive për të vlerësuar dhe analizuar vepra arti;
- Zhvillimin e aftësisë për të identifikuar veprat e artit nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepteti	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
<b>KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE</b>	<b>Krijimi i punimeve</b>  <i>Vizatimi,</i>  <i>Piktura,</i>  <i>Grafika,</i>  <i>Dizajni Grafik,</i>  <i>Modelimi,</i>  <i>Konstruksioni</i>  <i>Instalacione</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizon punime dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika dhe medime të ndryshme të artit</li> <li>• Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit</li> <li>• Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike</li> <li>• Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin, etj);</li> <li>• Realizonë piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe kollazhit</li> <li>• Realizon punime në teknikat e grafikës duke mësuar veqoritë dalluese të saj.</li> <li>• Realizon punime në teknikën e dizajnit;</li> <li>• Modelon vepra skulpturale në relief dhe skulpturë tridimensionale duke përdorur forma të ndryshme</li> <li>• Përzgjedhë dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme</li> <li>• Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale.</li> <li>• Manipulon me imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike.</li> <li>• Realizon punime nga arti aplikativ duke bërë dallimin nga arti figurativ</li> <li>• Realizon punime të ndryshme në dizajn të produkteve të ndryshme</li> <li>• Përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë</li> </ul>
<b>GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK</b>	<b>Elementet figurative</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh, përshkruan dhe përdor elementet dhe parimet e gjuhës figurative</li> <li>• Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të</li> </ul>

	<p>vija, ngjyra, toni, forma vëllimi madhësia, tekstura, kahja, dhe hapësira.</p> <p><b>Parimet e artit</b></p> <p>kontrasti, ritmi, harmonia, baraspesha, gradacioni, proporcioni, bashkësia dhe</p>	<p>vijave për të realizuar punime artistike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike</li> <li>• Identifikon dhe përdor llojet e ndryshme të toneve në vepra artistike</li> <li>• Dallon lloje të ndryshme të formave dhe realizon punimi duke përdorur elementin e formës</li> <li>• Shpjegon rëndësinë e dritë hijes dhe aplikon atë në vepra të artit;</li> <li>• Dallon dhe aplikon vëllimin në vepra dy dhe tri dimensionale</li> <li>• Përdor lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksturë</li> <li>• Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës duke përdorur parimin e perspektivës për të arritur iluzionin e hapësirës në punime artistike.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikojnë rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti</li> <li>• Analizojnë ritmin në punime të ndryshme të artistëve të njohur dhe aplikojnë lloje të ndryshme të ritmit në punët e tyre</li> <li>•</li> <li>• Identifikon llojet e ndryshme të harmonive duke realizuar një punim me parimin e harmonisë</li> <li>• Identifikon llojet e ndryshme të barazpeshave dhe përdor ato në vepra artistike;</li> <li>• Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike</li> <li>• Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e sakt të raportit në mes të formave të</li> </ul>
--	---	---

	kompozimi.	<p>ndryshme</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon lloje të ndryshme të sipërfaqeve dhe aplikon ato në punime artistike</li> <li>• Përdorin lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike</li> <li>• Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike</li> </ul>
<b>RELACIONI ART – SHOQËRI</b>	<p><b>Ekspozita dhe aktivitete kulturore</b></p> <p><b>Vizita dhe ngjarje artistike</b> Vizita në Galeri, muzeume, objekte të trashëgimisë kulturore, atele (studio) të artistëve, qendra kulturore etj.</p> <p><b>Periudha historike:</b> Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore</p> <p>Impresionizmi Postimpresionizmi Fovizmi Ekspresionizmi Kubizmi Futurizmi Abstraksionizmi Dadaizmi Surrealizmi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë, Galeri e komunitet;</li> <li>• Viziton atele dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionist</li> <li>• Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në fqae të ndryshme etj</li> <li>• Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha;</li> <li>• Njih disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike</li> <li>• Identifikon dhe njih disa nga veprat më të njohura të artit</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon stilet e periudhave historike te artit modern</li> </ul>

<p><b>ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK</b></p>	<p>Vlerësimi i Periudhave dhe drejtimeve të artit</p> <p>Vlerësimi i Veprave artistike</p> <p>Analiza estetike e punimeve</p> <p><i>Debate për trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantonë dhe përshkruan punimet e tij, para klasës</li> <li>• Analizonë dhe vlerësojë krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.</li> <li>• Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupore brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollore</li> </ul>
---	---	---

## Udhëzimet metodologjike

Për organizmimin sa më të mirë të procesit mësimor, për një mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme dhe për realizimin e planprogramit mësimor në lëndën e artit figurativ duhet të përdoren metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Këto metodologji janë në shërbim të rritjes së cilësisë së sukseseve dhe arritjeve të mësimnxënjes nga ana e nxënësve, duke i ofruar mundësinë që të shfaqin dhe të zhvillojnë potencialin krijues/artistik që zotërojnë brenda vetes.

Metodologjitë duhet të jenë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, koncepteve, shkathtësive dhe në harmoni me rezultatet e të nxënësve të lëndës së artit figurativ (RNL), fushës së arteve (RNF) dhe kompetencave kryesore të Kurrikulës Bërthamë (RNK).

Përzgjedhja e metodologjive është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës, dhe ato përgjithen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Duke marrë për bazë natyrën e lëndës së artit figurativ që më tepër është veprimtari praktike, ku nxënësit realizojnë vepra të ndryshme artistike, edhe metodologjitë përzgjidhen në atë mënyrë që nxënësi të motivohen për pejsmarrje aktive në këto aktivitete si një mundësi që ata përmes përdorimit të mjeteve të larmishme artistike të reflektojnë idetë, qëndrimet dhe mendimet e tyre.

Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin figurativ.

Mësimdhënia në artin figurativ synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet në mësimdhënien dhe nxënien, bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me nxënësin në qendër dhe mësimdhënien - nxënien e integruar.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit figurativ merr parasysh:

- Zhvillimin dhe forcimin e njohurive dhe shkathtësive bazë të artit figurativ duke u mbështetur në ato paraprake;
- Kompetencat kryesore të të nxënësve në artin figurativ;
- Nxitjen e të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- Motivimin e nxënësve, për krijimtari artistike dhe punë të pavarur
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin figurativ, brenda dhe jashtë klasës
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- Veçoritë e veprimtarive individuale dhe në grup;
- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit figurativ dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënë në procesin mësimor
- Eksperiencat gjatë vizitave nëpër institucione të artit (galeri, muze)

Secila metodologji duhet të jetë në shërbim të interesave dhe nevojave të nxënësve dhe t'i inkurajojë ata të kenë besim në arritjen e suksesit në fushën e artit.

Për të zhvilluar sukseshëm procesin mësimor mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë, të stimulojë dhe inkurajojë nxënësit për pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme duke planifikuar shumëllojshmëri aktivitetesh, materialesh, teknikash dhe informacionesh ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar sa më shumë mbi artin figurativ.

Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave figurative/artistike.

### **Format e punës në lëndën Art Figurativ**

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të lëndës së artit figurativ aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale



- në çifte
- në grupe
- me tërë klasën

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Në sistemin arsimor temat ndërkurrikulare janë tema të rëndësishme përmes të cilave nxënësit fitojnë, zhvillojnë dhe përvetësojnë disa aftësi dhe njohuri specifike, në mënyrë që të përgatiten për jetën dhe punën në të ardhmen dhe të përballojnë dhe tejkalojnë me lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare janë tema me të cilat vazhdimisht është ballafaquar shoqëria njerëzore, të cilat synojnë krijimin dhe kultivimin e disa vlerave shoqërore, humane e njerëzore, të cilat kontribuojnë në formimin e identitetit dhe personalitetit individual dhe të pavarur të nxënësve.

Në temat ndërkurrikulare integrohen dhe kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare në forma të ndryshme duke përfshirë edhe e fushën e arteve me lëndët e saj, e cila i ndihmon nxënësit të njohin, kuptojnë dhe të interpretojnë më mirë botën, ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Temat ndërkurrikulare të cilat trajtohen në fushën e arteve janë:

- *Edukimi për qytetari demokratike*
- *Edukimi për paqe*
- *Globalizimi dhe ndërvarësia*
- *Edukimi për media, dhe*
- *Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm*

Këto tema mund të ndërliken dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me programin e lëndës së artit.

### **Edukimi për qytetari demokratike**

Në temën Edukimi për qytetari demokratike përmes artit nxënësit mund të trajtojnë tema për qytetërimet dhe demokracinë dhe në këtë formë të formojnë identitetin e tyre qytetar e kulturor, si qytetar aktiv për mirqenien e tyre dhe të komunitetit.

### **Edukimi për paqe**

Nxënësit në lëndën e artit mund të trajtojnë dhe realizojnë tema që kanë të bëjnë me paqen, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, dinjiteti njerëzor, diversitetit kulturor, toleranca, humanizmi, harmonia dhe bashkëjetesa.

### **Globalizimi dhe ndërvarësia**

Nxënësit trajtojnë tema që kanë të bëjnë me epokën e globalizimit në sfera të ndryshme shoqërore si në art, kulturë, ekonomi, arsim etj. Dhe ndërvarësia dhe raporti i zhvillimeve

të kulturave të ndryshme shoqërore, duke krijuar një këndvështrim pozitiv e pranues ndaj këtyre përvojave dhe kulturave.

### **Edukimi për media**

Edukimi për përdorimin e medias është një imperativ i kohës për nxënësit, e cila u siguron informacione për zgjerimin e njohurive të tyre mbi zhvillimet historike të artit, autor, vepra arti, teori dhe problem artistike, duke zhvilluar dhe kultivuar shkathtësinë dhe kulturën hulumtuese për trajtimin e problemeve të caktuara. Gjithashtu Median mund të përdorin edhe për krijime artistike dhe prezantimin e projekteve të ndryshme artistike.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

Zhvillimi i qëndrueshëm është një proces i cili i përgatitë nxënësit me aftësi të qëndrueshme që garanton mundësitë për një jetë më të mirë. Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi shoqërinë, në aspektin kulturor-artistik, social, ekonomik dhe mjedisor.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë dhe konsiderohet si element i mësimdhënies që ndihmon mësimdhënësit për ndjekjen e zhvillimit gradual në arritshmërinë e rezultateve të të nxënësve në nivel klase dhe shkolle të nxënësve si dhe zotërimin e kompetencave. Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, po ashtu, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve ngase është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore.

Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.

Vlerësimi në artin figurativ, mbështetet në parimin e individualizimit, ngase arritjet janë më shumë individuale, ku çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e shprehjes artistike.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale, krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte.

Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grupe, në aktivitetet të ndryshme artistike, që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlersimi individual bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli me krijimet, shkrimet, prezantimet dhe testimi janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësit, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit figurativ.

### **Qëllimet e vlerësimit:**

- *Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftushme.*
- *Të motivohen nxënësit për punë*
- *Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së kompetencave*
- *Të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe të forta tek nxënësit.*
- *Të përmirësohen nxënia dhe mësimdhënia*
- *Të japin detyra sipas aftësive individuale në përputhje me nivelin e nxënësve.*
- *Të përzgjedhin metoda të përshtatshme gjatë mësimdhënies, bazuar në nivelin e klasës.*
- *Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm*

### **Format dhe instrumentet e ndryshme të vlerësimit**

Gjatë procesit të vlerësimit sugjerohet që mësimdhënësit të përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

### **Metodat e vlerësimit**

- **Vlerësimi verbal** - përdorimi i pyetjeve të shkurtra, biseda rreth materialit mësimor apo një detyre konkrete, duke diskutuar me nxënësit të veçantë, grupe apo me gjithë klasën, duke dëgjuar diskutimet që bëjnë nxënësit me njëri - tjetrin për një koncept, mbi njohuri të arteve figurative, vepër apo detyrë artistike etj.

- **Vlerësimi me shkrim ose testimi** - detyra të veçanta për grupe nxënësish, teste të shkurtra për një koncept, temë apo dhe një grup temash, për një ese si dhe testime për një linjë të caktuar, semestrare dhe vjetore.
- **Vlerësimi i detyrave të realizuara** - vëzhgimi hap pas hapi i detyrave të artit, që nga ideimi deri tek organizimi dhe realizimi si p.sh: demonstrimi i arritjeve në punë konkrete (fjala vjen realizimi i punëve dy dhe tredimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj kësaj lënde etj).
- **Vlerësimi i projekteve të ndryshme**-bashkëpunimi i nxënësve në një projekt në bazë shkolle apo krahine.
- **Vlerësimi i punëve artistike** - marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj., pjesëmarrja në veprimtari kombëtare si: konkurset, ekspozitat në shkallë vendi apo më gjerë.
- **Vlerësimi përmes portofolit** - portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), krijime të ndryshme dy dhe tredimensionale të realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), kompjuter etj., projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

#### **Instrumentet e procesit të vlerësimit**

- Testi (me shumë zgjidhje, saktë- gabim, përputhje, plotësim, përgjigje e shkurtër dhe kërkesa të hapura);
- Testi i strukturuar me gojë;
- Lista e kontrollit;
- Pyetësi;
- Fleta për intervista;
- Anketa;
- Eseja;
- Projekti;
- Dosja/Portofoli.

## Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave.

Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit, dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në lëndën e artit figurativ duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike figurative me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxit zgjerimin e njohurive mbi artin tek nxënësit duke i motivuar që të përdorin burime, materialeve dhe tekste (Libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

### Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- Mjete vizuale – *figurative: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;*
- Mjete auditive-dëgjimore: *radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;*
- Mjete audiovizuale – *figurative-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;*
- Mjedisi mësimor (*klasa, ateleja, kabineti, natyra, galeria, muzeu etj.*).

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Art muzikor**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Muzika kontribuon në zhvillimin fizik, emocional, intelektual, social dhe estetik të fëmijës, pra në formimin e gjithanshëm të tyre, e posacërisht në formimin kulturor të nxënësve duke e pasuruar botën e tyre shpirtëror dhe personalitetin e tyre.

Me gjuhën universale të cilën e kuptojnë të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, e moshe, muzika u ndihmon nxënësve të kuptojnë dukuritë dhe proceset muzikore përmes shfrytëzuar ato për komunikim dhe shprehje artistike në kontekste të ndryshme.

Si aktivitet shoqëror që në zanafillën e paraqitjes së saj, muzika është medium që mundëson aktivitete të përbashkëta grupore ku kërkohet bashkëpunimi në realizimin e këngëve, pjesëve muzikore me instrumente etj, duke i'u mundësuar nxënësve që të zhvillojnë shkathtësitë e ndryshme muzikore krahas zhvillimit të kompetencave të tjera të përgjithshme.

## Qëllimi

Lënda Edukatë Muzikore në klasën e VIII vazhdon të ketë për qëllim:

- zhvillimin e shkathtësive muzikore të nxënësve sipas interesimit dhe dispozitave individuale-( aftësinë për këndim, dhe për luajtje në instrumente, aftësinë për dëgjim aktiv të muzikës, aftësitë krijuese etj) Z
- rritjen e interesimit të nxënësve për pjesëmarrje aktive në muzikim praktik në shkollë dhe jashtë saj R
- grijten e njohurive dhe të kuptuarit për konceptet dhe elementet e gjuhës muzikore ( ritmin, melodinë, harmoninë, format muzikore) N
- vlerësimin e nxënësve që të dëgjojnë muzikën në mënyre aktive , analitike dhe të cmojnë e vlerësojnë krijimtarinë muzikore (kombëtare dhe botërore) të stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore A
- xitjen e nxënësve që të provojnë aftësitë e tyre krijuese muzikore në forma të ndryshme shprehëse N
- gjerimin e njohurive për krijuesit dhe performuesit, institucionet dhe ngjarjet e rëndësishme muzikore në botë dhe në vend. Z
- ultivimin e shijes së mirë estetike muzikore K

- ftësinë për të komunikuar dhe për tu shprehur në mënyrë artistike e mjetet e shprehjes muzikore

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Rezultatet e të nxënit të fushës (RNL) zbërthehen dhe specifikohen me anë të rezultateve të të nxënit të lëndës të organizuara në 4 tërësitë tematike kryesore.

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
<b>RNF.1.</b> Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.		
<b>Krijimtari a dhe performan ca artistike</b>	Këngë	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi:</li> <li>• Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë) simbas tekstit notal dhe imitimit</li> <li>• Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).</li> </ul>
	Interpretim në instrumente	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi shoqëron këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe</li> </ul>
	Kreativitet muzikor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi improvizon me zë ose me instrumente, ritme dhe melodi në zhanre të ndryshme</li> <li>• Nxënësi shprehet me lëvizje/vallëzim, shprehje letrare e figurative inspiruar nga muzika e dëgjuar.</li> <li>• Nxënësi krijon tërësi të reja muzikore në bazë të rimit, tekstit poetik etj.</li> <li>• Nxënësi shfytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore) sipas interesimit dhe prirjes për të krijuar shprehje origjinale muzikore</li> <li>• Krijon këngë dhe shoqërime instrumentale në</li> </ul>



		zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese);
<p><b>RNF.2.</b></p> <p>Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.</li> <li>● Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).</li> <li>● Dallojnë aplikimet e inovacioneve në teknika shprehëse dhe medime bashkëkohore të artit (si video arti, Instalacioni, Performanca etj.), në veprat e artit bashkëkohor.</li> <li>● Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audiencë të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).</li> <li>● Analizojnë dhe krahasojnë traditat e ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.</li> </ul>		
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik</b>	<b>Elementet muzikore</b> Ritmi Harmonia Melodia Forma Dinamika Tempi Stili/zhanri/gjinia	<b>Rezultatet e të nxënimit të lëndës për temë (RNL)</b> Nxënësi/sja: <ul style="list-style-type: none"> <li>● Dallon, analizon dhe krahason elementet muzikore në veprat muzikore që dëgjojnë</li> <li>● Përdorin elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore</li> <li>● Identifikon format muzikore në veprat e dëgjuara të zhanreve e gjinive të ndryshme muzikore (muzika vokale, instrumentale dhe vokalo-instrumentale (p.sh fuga, sonata, oratoriumi, kantata, opera, simfonia etj))</li> <li>● Njohin rolin e elementeve shprehëse muzikore si tempin, dinamikën, etj</li> </ul>

	<p><b>Shkrim leximi muzikor</b></p> <p><b>Tonalitetet</b> (shenjat e shartimit)</p> <p><b>Elementet e formave muzikore :</b> Motivi, Temat muzikore Fjalja, periudha (Repriza, (da capo al fine, coda corona, etj)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Zbatojnë shkrim-leximin muzikor në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre individuale muzikore.</li> <li>● Njohin parimin e tonalitetëve të ndryshme muzikore dhe simbolet e tyre</li> <li>● Identifikojnë parimin e ndërtimit të formave të ndryshme muzikore edhe përmes tekstit notal</li> <li>● Identifikojnë elementet e formës muzikore në veprat që performojnë dhe dëgjojnë</li> <li>● Përdorin elementet e ndryshme të formave muzikore në krijimet e tyre</li> </ul>
<p><b>RNF.3.</b></p> <p>Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjelltas në kontekstin historik, social dhe kulturor</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror;</li> <li>● demonstroi të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasika, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).</li> <li>● prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar</li> </ul>		
<p><b>Muzika dhe shoqëria</b></p>	<p><b>Zhanret muzikore</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Nxënësit dallojnë dhe krahasojnë veprat sipas zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok, muzikë festive etj) përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë</li> </ul>
	<p><b>Gjinitë (llojet) muzikore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Analizojnë muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muziken skenike përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare</li> </ul>



Përjetimi artistik, kërshtëria, imagjinata dhe liria e të shprehurit, janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Nxënësit kuptojnë proceset dhe teknikat krijuese muzikore, duke mësuar edhe si t'i zbatojnë ato në praktikë gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore. Artet ndërveprojnë mes vete, andaj edhe në procesin mësimor mund të ndërlihen format e ndryshme të të shprehurit artistik, p.sh., kënga me lëvizjen dhe vallëzimin, muzika me shprehjen figurative, muzika me shprehja letrare, shprehja figurative me shprehjen letrare, performanca artistike sinkretike etj. Sidomos në këtë nivel, mund të aplikohet qasja e integruar e kombinimit të shprehjeve artistike për tema të ndryshme.

Ndërlidhja e gjuhës (amtare dhe të huaj) me muzikën mund të jetë shumë e suksesshme. Poezitë e ndryshme janë shpesh pjesë të këngëve artistike, por edhe temat e ndryshme letrare ndërlihen me veprat e ndryshme muzikore për dëgjim.

Udhëzimet specifike metodike të mësimin të muzikës në këtë klasë të elaboruara për secilën tërësi tematike e ndihmojnë mësimdhënësin që të planifikojë me kujdes orët mësimore gjatë një muaji, në mënyrë që ato të jenë të kombinuara dhe të mundësojnë arritjen e qëllimeve të lëndës.

### **Këndimi dhe luajtja në instrumente**

Melodia dhe ritmi janë pjesë e pandashme e njohurive të domosdoshme që duhet të dijë nxënësit për kuptimin e muzikës. Këngët vazhdojnë të mësohen edhe sipas veshit (imitimit) por edhe me tekst notal, varësisht nga mundësitë e nxënësve.

Këndimi, luajtja në instrumentin e bokflautit por edhe instrumenteve të tjera muzikore zhvillohen nëpërmjet teknikave dhe ushtrimeve të vazhdueshme. Përmes të kënduarit zhvillohen më tej mënyrat e formësimit të zërit dhe të një të kënduari të saktë në intonacion e në një ritëm të caktuar. Përmbajtjet e këngëve janë të thjeshta dhe vazhdojnë të ruajnë tematika të tilla si: dashuria për familjen, shkollën, atdheun, këngët patriotike dhe festat e ndryshme, idetë dhe dëshirat e ndjenjat personale, si edhe temat nga çështjet ndërkurrikulare (paqja, tolerance, ambienti, etj) etj. Këngët për të rinj dhe ato popullore të përzgjedhura me kujdes sipas kriterëve të përzgjedhjes së këngës duhet poashtu të përfshihen. Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga shtrirja e regjistrimit vokal (zërit), melodia dhe në ritme e masa të ndryshme. Ndërsa luajtja në instrumente muzikore (popullore dhe klasike me të cilat disponojnë fëmijët) bëhet sipas veshit (me imitim) por edhe me tekst notal, për të shoqëruar këngët, por nxiten nxënësit që edhe të interpretojnë individualisht dhe në grupe pjesë të shkurtëra muzikore sipas tekstit notal.

### **Gjuha dhe komunikimi artistik**

Trajtohen masa e ndryshme muzikore dhe dukuritë ritmike e melodike, shkallët muzikore etj. në bazë të këngëve e shembujve dhe në këtë mënyrë zgjerojnë më tej njohuritë muzikore për të kuptuarit, krijimin, interpretimin dhe gjykimin e saktë të muzikës që dëgjon apo performon. Trajtohen elementet formale muzikore në veprën e dëgjuar ose të performuar gjithnjë përmes dëgjimit, analizës dhe tekstit notal që ndihmon nxënësin për të kuptuar parimin e ndërtimit të formës muzikore. Këtu nxënësit nxiten të punojnë në mënyrë të pavavrur, në grupe etj dhe me

rëndësi është që materiali muzikor që përdorin për performim ose dëgjim shërben si bazë pr të vërejtur, analizuar dhe dalluar elementet e ndryshme shprehëse muzikore.

### **Dëgjimi muzikor, cmuarja dhe vlerësimi**

Dëgjimi muzikor, përjetimi dhe të shprehurit emocional ndaj muzikës, është një proces shumë i rëndësishëm. Muzika krijon emocione të ndryshme dhe nxënësit duhet të nxiten që ti shprehin ato emocione të përjetuara. Dëgjimi aktiv muzikor kërkon përzgjedhjen e kujdeshme të veprave muzikore për dëgjim që ato të jenë të përshtatshme për aftësitë përjetuese të nxënësve. Muzika orkestrale është më atraktive për nxënësit e kësaj moshe, më e larmishme në ngjyra tingëllore, kurse muzika vokalo-instrumentale është më konkrete për shkak të tekstit gjuhësor që e konkretizon përmbajtjen muzikore. Muzika programore, skenike, muzika e popullarizuar poashtu mundëson që nxënësit të jenë më afër përmbajtjes muzikore dhe mesazhit të këtyre veprave. Përdorimi i teknologjive të ndryshme ndihmon dhe është në funksion të kërkimit të të dhënave dhe të prezantimit të veprave muzikore për dëgjim (shembujt muzikorë dhe videot e interpretimeve të veprave të ndryshme muzikore në youtube, CD, video etj)

Nxënësit inkurajohen vazhdimisht që të cmojnë dhe vlerësojnë veprat e dëgjuara duke përdorur termet adekuate për elementet muzikore dhe shprehjen artistike.

Në lëndën e muzikës në klasën e VIII mund të trajtohen një varg çështjesh ndërkurrikulare.

**Edukimi për demokraci dhe paqë** ka të bëjë me promovimin e përgjegjësisë, të drejtat e njeriut, të çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimin dhe luftimin e dukurive negative shoqërore, promovimin e dialogut, tolerances etj. Këto tema mune të jenë subjekt i këngëve që nxënësit i këndojnë në klasë dhe në aktivitetet jashtëshkollore. Mund të organizohen projekte tematike në këto tema me c' rast përzgjidhen këngët dhe veprat muzikore për dëgjim që kanë ndërlidhje me këto tema.

### **Globalizimi dhe ndërvarësia**

Nga perspektiva e arteve, vetë veprimtaritë artistike grupore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh kur duhet të realizohet nje mural, mozaik, kolazh, ose maketë grupore, të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Muzikimi në ansambël, kor, orkestër realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

### **Edukimi për media**

Nga perspektiva e arteve, ketu perfshihen çështjet e përdorimit të drejtë të teknologjisë dhe mediave për krijimin dhe shpërndarjen e veprave artistike, por edhe edukimin e shijes estetike për artin që përfaqësohet në media (imazhet, muzika e mirë dhe jo e mirë, shpërndarja e muzikës përmes medimeve (e drejta autoriale, copyright etj)por edhe aplikimi i mediave per krijim artistik (fotografia,kolazhi etj), objektivizimi i gjinisë femërore në materialet muzikore në media, etj.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare mund të jenë objekt trajtimi i veprimtarive artistike (muzikës, dramës, vallëzimit, arteve pamore dhe teknikave të ndryshme (postere, grafike, pikturë etj)

Përdorimi i shprehjes artistike muzikore për të trajtuar të drejtën e fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme, për dukuritë e ndryshme (psh kunder duhanit, stop dhunës ndaj fëmijëve, stop luftës, etj) është i mundshëm përmes projekteve tematike në të cilat muzika merr pjesë.

Përdorimi i shprehjes artistike dhe lëndëve artistike për të trajtuar temat e zhvillimit të qëndrueshëm (mbrojtja e ambientit, hapësirave, rregullit, lobimi për jete të shëndetshme etj) është poashtu një mundësi shumë e mirë e trajtimit të çështjeve ndër-kurrikulare edhe e integritetit ndërlëndor. Një ambient i shëndoshë tingullor është shumë i rëndësishëm për shoqërinë andaj trajtimi i shijes muzikore të nxënësve, kujdesi për nivelin e zërit, zhurmave etj adreson këtë çështje.

## Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi në përgjithësi bëhet sipas 5 niveleve.

**Niveli 1** Dëshmon një shkallë të pamjaftueshme të përmbushjes së rezultateve të të nxënës dhe përkon me vlerësimin Pamjaftueshëm.

**Niveli 2** Dëshmon një zotërim minimal dhe të mjaftueshëm të rezultateve të të nxënës, por që janë bazë për veprimtarinë e nivelit pasardhës dhe përkon me vlerësimin Mjaftueshëm.

**Niveli 3** Përfaqëson disa arritje të pjesshme të të nxënës dhe disa kompetencave për të kapërcyer sfidat e të nxënës dhe përkon me vlerësimin Mirë.

**Niveli 4** Përfaqëson arritje solide në përmbushjen e rezultateve të të nxënës dhe përkon me vlerësimin Shumë mirë.

**Niveli 5** Përfaqëson arritjet më të larta e të qëndrueshme në përmbushjen e rezultateve të të nxënës dhe përkon me vlerësimin Shkëlqyeshëm.

Vlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm por mund të zbatohet edhe vlerësimi përmbledhës për periudhën dy apo tre mujore që të vlerësohet arritja e zbatimit të planit dy mujor. Vlerësimin e vazhdueshëm e mundëson mësimdhënësi përmes evidentimit të progresit të nxënësve me instrumente të ndryshme të vlerësimit, ku përfshihen:

- **Lista e kontrollit** për këngët, pjesët instrumentale dhe vlerësimi për nivelin e performimit sipas kritereve të përcaktuara
- **estet e ndryshme muzikore** ( me dëgjim dhe me gojë e me shkrim ), detyrat e ndryshme hulumtuese me elementin e dëgjimit muzikor

L

T

- **Ieresimi i dosjes** (portofolit) të nxënësit. Portfolio është koleksionimi i kontributeve të nxënësit/es dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e tij/saj në lëndën e muzikës. Dosja /portofolio mund të përmbajë punët/detyrat praktike që zbatohen në klasë; projekte/pune praktike si detyrë shtepie, playliste me shembuj muzikorë, kërkime individuale për kompozitorët, instrumentet, veprat muzikore etj
- Projekt muzikor individual apo në grup, lidhur me çështje të ndryshme të muzikës.

## Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Gjatë mëimit të muzikës mund të përdoren mjete didaktike dhe burime të ndryshme muzikore. Zëri dhe instrumentet tjera muzikore janë burimet kryesore për realizimin me sukses të edukatës muzikore. Pasjisa e kabinetit të muzikës me instrumente të ndryshme muzikore ( ritmike dhe melodike) mundëson aktivitet muzikor dinamik në klasë dhe në shkollë. Pajisja me mjete te teknologjisë bashkëkohore TV, CD, projector dhe qasje në internet I mundëson mësimdhënësve që të prezantojnë shembujt muzikore në klasë në mënyrë auditive dhe vizuele, por edhe nxënësve u mundëson prezantimin e detyrave hulumtuese dhe projektet e tyre.

Tekstet mësimore, enciklopeditë muzikore e burimet on line mundësojnë nxënësve të marrin informacione të duhura për krijuesit, instrumentet, stilet dhe zhanret muzikore, performuesit, institucionet

Tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë (të këngëve dhe shembujve muzikorë për dëgjim), albume të ndryshme me pamje të instrumenteve, kompozitoreve etj mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese.

### **Disa burime on line:**

#### **Libri i klasës së VIII për edukim muzikor**

<http://music-teacher-resources.com/>

<http://www.zzounds.com/edu--musicteacherhandouts>

<http://interactivesites.weebly.com/music.html>

<http://www.classicsforkids.com/>

[https://www.youtube.com/results?search\\_query=muzike+instrumentale+klasike](https://www.youtube.com/results?search_query=muzike+instrumentale+klasike)

[https://www.youtube.com/results?search\\_query=muzike+popullore+shqiptare](https://www.youtube.com/results?search_query=muzike+popullore+shqiptare)

<https://www.youtube.com/watch?v=fABL5xSG4cA>

# **FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Matematikë



# Kurrikula lëndore/programi mësimor

## Matematikë

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Matematika si fushë dhe lëndë mësimore, në klasën e tetë, si vazhdimësi e programit paraprak, siguron zhvillimin dhe avansimin e njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave. Ajo u mundëson nxënësve të vazhdojnë të përmbushin me sukses nevojat dhe interesat e tyre, të zhvillojnë personalitetin dhe potencialin e tyre në zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e të jetës dhe integrimin në shoqëri.

Programi lëndor i klasës së tetë është vazhdimësi logjike e programit lëndor të klasës së shtatë dhe mundëson realizimin e rezultateve të fushës për shkallën 4. Që të arrihet kjo nevojiten materiale të mira mësimore, metodologji të larmishme të mësimdhënies, e sidomos angazhim i vazhdueshëm për zhvillimin e aftësive të nxënësve. Tërë kjo ka synim që nxënësit të vazhdojnë të fitojnë njohuritë e nevojshme dhe të kuptojnë marrëdhëniet sasiore, hapësinore dhe modelet në fenomene të ndryshme në natyrë, shoqëri dhe në jetën e përditshme si dhe zhvillimin e të menduarit logjik, kritik, analitik dhe abstrakt.

Programi i matematikës në vete përmban:

- qëllimet e lëndës së matematikës për klasën e tetë dhe i shërben:
  - nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë qytetar i suksesshëm,
  - mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj,
  - prindit për njohjen e rezultateve të të nxënësve të fëmijës dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore,
  - hartuesve të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësit dhe nxënës.
- rezultatet e të nxënësve të lëndës për tema mësimore me përmbajtje të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore;
- udhëzime metodologjike të mësimdhënies si kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësin të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare për kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme;
- udhëzime për vlerësimin e arritjes së nxënësve të klasës së tetë;
- udhëzime për materiale didaktike dhe burimet e mjetet mësimore.

## Qëllimi

Përmes të mësuarit të matematikës në klasën e tetë synohet që nxënësit të përvetësojnë njohuri themelore matematikore të nevojshme për të kuptuar fenomenet dhe ligjet e natyrës dhe të shoqërisë, zhvillimin intelektual të nxënësit, ushtrimin e rregullave themelore, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për klasat në vijim. Po ashtu programi i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë dhe strukturat matematikore si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë llogaritëse dhe të zgjidhjes së problemeve në jetën e përditshme. Njëkohësisht programi i matematikës në klasën e tetë gjatë zbatimit: përzgjedh dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve; bën vrojtime, hetime, hulumtime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; komunikon të menduarit e tij matematik duke përdorë simbole matematike; krijon paraqitje të koncepteve të matematikës duke i lidhur mes vete dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i lëndës së matematikës në klasën tetë është promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të koncepteve matematike dhe përforcimi i tyre i cili bëhet përmes:

- të nxënës të integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme;
- të nxënës nëpërmjet përvetësimit të koncepteve elementare dhe koncepteve të ndërtruara të matematikës.

Programi i matematikës për klasën e tetë qëllim kryesor ka krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fushës - lëndës si dhe të kompetencave kryesore që lidhen me to.

## Tema dhe rezultatet e të nxënës

Përvetësimi i përmbajtjeve programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante që atij i parashtrohen në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive në arritjen e rezultateve të të nxënës të planifikuara për tema përkatëse për këtë klasë.

Në lëndën e matematikës për klasën e tetë zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- numrat, algjebra dhe funksioni;
- forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti;

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema dhe për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënës që bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënës të fushës për shkallë.

### I. Numri, algjebra dhe funksioni

Rezultatet e përgjithshme të të nxënës

Nxënësi:

- përdorë termat: numër natyrorë, numër pozitiv e negativ, numër i plotë, numër racional, vlerë absolute, numër reciprok, rrënjë katrore, fuqi, monom, binom, polinom,
- përvetëson konceptin për numrin dhe veprimet me numra nëpërmjet trajtimit më të thelluar të thyesave, numrave dhjetorë, shprehjeve shkronjore dhe zbaton ato në praktikë në zgjidhje të problemeve,
- përdorë simbole, fakte dhe procedura për zgjidhjet problemore që lidhen me numra të plotë dhe racionalë, me fuqi, me polinome etj, duke përzgjedhur dhe zbatuar strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve,
- përvetëson matematikën si pjesë e kulturës njerëzore (integron matematikën me situata ose dukuri nga kontekste të tjera: jeta e përditshme, lëndët tjera, sportet, ngrohja globale, turizmi, ekonomia, ambienti, migrimi etj.);
- përdor veglat e teknologjisë informative për njehsime të ndryshme,
- modelon dhe zgjidhë ekuacione dhe inekuacione elementare dhe i zbaton në probleme nga situatat reale;
- modelon dhe zgjidhë probleme nga jeta e përditshme duke përdorur fuqitë, shprehjet shkronjore, paraqitjet grafike etj.

## II. Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria

Rezultatet e përgjithshme të të nxënit për temën

Nxënësi:

- konstrukton figura gjeometrike simetrike ndaj drejtëzës/pikës
- konstrukton rrotullimin e figurave gjeometrike për një kënd të caktuar/ndaj një boshti të caktuar
- konstrukton rrethin e brendashkruar/jashtëshkruar në trekëndësh;
- konstrukton trekëndëshin kur dihen tri elemente të tij
- përdorë matjet dhe përvetëson formulat për caktimin dhe njehsimin e syprinës së sipërfaqeve trekëndëshe si dhe zgjidhë probleme nga situatat reale;
- klasifikon dhe konstrukton katërkëndëshin në bazë të vetive të ndryshme;
- përdorë matjet dhe përvetëson formulat për caktimin dhe njehsimin e syprinës së sipërfaqeve paralelograme;
- zbaton teoremën e Pitagorës në figurat dhe objektet ku paraqitet trekëndëshi kënddrejtë si dhe në probleme të jetës reale;
- përvetëson kuptimet mbi rrethin dhe elementet e tij
- konstrukton tangjenten e rrehit
- zbaton rregullat për të njehsuar syprinën e sipërfaqes rrethore
- zbaton rregullat për llogaritjen e syprinës së sipërfaqes së cilindrit, konit dhe sferës;
- zbaton rregullat për llogaritjen e vëllimit e cilindrit, konit dhe sferës.

### III. Përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti

Rezultatet e përgjithshme të të nxënit

Nxënësi:

- demonstroi njohuri për ngjarjet dhe dallimin e tyre;
- njehson probabilitetin për ngjarje të dhëna;
- paraqet probabilitetin e ngjarjeve të ndryshme numerikisht dhe grafikisht;
- përdor teknologjinë për zgjidhjen e problemeve nga statistika dhe probabiliteti dhe nga jeta e përditshme.

Koncepti	Temat	Rezultatet specifike të të nxënit të lëndës për temë (RNL)
Numri, funksioni dhe algjebra	Bashkësitë numerike	Nxënësi: - Përkufizon bashkësitë numerike: $N$ , $N_0$ , $Z$ dhe $Q$ si dhe i shkruan simbolikisht ato, - Lexon dhe shkruan numrat natyrorë, thyesorë dhe dhjetorë, - Kryen veprimet me numra natyrorë, thyesorë dhe dhjetorë, - Përcakton bashkësinë e zgjidhjes së ekuacioneve me një të panjohur, - Shndërron numrat thyesorë në numra dhjetorë, dhjetorë periodik dhe anasjelltas.
	Fuqitë dhe rrënja katrore	Nxënësi: - Lexon dhe shkruan fuqitë me eksponentë numër të plotë, - Shkruan numrat e mëdhenj dhe të vegjël si fuqi të numrit 10, - Përkufizon dhe vërteton vetitë e fuqive me baza të njëjta, - Zbaton vetitë e fuqive të veprimet me fuqi, - Përkufizon rrënjën katrore dhe njehson rrënjën katrore të numrave racionalë pozitiv me llogaritje, - Zbaton veprimet e rrënjëzimit të prodhimit dhe të herësit,
	Shprehjet shkronjore	Nxënësi: - Njehson vlerën (numerike) të shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve, - Përkufizon shprehjet shkronjore, - Përkufizon binomin, trinomin, polinomin,

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryen veprimet (+,-,*,:;) me monome të ngjashme dhe jo të ngjashme,</li> <li>- Redukton polinomet,</li> <li>- Mbledh, zbret dhe shumëzon monome dhe polinome,</li> <li>- Shprehë prodhimet e veçanta si formula (katrorin e binomit, kubin e binomit, ndryshimin e katrorëve, ndryshimin e kubeve) duke i vërtetuar në mënyrë algjebrike dhe gjeometrike,</li> <li>- Faktorizon polinomet duke përdorur PMP,</li> <li>- Faktorizon shprehjet shkronjore, polinomet me dy, tri dhe katër terma.</li> </ul>
	Ekuacionet dhe Inekuacionet lineare me një të panjohur	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon ekuacionin linearë me një të panjohur,</li> <li>- Zbaton vetinë aditive dhe multiplikative të zgjidhja e ekuacioneve,</li> <li>- Zgjidh detyra problemore me fjalë me ndihmën e ekuacioneve lineare me një të panjohur,</li> <li>- Përkufizon inekuacionin linear me një të panjohur,</li> <li>- Zgjidh inekuacione lineare me një të panjohur dhe paraqet zgjidhjet e tyre me bashkësi, grafik dhe intervale,</li> <li>- Zgjidhë detyra problemore me fjalë me ndihmën e inekuacioneve lineare me një të panjohur,</li> </ul>
<b>Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria</b>	Simetria	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton qendrën e segmentit duke konstruktuar simetralen e tij,</li> <li>- Konstruktin figura simetrike ndaj një drejtëze-simetrinë boshtore,</li> <li>- Konstruktin rrotullimin e figurave për një kënd të caktuar,</li> <li>- Konstruktin figurat simetrike ndaj një pike-simetria qëndrore,</li> <li>- Rrotullon figurat ndaj boshtit të tyre-simetria rrotulluese,</li> <li>- Konstruktin drejtëzat e simetrisë të figurat me bosht simetrie,</li> <li>- Përcakton qendrën e simetrisë të figurat me qendër simetrie.</li> </ul>

	Figurat gjeometrike	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon trekëndëshin dhe sipërfaqen trekëndëshe,</li> <li>- Klasifikon trekëndëshat në bazë të gjatësisë së brinjëve dhe madhësisë së këndëve,</li> <li>- Brendashkruan rrethin në çfarëdo trekëndëshi,</li> <li>- Jashtëshkruan rrethin në çfarëdo trekëndëshi,</li> <li>- Konstruktin trekëndëshat barakrahës, barabrinjës, brinjëndryshëm kur dihen tri elemente të tij (jo tri kënde),</li> <li>- Njehson perimetrin dhe syprinën e sipërfaqeve trekëndëshe duke kryer matjet e nevojshme dhe duke përdorur formulat,</li> <li>- Përkufizon katërkëndëshin dhe sipërfaqen katërkëndëshe,</li> <li>- Zbulon se shuma e këndëve të katërkëndëshit është <math>360^\circ</math>,</li> <li>- Klasifikon katërkëndëshat në bazë të pozitës së brinjëve,</li> <li>- Klasifikon paralelogramet në bazë të vetive të tyre,</li> <li>- Konstruktin paralelogramet kur dihen elementet e tij,</li> <li>- Njehson perimetrin dhe syprinën e sipërfaqeve paralelorame.</li> </ul>
	Teorema e Pitagores	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vërteton teoremën e Pitagorës,</li> <li>- Zgjidhë detyra për trekëndëshin kënddrejtë duke zbatuar teoremën e Pitagorës,</li> <li>- Zbaton teoremën e Pitagorës për të zgjidhur detyra që kanë të bëjnë me trekëndëshin barakrahës, barabrinjës, trapezin barakrahës, kubin dhe kuboidin,</li> <li>- Përdorë teoremën e Pitagorës në zgjidhje të problemeve nga jeta reale.</li> </ul>
	Rrethi	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon rrethin, sipërfaqen rrethore dhe përcakton elementet e tij,</li> <li>- Dallon dhe vizaton rrethin, sipërfaqen rrethore dhe pjesët e tij,</li> <li>- Përkufizon këndin qendror dhe periferik të rrethit</li> </ul>

		<p>dhe heton lidhshmërin e tyre kur ndodhen në të njëjtën kordë,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vërteton se këndi periferik është sa gjysma e këndit qëndror mbi të njëjtën kordë,</li> <li>- Përkufizon tangjentën e rrethit dhe e konstukton atë kur është dhënë rrethi dhe një pikë,</li> <li>- Përcakton numrin pi, njehson gjatësinë (perimetrin) e rrethit si dhe të harkut rrethor,</li> <li>- Njehson syprinën e sipërfaqes rrethore, sektorit rrethorë, unazës rrethore,</li> </ul>
	<p>Trupat gjeometrikë rrotullues (Cilindri, Koni dhe Sfera)</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon cilindrin dhe dallon elementet e tij,</li> <li>- Ndërton rrjetën e sipërfaqes cilindrike, zbulon formulën dhe njehson syprinën e sipërfaqes së cilindrit,</li> <li>- Njehson vëllimin e cilindrit,</li> <li>- Përkufizon konin dhe dallon elementet e tij,</li> <li>- Ndërton rrjetën e sipërfaqes konike, zbulon formulën dhe njehson syprinën e sipërfaqes së konit,</li> <li>- Njehson vëllimin e konit,</li> <li>- Përkufizon sferën dhe dallon elementet e saj,</li> <li>- Njehson syprinën dhe vëllimin e sferës.</li> </ul>
<p><b>Të dhënat dhe probabiliteti</b></p>	<p>Probabiliteti</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon eksperimentin, realizimin, ngjarjen dhe i dallon ato,</li> <li>- Dallon shkallët e probabilitetit në ngjarjet e dhëna dhe përcakton vlerat e tyre,</li> <li>- Llogaritë vlerat e probabilitetit në ngjarjet e dhëna.</li> <li>- Paraqet probabilitetin e ngjarjeve në formë numerike si thyesë ose si numër dhjetor duke i paraqitur ato vlera edhe grafikisht.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën tetë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë II, e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënësve. Temat që paraqiten në programin e klasës së tetë nuk zhvillohen si të veçanta, por duhet të integrohen në mes vete, të jenë vijimësi e atyre të zhvilluara në klasën e shtatë si dhe të jenë të lidhura me fusha të tjera. Rezultatet e të



nxënit për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që synojnë edhe tema të tjera brenda dhe jashtë fushës kurrikulare.

Mësimdhënësi duhet të përqëndrohet kryesisht në:

- lidhjen e rezultateve të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultateve të nxënit për tema;
- mësimdhënie me nxënësin në qendër;
- mësimdhënie dhe të nxënit e integruar;
- zhvillimi i temave ndërkurrikulare;
- zhvillimi i veprimtarive për arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi:

- përcaktimin e temës për t'u zhvilluar;
- listimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim;
- mundësimin në qasje në të gjitha mjetet e domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen dhe lavdërimin e përhershëm të nxënësve;
- informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijve të tyre.

Mësimi i matematikës duhet të bëhet me metoda të avancuara dhe me forma moderne të punës me një qasje njohëse që përfshin zhvillimin konceptual, njohuritë dhe miratimin e skemave kuptimplote. Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, pasi i jep secilit nxënës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Nxënësit duhet të trajnohen për të punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, meqë kjo jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e ri e të panjohur, të respektojnë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punën ekipore. Përmes qasjes së nxënies me kompetenca mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre duke marr parasysh dallimet mes nxënësve në klasë.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngusht me shumë komponente të arsimit, e që njëkohësisht kontribuon në realizimin e këtyre temave: ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit etj. Nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje

të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në ngritjen e tij personale. Nxënësi mund të përdorë metodat statistikore si anketa, intervista për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të asyetojë dhe argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

Duke përdorur të kuptuarit për numrat, arsyetimin e raporteve, interpretimin e përqindjeve, nxënësi mund të ushtrojë gjykimin e tij kreativ dhe kritik për konsumimin dhe përdorimin e mallërave të konsumit. Njohuritë statistikore dhe probabiliteti mund të ndihmojnë nxënësin të interpretojë të dhëna për promovimin e shëndetit të mirë, traditës e zakoneve të jetesës dhe për të ushtruar gjykimin, argumentimin për vendimet e marra. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së matematikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

## **Udhëzime për vlerësim**

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë parasysh rezultatet e të nxënësve për tema mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e fushës për shkallë. Vlerësimi i arritjes së nxënësve të klasës së tetë nga matematika realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimeve të vazhdueshme, vëzhgimit në klasë, detyrave kontrolluese (testeve tematike), detyrave të shtëpisë, vlerësimit përmes testeve përmbledhëse periodike. Raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me komente konstruktive dhe me nota numerike (1-5).

Gjatë vlerësimit mësimdhënësi duhet të fokusohet dhe të mbështetet në një sasi të dhënash si: vlerësimi i përgjigjeve me gojë, puna në grup, aktivitetit gjatë debateve në klasë, detyrat e shtëpisë, testet për një grup temash të caktuara, testet në përfundim të një periudhe të caktuar, etj.

## **Udhëzime për materiale dhe burimet mësimore**

Gjatë mësimit të matematikës mësuesi jep informacione dhe performon shkathtësi duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi gjeneron informacione dhe formon shprehje si dhe zhvillon shkathtësi duke i'u qasur të mësuarit përmes të pamurit, të dëgjuarit, prekjes, përdorimit të teknologjisë dhe formave të tjera.

Për realizimin e kompetencave të nivelit të dytë të arsimit të mesëm të ulët për klasën e tetë, mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të mësuarit.

Mësuesi, përveç materialeve dhe mjeteve të nevojshme didaktike, burimeve të besueshme të ndryshme nga interneti, krijon modele matematike, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedis dhe klimë për aktivitete alternative. Ai po ashtu ofron edhe mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e tij në mësimin e matematikës. Mësuesi, u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë detyra dhe projekte të ndryshme.

# **FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT E NATYRËS**

## **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Fizikë  
Biologji  
Kimi

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Fizikë

## **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Fizika është shkencë që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Ajo i ofron nxënësit mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, e praktikave të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, e kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Kurrikula e re ndihmon që përmes fizikës 8 në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë nxënësve në aspektin personal, social dhe ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës në shkallën e IV kontribuonë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Nxënësi fillon me idetë e tij se si janë gjërat dhe pastaj i ndryshon dhe i zhvillon duke i provuar ato praktikisht. Gjatë veprimtarive shkencore nxënësi ndeshet me mundësitë e ndryshimit, rivendosi ose sfidës së ideve. Kjo mënyrë e të nxënësve bën që nxënësi të zhvillojë dhe formojë të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave të tij. Idetë dhe konceptet përpunohen për sa kohë nxënësi punon në situata problemore dhe zbaton metoda kërkimore për t'i zgjidhur problemet. Duke mësuar në këtë mënyrë, ai mund të përjetojë gëzimin e zbulimit shkencor dhe të ushqejë kureshtjen për botën që erreton.

Mësimi i fizikës në klasën e tetë lidhet ngushtë me TIK dhe së bashku e formojnë nxënësin në një kontekst më të gjerë.

Ajo i shërben nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës; mësuesit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj dhe prindit për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit në periudha të caktuara.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e gjithëpërfshirjes në aspektin gjinor, etnik, kulturor, racor, fetar dhe nevojave të veçanta të fëmijëve.

## Qëllimi

Programi në Fizika 8 ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të nxënësit, duke gërrshetur të nxënësve teorik me metodat e hulumtimit, vrojtimit të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator ose në terren, burimeve të ndryshme mësimore, përpunimit të informatave dhe prezentimit të gjeturave etj. Kjo iu mundëson nxënësve që aktivisht të zhvillojnë kompetencat e tyre dhe në sajë të kërkimeve të kuptojnë, shpjegojnë dhe ndërhyjnë në ndërlidhjen e jetës me natyrën. Të mësuarit e lëndës së fizikës ka për qëllim zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e fizikes:

- zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues;

- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- përshkruajnë burimet energjitike;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen.

## **Temat dhe rezultatet e të nxënit**

Përmbajtja e lëndës së fizikës është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënit lëndore (RNL). Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin gjashtë koncepte, të zërthyer në koncepte specifike (domeni) në tema dhe rezultate të të nxënit lëndorë me anë të të cilëve përfshihet fundamenti i fushës së shkencës në lëndën përkatëse.

Rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore sigurojnë:

- Zhvillimin e kompetencave përmes një tërësie të përbashkët përvojash mësimore të ndërlidhura.
- Lidhjen/koherencën ndërmjet temave dhe veprimtarive mësimore, që realizohen në kuadër të një lënde mësimore, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që mundësojnë këto tema në funksion të arritjes së rezultateve të fushës kurrikulare.
- Fokusin e planifikimit mësimor në rezultate të të nxënit.
- Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel të lëndëve të fushës, në nivel klase/shkolle.

Rezultatet lëndore, në fizikë për klasën e tetë si pika referente kanë temat:

<b>Konceptet</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të fushës (RNF)</b>	
	Shpjegon burimet e energjisë, format dhe shndërrimet e valëve mekanike, të zërit, ligjeve elektrike dhe magnetike, burimeve të dritës, relativitetit të levizjeve, strukturës së bërthamës, radioaktivitetit të saj, me qëllim të shfrytëzimit të tyre në jetën e përditëshme	
<b>Proceset fizike</b>	<b>Tërësitë tematike</b>	<b>Rezultatet e të nxënit në Lëndë (RNL)</b>
	<b>1.Lëvizjet e nxituara</b>	<b>I.</b> <b>Nxënësi:</b> -përkufizon nxitimin e trupit dhe përshkruan lëvizjen drejtvizore njëtrajtësisht të nxituar, -njehson shpejtësinë nga formula e përkufizimit të nxitimit dhe me ndihmën e sipërfaqes nën gjysmëdrejtzen $a = \text{konst.}$ për kohë të caktuar $t$ , në grafikun $a/t$ , -përcakton rrugën $s$ të levizjet njëtrajtësisht të nxituara me ndihmën e shpejtësisë mesatare dhe nga sipërfaqja nën gjysmëdrejtzen $a$ për kohë të caktuar $t$ , në grafikun $v/t$ , -përfiton formulat për lartësi $h$ , shpejtësi $v$ dhe nxitim $g$ të rënjës së lirë të trupit nga shprehjet $s$ , $v$ dhe $a$ të lëvizjes njëtrajtësisht të nxituar me nxitim constant, -dallon lëvizjet e pikës lëndore sipas formës së rrugës, sipas shpejtësisë dhe sipas nxitimit, -zgjidhë detyra numerike për përcaktimin e rrugës, shpejtësisë, kohës dhe nxitimit për lëvizje drejtvizore njëtrajtësisht të nxituara dhe rënjë të lirë.
	<b>2.Ligjet themelore të mekanikë</b>	<b>I, III.</b> -trajton forcën si shkak të lëvizjes së trupit dhe paraqet kuptimin e ligjit të inercisë me ndihmën e demonstrimeve virtuale të Galileit, -paraqet masën e trupit si tregues të plogëtisë së tij, apo si rezistencë ndaj lëvizjes, -demonstron raportin mes forcës me intensitete të ndryshme që vepron në trup të njëjtë dhe nxitimit që përfiton ai, ( $m = \text{konst.}$ , $F = \text{ndryshore}$ ), -demonstron raportin mes forcës konstante që vepron në trupa me masa të ndryshme dhe nxitimeve që iu jep atyre ( $m = \text{ndryshore}$ , $F = \text{konst.}$ ),



		<p>-shkruan formulën e ligjit të dytë të Njutonit duke u bazuar në raportet mes madhësive që dalin nga demonstrimet e cekura dhe paraqet madhësitë që e përkufizojnë njësinë e forces,</p> <p>-dallon madhësitë fizike sipas përkufizimit, në madhësi skalare dhe vektoriale,</p> <p>-tregon shembuj të zbatimit të ligjit të dytë të Njutonit, për përcaktimin e forcës, nxitimit dhe masës së trupit,</p> <p>-shënon formulën e ligjit të tretë të Njutonit dhe vën në dukje shembuj për demonstrimin e tij,</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për zbatimin e ligjit të dytë të Njutonit.</p>
	<p><b>3. Zbatimi i ligjit të dytë mekanikës</b></p>	<p>-shënon ligjin e Njutonit për bashkëveprim gravitacional të trupave në largësi dhe paraqet shembuj të zbatimit të tij,</p> <p>-përkufizon peshën e trupit me ndihmën e ligjit të dytë të Njutonit si forcë me të cilën Toka vepron në të gjithë trupat në afërsi të sipërfaqes së saj, (<math>F_g = mg</math>),</p> <p>-njehson vlerën numerike të punëve të shprehur në xhul ( J ), nga sipërfaqet e këndrejtve në grafikun <math>F(N)/s(m)</math> të fituara për vlera të ndryshme të forcave konstante dhe rrugëve të ndryshme s,</p> <p>-përcakton formulën për energji kinetike me ndihmën e sipërfaqes nën gjysmëdrejtzën <math>a</math> për kohë të caktuar <math>t</math>, në grafikun <math>v/t</math> (rruga <math>s</math>) dhe ligjit të dytë të Njutonit,</p> <p>-demonstron zgjatjen e sustës elastike në varësi të peshave të varura dhe përcakton punën e forcës elastike në distancë <math>x</math>, nga sipërfaqja nën gjysmëdrejtzën <math>k</math> në grafikun <math>F / x</math>,</p> <p>-paraqet formulën e përgjithshme të lidhmërisë së punës me energji dhe e zbaton për lidhmëri me energji potenciale gravitacionale, energji kinetike dhe energji potenciale elastike,</p> <p>-verteton se energjia kinetike, energjia potenciale gravitacionale dhe energjia potenciale elastike maten me njësi të punës xhul ( J ),</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për zbatim të ligjit të dytë të Njutonit për lëvizje.</p>
	<p><b>4.Shtypja në Fluide</b></p>	<p><b>I, III</b></p> <p>-tregon shembuj të paraqitjes së shtypjes në natyrë, shkruan formulën e përkufizimit të saj dhe emërton njësinë matëse,</p> <p>-tregon ecurinë e eksperimentit të Toriçelit për përcaktimin e vlerës numerike të shtypjes atmosferike,</p> <p>-vën në dukje zbatimin e ndërrimit të shtypjes atmosferike për parashikim të motit dhe për matje të</p>

		<p>lartësisë mbidetare (altimetri),</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-dallon kuptimet e motit dhe klimës dhe përshkruan vetitë e rrymimit të masave horizontale, vertikale dhe shtjellore të ajrit së bashku me pajisjet përkatëse,</li> <li>-shpjegon orientimin e hulumtimeve shkencore për shfrytëzimin e fuqisë së erës si resurs energjetik,</li> <li>-përfiton formulën e ndërrimit të shtypjes me thellësi në lëngun me dendësi të dhënë dhe analizon madhësitë e saj të përmbledhura si paradoksi hidrostatik,</li> <li>-demonstron përhapjen të shtypjes në lëngje njësoj në të gjitha drejtimet dhe tregon shembuj të zbatimit,</li> <li>-demonstron vlerën e forcës së shtypjes në trup të zhytur në lëng dhe analizon konditat e pluskimit, lundrimit dhe fundosjes së tij,</li> <li>-demonstron matjen e shtypjes së gazit në enë të mbyllur me manometer të hapur dhe paraqet lloje tjera të pajisjeve,</li> <li>-tregon në gypin rrjedhës raportet proporcionalisht të drejta të shtypjes me sipërfaqet e seksioneve dhe proporcionalisht të zhdrejta me shpejtësitë e rrymimit të fluidit të pangjeshëm,</li> <li>-nxjerr përfundime për burimet e ndotjes së ajrit, ujit dhe trolit dhe pasojat në shëndetin e njeriut bimëve dhe kafshëve,</li> <li>-zgjidhë detyra numerike për shtypje në fluide.</li> </ul>
	<p><b>5. Lëvizjet rrethore</b></p>	<p><b>I.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-përkufizon radianin si njësi të matjes së këndit dhe lidhmërinë e tij me shkallën këndore,</li> <li>-dallon lëvizjet rrethore nga lëvizjet drejtvizore dhe përcakton rrugën, shpejtësinë dhe lidhjen me shpejtësi lineare,</li> <li>-përfiton shprehjen për intensitet të forcës centripetale dhe centrifugale dhe tregon se bëhet fjalë për forca të natyrës së ndryshme,</li> <li>-zgjidhë detyra numerike për lëvizje rrethore dhe forca centripetale e centrifugale.</li> </ul>
		<p><b>I, IV.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-emërton konceptet themelore që rezultojnë nga analiza e lëvizjes së trupit lëkundës,</li> <li>-përcakton periodën e lëkundjeve të vogla të lavjerrësit matematik,</li> <li>-demonstron përcaktimin e nxitimit të rëndësës nga formula e periodës së lavjerrësit,</li> </ul>

	<b>6. Lëkundjet dhe valët</b>	<p>-demonstron lëkundjet e shuara të trupit lëkundës, me zvogëlimin i amplitudave të tij në mjedise,</p> <p>-përshkruan lëkundjet e detyruara dhe demonstron rezonancën gjatë përhapjes së zërit nga dy rezonatorë të vendosur përballë njeri tjetrit,</p> <p>-dallon valët sipas drejtimit të lëkundjes të grimcave ndaj drejtimit të përhapjes dhe ilustron formën valëve të zërit,</p> <p>-paraqet karakteristikat e valës transverzale me shqyrtimin e lëkundjes së peshës të varur në sustë,</p> <p>-demonstron përhapjen e valëve mekanike (të zërit) në mjedise të tri gjendjeve aggregate,</p> <p>-përfiton formulën e shpejtësisë së përhapjes së valës me ndihmën e karakteristikave të saj,</p> <p>-demonstron zbatimin e parimit të Hajgensit për shpjegimin e thyerjes dhe reflektimit të valëve,</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për lëkundje dhe vale,</p>
	<b>7. Energjia e nxehhtësisë</b>	<p><b>IV.</b></p> <p>-vën në dukje ndërtimin grimcor të lëndës, energjinë e brendshme dhe ecuritë e ndërrimit të saj,</p> <p>-tregon lidhjen e shkallës së Celciusit me shkallën e Kelvinit dhe lloje të termometrave për matje të temperatures,</p> <p>-demonstron zvogëlimin e dukshëm të temperaturës së shkrirjes së akullit nën veprimin e shtypjes dhe shpjegon arësyen e ndodhjes së këtij efekti,</p> <p>-përkufizon temperaturën e trupit nga aspekti grimcorë i ndërtimit të lëndës, kurse sasinë e nxehtësisë <math>Q</math> si vlerë numerike për energji të brendshme <math>\Delta U</math> të dhënë apo të marrë në procese termike,</p> <p>-demonstron me kalorimetër kuptimin e baraspeshimit temik <math>\tau</math> të dy lëndëve si gjendje e ndërprerjes së kalimit të energjisë së brendshme nga lënda e nxehtë në të ftoftë,</p> <p>-analizon madhësitë e përkufizimit të sasisë së nxehtësisë <math>Q</math> që merr ndonjë lëndë duke u nxehur apo e jep duke u ftofur dhe përkufizon termokapacitetin specifik.</p> <p>-paraqet njësinë matëse të sasisë së nxehtësisë në sistemin SI, të njësisë së vjetër që akoma është në përdorim dhe të termokapacitetit specifik,</p> <p>-paraqet mjedisin bartës të nxehtësisë gjatë konduksionit, konveksionit dhe rrezatimit,</p> <p>-interpretion mundësinë e shndërrimit të punës në nxehtësi dhe në trajta tjera të energjisë dhe anasjelltas.</p> <p>-shpjegon ligjin e përgjithshëm të ruajtjes së energjisë termike,</p>

		<p>-përshkruan ligjin e zgjatjes së shufrës metalike me zmadhimin e temperaturës,          -demonstron bymimin e trupit të ngurtë dhe ndërrimin e dendësisë së tij, gjatë zmadhimit të temperaturës.          -zgjidhë detyra numerike për sasi të nxehtësisë, temperaturë dhe baraspeshim termik.</p>
	<p><b>8. Ligjet e gazeve ideale</b></p>	<p><b>I, IV.</b>          -dallon vetitë themelore të ndërtimit grimcorë të lëndës së gaztë nga e lëngëta dhe përshkruan parametrat e gjendjes,          -dallon vetitë e gazeve ideale nga vetitë e gazeve reale,          -përshkruan kuptimin e ligjit të Bojl-Marjotit për zmadhimin e shtypjes së gazit në enë të mbyllur gjatë zvogëlimit të vëllimit të tij, duke i mbajtur temperaturën konstante.          -demonstron ligjin e Bojl-Marjotit për gazin në enë të mbyllur, shënon formën analitike të tij dhe vizaton në grafikun <math>p/V</math> izotermën <math>T = \text{konst}</math>,          -shpjegon kuptimin e ligjit të Gej-Lysakut për zmadhimin e vëllimit së gazit në enë të mbyllur gjatë zmadhimit të temperaturës së tij duke i mbajtur shtypjen konstante.          -demonstron ligjin e Gej-Lysakut, për gazin në enë të mbyllur, shënon formën analitike të tij dhe vizaton në grafikun <math>V/t</math> izobaren <math>p = \text{konst}</math>,          -prezanton kuptimin e ligjit të Sharlit për zmadhimin e shtypjes së gazit në enë të mbyllur gjatë zmadhimit të temperaturës së tij duke i mbajtur vëllimin constant,          -demonstron ligjin e Sharlit, për gazin në enë të mbyllur, shënon formën analitike të tij dhe vizaton në grafikun <math>p/t</math> izohoren <math>V = \text{konst}</math>,          -zbaton lidhjen mes shkallëve të Celciusit dhe të Kelvinit për formulimin e trajtës tjetër matematike të ligjit të Gej-Lysakut dhe ligjit të Sharlit,          -zgjidhë detyra numerike për ligjet e gazeve ideale. (</p>

## Udhëzime metodologjike

Planifikimi me kohë dhe i detajuar i mësimit të shkencave të natyrës, bazohet në këkesat e KK-së dhe KB-së, është hap me rëndësi të veçantë, që duhet të zbatohet me anë të një metodologjie të mësimdhënies.

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore - fizikë, qoftë mbrenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve, stilet e të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkenca eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndën e fizikës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithë përfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen qasje metodologjike si më poshtë:

- Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në lëndën e fizikës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave. Metodatat që mund të përdorin në lëndën e fizikës janë:

- vëzhgimin,
- metodatat eksperimentale dhe analitike
- formimin e një ideje (hipoteze)

- përdorimin e TIK-ut.
- Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

**Metoda e vëzhgimit.** Metoda e vëzhgimit është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi.

**Metoda eksperimentale.** Metoda eksperimentale fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura.

Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre. Projektet. Projektet janë veprimtari të nxëni nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

**TIK** Teknologjia e informacionit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënit të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë. Arsimitari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

**Edukimi për media-** I referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

**Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**- I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm. Për më shumë shih Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

## **Udhëzime për vlerësim**

Zbatimi i programit mësimor, është i pamundur pa komponentën e vlerësimit të nxënësit. Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësit/es gjatë procesit të të nxënës dhe nxjerrja e gjykimit për ato arritje.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësit/es dhe motivimit të tij/saj për të nxënë;
- Vlerësimit të punës praktike dhe demonstruese.
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënës;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësit/es gjatë procesit të të nxënës;
- Vetëvlerësimit të nxënësit/es ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

**Vlerësimi i brendshëm**-Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel klase nga mësimdhënësi/et e lëndëve mësimore përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave e kritereve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluar me akte nënligjore.

Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm është mbështetja e të nxënësve për zotërimin e kompetencave të shkallëve të caktuara. Kjo arrihet duke kombinuar vlerësimin formativ (për nxënie) me vlerësimin përmbledhës (i të nxënës). Llojet e vlerësimit të brendshëm Korniza e Kurrikulës përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm të cilat janë të vlefshëm edhe për realizimin e KB:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë.

•

### **Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin:**

1. Vlerësimin formativ (vlerësimi për të nxënë)

## 2. Vlerësimin përmbledhës (vlerësimi i të nxënësve)

1. Vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënësve) kryhet në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e informacioneve të arritjeve të nxënësve gjatë çdo veprimtarie mësimore, me qëllim të përkrahjes së nxënësve.

1.1 Vlerësimi diagnostikues - përdoret për marrjen e informacioneve të arritjes së nxënësve për shkallën e përvetësimit të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave dhe i ndihmon mësimdhënësit në punën e mëtejshme.

1.2 Vlerësimi motivues - përdoret për nxitjen e interesimit dhe dëshirën e nxënësve/es për të nxënë.

1. Përmes vlerësimit formativ (për nxënësve), mësimdhënësi/ja vlerëson, mbikëqyrë përparimin e nxënësve/es gjatë procesit të të nxënësve, mbledhë informacion për marrjen e vendimeve për të ofruar mbështetje të nevojshme për të nxënësve e nxënësve/es.

2. Ndërsa, me ndihmën e vlerësimit përmbledhës (vlerësimi i të nxënësve), mësimdhënësi/vlerësuesi përcakton arritjet e nxënësve në përfundim të një detyre të caktuar, teme mësimore, kapitulli, periudhe mësimore etj., për të vendosur notat dhe për të vlerësuar nxënësve/sen për nxënësve të mëtejshme.

Vlerësimi përmbledhës përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënësve ose të programit mësimor. Në këtë kontekst p.sh në lëndën e fizikës, në fund të çdo detyrë (periudhë të cilën e përcakton mësimdhënësi; një mujore, detyrë, tremujore), mund të organizohen procedura vlerësimit për pjesë të ndryshme të lëndës për të parë sa kanë nxënësve ose sa kanë zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e ndryshme .

Vlerësimi përmbledhës bëhet me notë, duke përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme vlerësimi si: përgjigjet me gojë, me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, vetëvlerësimi, teste, etj.

Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi/ja është i/e pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit.

Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve/es, prindërve dhe komunitetit.

•

### **Vlerësimi përfundimtar:**

1 Përfshin vlerësimin në fund të çdo periudhe mësimore e përcaktuar me kalendarin shkollor, sipas MASHT-it (përfundimi i tremujorit të I-rë, II-të dhe III-të). Vlerësimi përfundimtar nënkupton përmbledhjen e vlerësimeve përmbledhëse brenda një tremujori.

2 Vlerësim përfundimtar, quhet dhe vlerësimi i cili realizohet në fund të vitit shkollor, që nënkupton përmbledhjen e tre tremujorëve të paraparë me kalendarin shkollor, i miratuar nga MASHT-i.

•

### **Vlerësimi për shkallë – Realizohet në fund të**

shkallës kurrikulare. Mësimdhënësit/et e shkencave natyrore



– Fizika 8, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumente të vlerësimit, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard, të jetë i specifikuar bazuar në kritere, i hartuar nga vetë mësimdhënësit/et, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve ) në harmoni me planin vlerësues të shkollës brenda kornizave të planit vlerësues nivel DKA-ve dhe UA i miratuar nga MASHT-i.

Gjykuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi/ja vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim, rishikim të kritereve të përdorura gjatë vlerësimit, të rizgjedhë instrumente të vlerësimit, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi/ja harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësit/es, i cili plan duhet të miratohet nga të gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësi/ja dhe prindërit) të jetë transparent dhe të ju shpërndahet gjitha palëve të interesuara. Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:

- Vlerësimi me shkrim
- Vlerësimi me gojë
- Vlerësimi me anë të dëgjimit
- Vlerësimi praktik
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve
- Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në teren
- Testimi - është ecuria e matjeve sipas një qëllimi të caktuar

Ekzistojnë lloje të ndryshme të testeve, si:

- Testet me përgjigje alternative
- Testet me kombinime
- Testet me alternativa të shumta
- Testet me përgjigje të shkurtëra dhe me plotësim

Vlerësimi duhet të jetë:

- I vlefshëm, transparent, i besueshëm, i paanshëm

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin e kompetencave në lëndën Fizika 8, është e domosdoshme të krijohet një mjedis mësimor i përshtatshëm. Mësimdhënësi mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuara dhe parimeve të KK-së. Më poshtë paraqitet një listë përmbledhëse e materialeve, burimeve dhe mjediseve të domosdoshme për realizimin e programit të kësaj lënde.

- Teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesional, materiale tekstuale, etj,
- Tabelë shkrimi, postera, fotografi, modele, makete etj,
- Mjedise mësimore,si: klasa, laboratore, kabinetet e punës, natyrë, ferma etj,
- Sugjerime për përdorimin e TIK-ut,
- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni,
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqe(website) të shkencës dhe teknologjisë, video eksperimente, programe interaktive,
- Zhvillimi i eksperimenteve me ndihmën e kompjuterit etj.

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Biologji**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

## Hyrje

Klasa 8-të paraqet fillimin e shkallës IV-të të arsimit parauniversitar. Në këtë shkallë nxënësit kalojnë në nivelin e përforcimit të njohurive dhe shkathtësive si dhe orientimit të tyre. Referuar dokumentit KB, si dhe RNF-ve për këtë shkallë kurrikulare, nxënësit zgjerojnë, gjegjësisht përforcojnë informacionet nga shkencat e natyrës, duke hyrë në konsolidim të koncepteve bazë. Sigurisht se programi i klasës 8-të, paraqet allkë të pashkëputshme me shtrirjen e programit nga klasa VII-të duke pasë parasysh lidhmërin që do krijohet me klasën IX-të. Biologjia në klasën e 8-të kontribuon mjaft shumë në arritjen e rezultateve të kompetencave të nxënësve për shkallën e IV-të, kompetenca këto të parapara me Kurrikulen Bërthame. Programi për klasën 8-të mundëson që gjatë mësimdhënies, të thellohet në përmbajtje shkencore duke hulumtuar ndërtimin dhe funksionimin e niveleve strukturore të qenieve të gjalla (qelizë, ind, organ, sisteme organeve) si dhe bënë krahasimin e grupeve të ndryshme të qenieve të gjalla në kontekstin e biodiversitetit. Poashtu gjatë mësimdhënies, tani mund të hulumtohet edhe në mosfunksionim të strukturave ndërtuese në nivele të ndryshme, si dhe mënyrat e kontrollit të tyre, që në të vertetë paraqet semundjet e ndryshme.

Programi, Biologjia 8 - përmban rezultate të të nxënësve për lëndë (RNL), sipas temave:

- Biologjia e qelizës,
- Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve,
- Indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazëve,
- Ushqimet e njeriut.

Detyrë e mësimin të biologjisë është: Përforcimi i aftësive hulumtuese dhe të menduarit kritik që në realitet është një formë e sofistikuar e të integruarit mes përmbajtjeve shkencore dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve, që në të vertetë parashihet në konceptin dhe filozofinë e Kornizës Kurrikulare të Kosovës.

Baza e lëndës mësimore Biologjia 8, qëndron në krahasimin e strukturave ndërtuese të qenieve të gjalla (biodiversitetit), funksionimin e këtyre strukturave si dhe mënyrat e kontrollit të tyre në rast sëmundjeve.

Zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një ecurie të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, parashtrimi i rezultateve të të nxënësve për kompetenca, rezultateve të të nxënësve të fushës së shkencave natyrore si dhe përzgjedhja e metodave dhe instrumentave të qëndrueshëm për vlerësim.

Aplikimi i qasjeve dhe i strategjive të reja të mësimdhënies zhvillojnë te nxënësi prirje për zbatim dhe ndërlidhje me botën reale, hapin dyert për orientim të ardhshëm profesional në lëmin e mjekësisë, të veterinës, të bujqësisë etj

## Qëllimi

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për kl. 8 – të ka për qëllim:

- Përforcimin e aftësive të nxënësit për të hulumtuar, krahasuar dhe krijuar mendim kritik mbi ligjshmëritë themelore të funksionimit, organizimit, ndërtimit dhe zhvillimit të botës së gjallë.
- Përforcimin e mendimit kritik për biodiversitetin e qenieve të gjalla dhe aftësive për të vlerësuar rolin e tij në ruajtjen e qenive të gjalla, si dhe kontrollin e baraspeshës ekologjike në natyrë.
- Përforcimin e mendimit kritik për shkaktarët e sëmundjeve dhe mekanizmat kontrollues të bimëve, shtazëve dhe njeriut.
- Kontribuim në arritjen e kompetencave:
  - për komunikim shkencor, përmes prezentimit të dhënave relevante shkencore
  - për mendim kritik, përmes përpunimit e të dhënave relevante shkencore
- Kontribues produktiv, përmes zbatimit të njohurive të fituara konkrete për të mirën e njeriut dhe të mjedisit. Etj.
- Hulumtim dhe përzgjedhje të burimeve informative për mbrojtje nga sëmundjet seksuale qofshin transmetuese apo jo.
- Zhvillim të debateve publike dhe konsultim me persona apo institucione shendetësore që trajtojnë sëmundjet seksuale.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Analizuar lidhjen vertikale të programeve lëndore, nga klasa në klasë gjegjesisht nga shkalla e III-të kurrikulare në shkallë e IV-të kurrikulare, mbi bazën e konceptit “Bota e gjallë” janë hartuar RNF për shkallë kurrikulare, dhe janë nxjerrë temat mësimore. Duke respektuar këto RNF (dokumentin KB niveli II), në klasën e 8-të, përtej koncepteve (qelizë, ind, organ, sistem organeve) punohet në hulumtim shkencor mbi llojet, ndërtimin, funksionimin dhe dëmtimin e strukturave ndërtuese të qenieve të gjalla. Poashtu, gjatë klasës së 8-të punohet në krahasimin shkencor të mbretërive të botës së gjallë, si në aspektin morfologjik ashtu edhe anatomik dhe fiziologjik.

Programi lëndor paraqet referencën për hartimin e përmbajtjeve mësimore, lëndës biologjia 8.

Përmbajtja e programit lëndës Biologjia 8, njëkohësisht qëndron në filozofin e KK-së, duke ruajtur autonomin e mësimdhënësit që në kontekst të shkollës/nxënësit të hartojë rezultate më specifike për orë mësimore.

<b>Koncepti</b>	<b>Temat</b>	<b>RNF</b> Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke ju referuar biodiversitetit të qenjeve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla
		Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara
<b>Bota e gjallë</b>	Biologjia e qelizës	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b> -Hulumton ndërtimin dhe përshkruan funksionin e qelizës, -Në bazë të vrojtimit dallon qelizën bimë nga ajo shtazore, -Krahason qelizat prokariote ,me ato eukariotë, -Emërton pjesët ndërtuese qelizore nga fotografia, skema, skica etj, -Shpjegon për pjesët kryesore të qelizës (murin, membranën, berthamen, mitokondritë, ribosomet), -Shpjegon se në qelizë vazhdimisht kryhet shkëmbimi i materies dhe energjisë, -Shpjegon se nga qelizat formohen indet, nga indet organet dhe nga organet formohen sistemet e organeve, -Argumenton unitetin e botës së gjallë dhe jo të gjallë nëpërmjet njohjes së përbërjes kimike të qelizës dhe veçorive fiziko-kimike të saj, -Zbaton teknikat laboratorike në bazë të punës vetanake, -Dallon membranën qelizore nga muri qelizor.
		Indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazët

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Emërton indet kryesore shtazore, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre,</li> <li>- Prshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme,</li> <li>- Shpjegon se organizmat janë në gjendje të mirëmbajnë mjedisin e brendshëm të tyre nga infeksionet, ndotësit etj,</li> <li>- Analizon ç' do të ndodh nëse një organ nuk funksionon, çrregullohet puna e tij ose e humb funksionin,</li> <li>- Zbaton terminologjinë korrekte anatomike, kur shqipton topografinë e pjesëve të trupit të jokurrizorëve dhe të kurrizorëve,</li> <li>- Identifikon organet që janë të përbëra nga muskujt e lëmuar, përkatësisht nga muskujt e strijuar,</li> <li>- Emërton pjesët kryesore të sistemit tretës dhe të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e tyre,</li> <li>- Emërton disa çrregullime në zhvillimin e organeve të tretjes si dhe sëmundjet më të shpeshta të sistemit tretës,</li> <li>- Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e zemrës dhe të enëve të gjakut, përkatësisht sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut,</li> <li>- Emërton dhe të përshkruan disa sëmundje të gjakut, të zemrës dhe të enëve të gjakut,</li> <li>- Përshkruan si kryhet transfuzioni i gjakut dhe si caktohen grupet e gjakut të sistemit ABO,</li> <li>- Numëron disa sëmundje imunologjike dhe të përshkruajë si shfaqen ato,</li> <li>- Emërton rrugët e frymëmarrjes, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre,</li> <li>- Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore, branshiale dhe trakeidale si dhe rregullimin e saj,</li> <li>- Krahason këmbimin e gazrave në alveole dhe në qelizë,</li> <li>- Emërton disa sëmundje që barten nëpërmjet të ajrit dhe vlerëson pasojat e pirjes së duhanit dhe ajrit të ndotur për rrugët e frymëmarrjes,</li> <li>- Përshkruan si kryhet masazhi i zemrës, frymëmarrja artificiale dhe reanimimi,</li> </ul>
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Definon termin tajitje dhe të emërtojë organet kryesore për tajitje te grupet e ndryeshme të shtazëve,</li> <li>- Emërton pjesët e veshkës, që duken në prerje tërthore dhe të përshkruajë funksionin e tyre,</li> <li>- Identifikon pjesët e nefronit dhe të përshkruajë procesin e formimit të urinës,</li> <li>-Emërtojë strukturat nëpër të cilat rrugëton urina prej veshkës deri në mjedisin e jashtëm,</li> <li>- Numron disa sëmundje të organeve për tajitje,</li> <li>-Identifikon dhe shpjegon mbështjellësin trupor të grupet e ndryeshme të shtazëve,</li> <li>- Emërtojë derivatet e lëkurës,</li> <li>- Shpjegon rolin mbrojtës të mbështjellësit trupor grupeve të shtazëve dhe rolin termorregullues të lëkurës,</li> <li>- Vlerëson rolin e higjienës së lëkurës (posaçërisht të duarve) për të evituar sëmundjet e sistemit tretës,</li> <li>- Përshkruan strukturën e qelizës nervore dhe rolin e trupit të neuronit, dendriteve dhe neuritit,</li> <li>- Numëron dy karakteristika themelore të sistemit nervor, (ngacmueshmëria, përcjellshmëria) dhe të përshkruajë si bëhet transmetimi i sinjalit,</li> <li>- Klasifikon sistemin nervor te grupet e caktuara të shtazëve,</li> <li>- Përshkruan rolin biologjik të trurit dhe të palcës kurrizore,</li> <li>- Paraqet shembuj dhe të argumentojë se palca kurrizore është qendër e veprimeve reflektore pa ndërmjetësim të trurit (refleksi i gjurit),</li> <li>- Përshkruan ndërtimin e shqisë së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore dhe të analizojë funksionin e tyre,</li> <li>- Arsyeto funksionin mbrojtës të shqisë për nuhatje dhe shije,</li> <li>- Përshkruan si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksione të caktuara nëpërmjet hormoneve,</li> <li>- Emërton hormonet më të rëndësishme të gjëndrave endokrine dhe të përshkruajë rolin fiziologjik të tyre,</li> <li>- Emërton disa sëmundje që shfaqen si pasojë e çrregullimit të funksionit të sistemit endokrin,</li> </ul>
--	--	--



		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e gjëndrave seksuale te grupeve të ndryshme shtazore,</li> <li>-Shpjegon mënyrat e shumimit të grupeve të ndryshme shtazore,</li> </ul>
	<p>Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e indeve dhe organeve</li> <li>përshkruan veçoritë themelore të bimëve duke u bazuar në ndërtimin e indeve dhe organeve,</li> <li>-Emërton dhe dallon indet dhe organet e specializuara të bimëve</li> <li>përshkruan strukturat që mundësojnë përcjelljen e materieve te bimët vaskulare (enëzore),</li> <li>-Përshkruan ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme,</li> <li>- Shpjegon çka do të ndodhë nëse një organ nuk funksionon,</li> <li>-Interpreton efektin e faktorëve të mjedisit ( dritës, gravitacionit etj.) në rritje, zhvillim dhe lëvizje të bimëve si dhe analizon mekanizmat si shfaqen këto ndryshime nën ndikimin e faktorëve të mjedisit,</li> <li>-vërteton cila pjesë e kërcellit e përcjellë ujin deri në gjethe,</li> <li>- Demonstron fototropizmin dhe gjeotropizmin te bimët,</li> <li>- Shpjegon pse fiernat u përkasin bimëve të larta,</li> <li>-Analizon ciklin e zhvillimit të fiernave, të farëzhveshurave dhe farëveshurave,</li> <li>-Identifikon dallimet thelbësore sa i përket ndërtimit të lules së bimëve farëzhveshura dhe farëveshura,</li> <li>-Analizon veçoritë në bazë të së cilave dallohen bimët monokotiledone dhe dikotiledone dhe klasifikon disa prej tyre deri në nivel të familjes,</li> <li>- Shpjegon si formohet fryti dhe dallon llojet e fryteve,</li> <li>- Emërton disa lloje bimore sipas vlerave përdoruese,</li> <li>- Shpjegon rëndësinë e frytnimit artificial për fisnikërimin e bimëve,</li> <li>-Krahason ndërtimin e organeve vegetative (p.sh. kërcellit) të bimëve njëthelbore dhe dythelbore,</li> <li>-Definon termat polenizim, frytnim, farë, fryt,</li> <li>-Krahasojnë se cilave qeliza të ciklit të zhvillimit të</li> </ul>

		fiernave i përgjigjen kokërrzat e polenit.
	Ushqimet e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon përbërset e ushqimit,</li> <li>- Shpjegon rolin dhe rendësin e përbërseve të ushqimit,</li> <li>- Emërton lloje të vitaminave, dhe identifikon ushqime më përbërje vitaminoze,</li> <li>- Shpjegon pasojat e ushqyeshmërisë jo të rregullt,</li> <li>- Hulumton informacione për dietë,</li> <li>- Diskuton për rregullat e ushqyeshmërisë në fazën e pubertetit,</li> <li>- Identifikon dhe shpjegon për ushqimet jo të shëndëtshme.</li> </ul>
	Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon ndërtimin dhe funksionin e organeve riprodhuese dhe kupton proceset si menstruacioni, spermatogjenezën, ovulimin dhe fertilizimin,</li> <li>- Përshkruan metodat tradicionale dhe moderne kontraceptive,</li> <li>- Diskuton ndikimin e alkoolit dhe drogave në sjelljen e vendimeve të përgjegjshme,</li> <li>- Kupton rendësin, mënyrat e vetëkontrollit të trupit dhe dine ku duhet të drejtohet për të marr këshilla dhe ndihme.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të programit për lëndën mësimore Biologjia 8, udhëzohet që të përdoren metodologji të përshtatshme në kontekste dhe rrethanave të ndryshme si: punë në klasë, jashtë klase, konstruktiviste, projekte etj.

Poashtu udhëzohen mësimdhënësit që të hartojnë dhe zbatojnë planin e aktiviteteve jashtëkurrikulare në interes të kontribuimit të arritjes së rezultateve lëndore të përshkruara në programin lëndor.

Përzgjedhja e metodave mbetet kompetencë e mësimdhënësit, bazuar në parimet e arsimit parauniversitar, gjë e cila imponon përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësit, me natyrën e përmbajtjeve të njësive mësimore gjegjësisht me kërkesat e rezultateve të pritura të të nxënësit për orë mësimore apo aktivitete tjera mësimor, në harmoni me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësit/ës dhe kompetencat e synuara.

Nxënësi në klasën e 8-të, merr përgjegjësi për të punuar në hulumtim dhe eksperiment. Prandaj, preferuar që ligjshmëritë shkencore, aty ku është e mundur, të punohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment, kurse mësimdhënësi të ketë rol përkrahës.

Zhvillimi i nxënësit/es përmes shkencave të natyrës – Biologjia 8, varet jo vetëm nga përmbajtjet mësimore, jo vetëm nga përkrahja e mësimdhënësit, por në radhë të parë nga vetë angazhimi i tij/saj, ku për këtë nevojitet motivimi, përfshirja në punë, ngritja e hipotezave, kontestimi me argumente, etj. Këtu shihet roli i mësimdhënësit si krijues/ofruar i hapsirës ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Sugjerohen metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

### **Format e punës**

- individuale,
- në çifte,
- në grupe të vogla,
- me të gjithë nxënësit.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Përmes temave ndërkurrikulare kontribuohet mjaftueshëm në zhvillimin e temave kurrikulare, dhe atë jo si të izoluara vetëm për një lëndë mësimore apo një fushë të caktuar kurrikulare, por për disa sosh. Gjithashtu temat ndërkurrikulare kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave, respektivisht rezultateve të të nxënësve për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimi për paqe, të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, edukimin për karrierë dhe aftësitë për jetë.

### **Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?**

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në Kurrikulën shkollore përmes përmbajtjeve shkencore të organizuara me strukturë normative dhe të zbatueshme përmes aktiviteteve praktike në klasë, jashtë klase, projekte të veqanta, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën shkollore të shkencave natyrore për këtë shkallë kurrikulare gjegjësisht për klasën 8-të, janë të njëjta me temat që janë trajtuar në shkallën e III-të kurrikulare, por duke u trajtuar në një nivel më të lartë, apo në një hulumtim më të thellë kritik, e këto janë:

Edukimi për media

Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm

#### **Edukimi për media**

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të medieve në procesin e selektimit të informatave relevante, të reja, të sakta. Përpunim dhe prezentim të të gjeturave shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtje lidhur me publikimet shkencore, rolin e tyre, shfrytëzimin e tyre për një jetë me kualitative.

#### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

Në klasën e 8-të, nxënësi/ja, konsolidon qëndrimet dhe parapregatitet për vendimmarrje në karrierë, duke fituar vlera të qarta për një zhvillim tërëjetësor dhe të qëndrueshëm. Nxënësi/ja integron aftësitë dhe shkathtësitë e të hulumtuarit, përdorimit të burimeve,

përzgjedhjes së përmbajtjeve etj, në interes të të qenit pjesë e zhvillimit dhe rrethanave shoqërore ekonomike si në nivel lokal ashtu edhe nivel global.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësit/es gjatë procesit të të nxënës dhe nxjerrja e gjykimit për ato arritje.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësit/es dhe motivimit të tij/saj për të nxënë;
- Vlerësimin të punës praktike dhe demonstruese.
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënës;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësit/es gjatë procesit të të nxënës;
- Vetëvlerësimin të nxënësit/es ;
- Përmirësimin të mësimdhënies dhe të nxënies.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

### **Vlerësimi i brendshëm**

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel klase nga mësimdhënësi/et e lëndëve mësimore përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave e kritereve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore. Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm është mbështetja e të nxënësit të nxënësve për zotërimin e kompetencave të shkallëve të caktuara. Kjo arrihet duke kombinuar vlerësimin formativ (për nxënie) me vlerësimin përmbledhës (i të nxënësit).

Llojet e vlerësimit të brendshëm:

Korniza e Kurrikulës përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm të cilat janë të vlefshëm edhe për realizimin e KB:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë.

➤ Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin:

- 1.Vlerësimin formativ (vlerësimi për të nxënë)
- 2.Vlerësimin përmbledhës (vlerësimi i të nxënësit)

1. Vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë) kryhet në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e informacioneve të arritjeve të nxënësve gjatë çdo veprimtarie mësimore, me qëllim të përkrahjes së nxënësve.

1.1 Vlerësimi diagnostikues - përdoret për marrjen e informacioneve të arritjes së nxënësit për shkallën e përvetësimit të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave dhe i ndihmon mësimdhënësit në punën e mëtejshme.

1.2 Vlerësimi motivues - përdoret për nxitjen e interesimit dhe dëshirën e nxënësit/es për të nxënë.

Përmes vlerësimit formativ (për nxënie), mësimdhënësi/ja vlerëson, mbikëqyrë përparimin e nxënësit/es gjatë procesit të të nxënit, mbledhë informacion për marrjen e vendimeve për të ofruar mbështetje të nevojshme për të nxënit e nxënësit/es.

2. Ndërsa, me ndihmën e vlerësimit përmbledhës (vlerësimi i të nxënit), mësimdhënësi/vlerësuesi përcakton arritjet e nxënësit në përfundim të një detyre të caktuar, teme mësimore, kapitulli, periudhe mësimore etj., për të vendosur notat dhe për të vlerësuar nxënësin/sen për nxënie të mëtejshme. Vlerësimi përmbledhës përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënit ose të programit mësimor. Në këtë kontekst p.sh në lëndën e biologjisë, në fund të çdo dymujori (periudhë të cilën e përcakton mësimdhënësi; një mujore, dymujore, tremujore), mund të organizohen procedura vlerësimit për pjesë të ndryshme të lëndës për të parë sa kanë nxënë ose sa kanë zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e ndryshme në lëndën e biologjisë.

Vlerësimi përmbledhës bëhet me notë, duke përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme vlerësimi si: përgjigjet me gojë, me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, vetëvlerësimi, teste, etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënit. Mësimdhënësi/ja është i/e pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësit/es, prindërve dhe komunitetit.

➤ **Vlerësimi përfundimtar:**

1 Përfshin vlerësimin në fund të çdo periudhe mësimore e përcaktuar me kalendarin shkollor, sipas MASHT-it (përfundimi i tremujorit të I-rë, II-të dhe III-të). Vlerësimi përfundimtar nënkupton përmbledhjen e vlerësimeve përmbledhëse brenda një tremujori.

2 Vlerësim përfundimtar, quhet dhe vlerësimi i cili realizohet në fund të vitit shkollor, që nënkupton përmbledhjen e tre tremujorëve të paraparë me kalendarin shkollor, i miratuar nga MASHT-i.

➤ Vlerësimi per shkallë – Realizohet në fund të shkallës kurrikulare.

Mësimdhënësit/et e shkencave natyrore – Biologjia 8, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumente të vlerësimit, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard, të jetë i specifikuar bazuar në kritere, i hartuar nga vetë mësimdhënësit/et, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve ) në harmoni me planin vlerësues të shkollës brenda kornizave të planit vlerësues nivel DKA-ve dhe UA i miratuar nga MASHT-i.

Gjykuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi/ja vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim, rishikim të kritereve të përdorura gjatë vlerësimit, të rizgjedhë instrumente të vlerësimit, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi/ja harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësit/es, i cili plan duhet të miratohet nga të gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësi/ja dhe prindërit) të jetë transparent dhe të ju shpërndalet gjitha palëve të interesuara.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:

- Vlerësimi me shkrim
- Vlerësimi me gojë
- Vlerësimi me anë të dëgjimit
- Vlerësimi praktik
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve
- Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në teren
- Testimi - është ecuria e matjeve sipas një qëllimi të caktuar

Ekzistojnë lloje të ndryshme të testeve, si:

- Testet me përgjigje alternative
- Testet me kombinime
- Testet me alternativa të shumta
- Testet me përgjigje të shkurtëra dhe me plotësim

Vlerësimi duhet të jetë:

- I vlefshëm
- I besueshëm
- I paanshëm

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të programit Biologjia 8, është e nevojshme të shfrytëzohen materiale dhe mjete të ndryshme mësimore, në mjedis të përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi, etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

## **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

**Kimi**



## **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## **Hyrje**

Programi lëndor për lëndën kimia 8 është vazhdimësi e të mësuarit të kimisë nga klasa e shtatë, të cilat rrjedhin nga kërkesat e KB për nivelin 2 të domosdoshme për edukimin e nxënësve i cili kërkohet në shekullin 21.

Në këtë klasë nxënësit do të zhvillojnë të mësuarit duke identifikuar, shpjeguar, testuar dhe krahasuar materialet më të rëndësishme për njeriun sot, si dhe rrezukun nga substancat e ndryshme, mënyrën e tyre të veprimit në organizëm, në mjedis si dhe qëndrueshmërinë e tyre për ndërtimtarinë dhe teknologjinë. Nxënësit do të zgjerojnë njohuritë rreth: shpejtësisë së reaksioneve kimike, klasifikimit të elementeve dhe komponimeve inorganike, llogaritjeve të thjeshta kimike, si dhe materialet më të rëndësishme industrial duke përfshi përhapjen, vetitë, përfitimin dhe përdorimin e tyre për qëllime të caktuara.

Krahas mësimit do të zhvillohen edhe shkathësitë hulumtuese të nxënësve përmes punës praktike/eksperimentale apo duke shfrytëzuar mjetet teknologjike.

Programi dhe metodologjia për klasën e 8-të janë në funksion të arritjes së rezultateve të fushës shkencat e natyrës, si dhe arritjen/kontributin në rezultatet e të nxënit për shkallë/kompetencë (shkalla 4).

## **Qëllimi**

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore përmes aktiviteteve të ndryshme të cilat përfshihen në diskutime, punë eksperimentale dhe qasje të ndryshme të hulumtimit të problemeve.
- Zhvillimi dhe kultivimi i shprehive dhe shkathtësive për përdorimin e substancave kimike, mjeteve laboratorike, për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe për mbrojtjen e mjedisit
- Inkurajon nxënësit të transferojnë dhe ndërlidhin njohuritë e tyre në situata të reja nga jeta e përditshme
- Aktivizimi i sa më shumë shqisave (të pamurit, të prekurit, ndëgjimit, shijimit, nuhaturit) për nxënie të qëndrueshme të njohurive.
- Zhvillimi i të menduarit autonom dhe kritik për të kuptuar, shprehur dhe zbatuar fenomenet dhe dukuritë kimike që ndodhin në natyrë dhe në laborator.
- Edukimi i nxënësve, prindërve të tyre dhe komunitetit më të gjerë shkollor për ambientin.
- Zotërimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve shkencore;
- Zhvillimin e shkathtësive për të nxënë gjatë gjithë jetës;

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e tetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së katërt të kurrikulës (Shk 4) në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ultë:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
<b>Materia, vetitë dhe shëndrrimet</b>	<b>RNF:</b> Përshkruan dhe analizon elementet kimike që hyjnë në përbërjen e komponimeve inorganike dhe organike, strukturën e këtyre komponimeve, vetitë fizike e kimike, funksionimin dhe ndërlidhjen e tyre në botën e gjallë dhe jo të gjallë dhe ndikimin e tyre afatgjatë në mjedis.	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	Klasifikimi i komponimeve inorganike	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Klasifikon komponimet inorganike sipas përbërjes dhe vetive të tyre,</li> <li>- Dallon llojet e oksideve në bazë të reaksionit të tyre me ujë dhe produkteve që formojnë,</li> <li>- Identifikon acidet, bazat dhe kripërat në bazë të teorisë së Arrheniusit ,</li> <li>- Shpjegon vetitë dhe përdorimin e acideve dhe</li> </ul>

		<p>bazave</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon nocionet “i fortë” dhe ”i dobët” për acide dhe baza,</li> <li>- Tregon ngjyrat e indikatorëve: letër lakmuesi, metil oranzh, fenolftaleinë dhe ujë lakre e kuqe në tretësira acidike dhe bazike,</li> <li>- Përcakton aciditetin ose bazitetin e tretësirave duke përdorë indikator dhe shkallën pH,</li> <li>- Demonstron vetit acidike ose bazike në një tretësirë duke përdorë indikatorët ose pH – meter,</li> <li>- Identifikon kripërat më të përdorshme dhe i emërton ato,</li> <li>- Tregon si formohen kripërat përmes reaksioneve të neutralizimit.</li> </ul>
	<p>Llojet, kinetika dhe ekuilibri i reaksioneve kimike</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan nocionin e shpejtësisë së reaksioneve kimike,</li> <li>- Metoda të përshtatshme për matjen e shpejtësisë së reaksionit kimik,</li> <li>- Interpretin informatat e fituara për shpejtësinë e reaksioneve gjatë eksperimenteve kimike,</li> <li>- Identifikon faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike,</li> <li>- Përshkruan rolin e katalizatorve,</li> <li>- Tregon rëndësinë e përdorimit të katalizatorëve</li> <li>- Dallon reaksionet e pakthyeshme dhe ato të kthyeshme,</li> <li>- Shpjegon gjendjen e ekuilibrit dinamik me shembuj të thjeshtë,</li> <li>- Shpjegon konceptet oksidim dhe reduktim në reaksione kimike,</li> <li>- Gjen numrat oksidues të elementeve në komponimet e tyre,</li> <li>- Identifikon substancat që oksidohen dhe reduktohen gjatë reaksioneve oksido-reduktuese,</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan procesin e elektrolizës,</li> <li>- Shpjegon ndarjen e substancave në elektroda përmes elektrolizës.</li> </ul>
	Llogaritjet në kimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Spjegov dhe jep shembuj për ligjet themelore të Kimisë,</li> <li>- Definon numrin e Avogadros, molin dhe masën molare,</li> <li>- Llogaritë numrin e moleve nga masa e dhënë dhe anasjelltas,</li> <li>- Llogaritë vëllimin e gazeve në kushte standard</li> <li>- Llogaritë pjesëmarrjen në masë ose në përqinje të elementeve në komponim duke u bazuar në përqinjen e elementëve përbërës,</li> <li>- Gjenë formulën empirike të komponimit duke u bazuar në përqindjen e elementeve përbërëse,</li> <li>- Llogaritë sasinë e reaktantëve dhe të produkteve të reaksionit duke përdorë molin.</li> </ul>
	Klasifikimi i elementeve dhe vetitë e tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërlidh pozitën e elementeve në tabelën periodike me numrin e elektroneve valente dhe niveleve energjetike,</li> <li>- Përcakton nëse një element është metal, jometal apo gjysmëmetal duke përdorë tabelën periodike,</li> <li>- Shpjegon ngjashmëritë e elementeve në kuadër të grupeve përmes shembujve të thjeshtë,</li> <li>- Përshkruan vetitë e përgjithshme të metaleve, jometaleve dhe gjysmëmetaleve,</li> <li>- Përshkruan trendet e vetive të metaleve alkaline (pikat e vlimit dhe shkrirjes, dendësinë, fortësinë dhe reaktivitetin),</li> <li>- Shkruan reaksionet e metaleve alkaline me ujë dhe elemente halogjene</li> <li>- Tregon përdorimin e elementeve alkaline dhe komponimeve të tyre,</li> <li>- Përshkruan trendet e vetive të metaleve alkalino tokësore (pikat e vlimit dhe shkrirjes, dendësinë, fortësinë dhe reaktivitetin),</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkruan reaksionet e metaleve alkalino tokësore me ujë dhe oksigjen,</li> <li>- Tregon përdorimin e elementeve alkalino tokësore dhe komponimeve të tyre,</li> <li>- Krahason vetitë fizike dhe reaktivitetin e metaleve alkaline me ato alkalino tokësore,</li> <li>- Përshkruan vetitë fizike të elementeve halogjene (gjendja agregate, ngjyra, tretshmëria),</li> <li>- Krahason elementet halogjene mes veti dhe me jometalet e tjera për nga reaktiviteti,</li> <li>- Shkruan reaksionet e elementeve halogjene me metale dhe hidrogjen,</li> <li>- Tregon përdorimin e elementeve halogjene dhe komponimeve të tyre,</li> <li>- Shpjegon vetitë dhe rëndësinë e acidit klorhidrik,</li> <li>- Shpjegon përhapjen, vetitë, përfitimin dhe rëndësinë e oksigjenit,</li> <li>- Shpjegon përhapjen, vetitë, përfitimin dhe përdorimin e sulfurit,</li> <li>- Shpjegon vetitë dhe rëndësinë e acidit sulfuric</li> <li>- Përshkruan përhapjen, vetitë dhe përdorimin e azotit,</li> <li>- Tregon vetitë, përfitimin dhe përdorimin e amonjakut dhe acidit nitric,</li> <li>- Dallon modifikimet alotropike të karbonit për nga struktura dhe vetitë e tyre.</li> </ul>
	<p>Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Diskuton problemet dhe përfitimet për shkak të riciklimit të metaleve, letrës dhe plastikës,</li> <li>- Identifikon ndotësit dhe burimet kryesore të ndotjes së ajrit,</li> <li>- Numëron shkaktarët kryesorë të shirave acidike.</li> <li>- Shpjegon ndotjen e ujit dhe metodat e pastrimit të ujërave,</li> <li>- Identifikon ndotësit e tokës dhe ndikimin e tyre në organizmat e gjallë,</li> <li>- Të vlerësojnë ndikimin e ndotësve të ajrit, të ujit dhe të tokës në cilësinë e jetës së njeriut.</li> </ul>

<b>Toka, mjedisi dhe gjithesia</b>	<b>RNF:</b> Analizon përbërësit e ndërtimit të kores së Tokës, resurset natyrore e në veçanti ato të Republikës së Kosovës dhe lidhshmërinë hapësirë-kohë, tregon lëvizjen e dukshme dhe të vërtetë, ndërtimin e sistemit diellor dhe të galaktikave	
	Materialet përbërse të shkëmbinjve	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregon elementet më të rëndësishme që gjenden në koren e Tokës si dhe ato më të përhapura në Kosovë,</li> <li>- Emërton mineralet kryesore që përmbajnë hekur, bakër, alumin, plumb dhe zink,</li> <li>- Tregon mënyrën e përfitimit të metaleve duke përdorë serinë e reaktivitetit të metaleve,</li> <li>- Përshkruan metodën e përfitimit të hekurit në furnaltë,</li> <li>- Shpjegon prodhimin e çelikut dhe përdorimin e tij,</li> <li>- Dallon faktorët që ndikojnë në korrozion dhe sugjeron metoda të përshtatshme për mbrojtje të metaleve,</li> <li>- Përshkruan përfitimin e aluminit nga xehet e tij,</li> <li>- Ndërlidhë përdorimin e gjerë të aluminit me vetitë e tij,</li> <li>- Shpjegon metodën e përfitimit dhe rafinimit të bakrit</li> <li>- Tregon vetitë dhe përdorimin e bakrit,</li> <li>- Shpjegon mënyrën e përfitimit të plumbit dhe zinkut,</li> <li>- Diskuton vetitë, përdorimin dhe mundësitë e ndikimit në ekonominë e vendit.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e kimisë, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL) – paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve por edhe për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar

njera me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndën e kimisë varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, demonstrime, punë me projekte, punë praktike e të tjera.

Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe ti përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare.

Kimia është shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

### **Mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar**

Integrimi i disa temave është i domosdoshën në shkencat e natyrës në mënyrë që nxënësit të arrijnë rezultate sa më të mira. Fenomenet që ndodhin në natyrë nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjesëshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve të shkencave të natyrës por edhe fushave tjera, në mënyrë që tek nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Temat dhe konceptet nga lënda e kimisë që mund të integrohen me lëndë tjera: jonet dhe përcjellshmëria elektrike e acideve, bazave dhe kripërave (me lëndën e fizikës), vetitë dhe rëndësia e metaleve, jometaleve dhe komponimeve të tyre për Tokën dhe botën e gjallë (biologjia, gjeografia, fizika), ndotja e ujit, ajrit dhe tokës (biologjia, gjeografia), përdorimi i llojeve të ndryshme të materialeve sipas vetive të tyre, riciklimi i materialeve (fizika, fusha jeta dhe puna) si dhe tema apo koncepte të tjera të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve për

fushë apo për kompetenca. Paraqitja dhe analiza e rezultateve për këtë klasë kryesisht mund të realizohet përmes TIK-ut dhe llogaritjeve matematike ku integrimi me këto lëndë/fusha është i domosdoshëm.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për medie;
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

### **Edukimi për media**

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të medieve për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësi të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlihet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndorë dhe shkathtësi, vlerave dhe qëndrimeve në shkenca të natyrës.

Metodat e vlerësimit që duhet të përdoren në shkencat e natyrës:

- vlerësimi me gojë (diskutime, debate),
- Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, eseve, raportet e punës),



- Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale,
- Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte,
- Vlerësimi i portfolios,
- Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore,
- Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore, për shkak të specifikave që ka fusha, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere i hartuara nga vetë mësimdhënësit, në harmoni me planin zhvillimor të shkollës, me vendimmarrjen e DKA-ve dhe me politikat e MASHT-it.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit).

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për zhvillim sa më me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atlase etj.

Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, video projektori, kompjuteri, telefoni, tablati etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).

**FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE  
MJEDISI**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Histori

Gjeografi

Edukatë qytetare

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Histori**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Lënda e Historisë për klasën e tetë, luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të nxënësit. Përmes kësaj lënde nxënësi do të njihet me zhvillimet e shoqërisë njerëzore të Periudhës Moderne e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore. Në këtë lëndë trajtohen mënyrat e jetesës dhe organizimit shoqëror, ekonomik, politik, kulturor si dhe bota materiale e shpirtërore përgjatë Mesjetës. Duke trajtuar proceset, fenomenet dhe marrëdhëniet midis individëve, grupeve, shoqërive, shteteve-vendeve dhe civilizimeve përgjatë kësaj periudhe historike, nxënësit do të kuptojnë ndryshimet dhe transformimet në vazhdimësi të shoqërisë njerëzore dhe të mendimit historik.

## Qëllimi

Qëllimi i lëndës, për këtë klasë, është që nxënësi të përfitojë njohuri të duhura për Periudhën Moderne e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore në mënyrë që të krijojë një botkuptim të përgjithshëm për këtë periudhë historike. Gjithashtu, përmes kësaj lënde synohet që gjatë procesit mësimor për ngjarjet, personalitetet e proceset në të gjitha fushëveprimet e rëndësishme të kësaj periudhe historike, tek nxënësi të zhvillohet të menduarit kreativ e kritik, aftësia për të hulumtuar e analizuar dhe zhvillimi i shkathtësive për të përdorë burime të ndryshme informacioni. Njëherazi, lënda ka për qëllim që tek nxënësi të kultivohen vlera, qëndrime e sjellje të një qytetari të përgjegjshëm, i cili do të pranojë dhe respektojë identitetet, përkatësitë dhe diversitetet e ndryshme, si ato: kulturore, fetare, etnike, racore, gjinore, orientimet seksuale, etj

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e tetë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së katërt (Shk 4) në Kurrikulën Bërthamë të Shkollës së Mesme të Ulët.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL
<b>Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</b>	<b>RNF: 1. Njeh strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to.</b>  1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në

	<p>mjedis.</p> <p>1.2. Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë).</p> <p>1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.</p>
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
<b>Personalitete të shquara të periudhës moderne</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon personalitetet të rëndësishme botërore të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.</li> <li>▪ Analizon rolin e personaliteteve të rëndësishme shqiptare të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.</li> </ul>
<b>Arbrit/Shqiptarët dhe Ballkani në Perandorinë Osmane</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon ngritjen e sistemit administrativ osman në trevat arbërore dhe identifikon faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës fetare të arbërve/shqiptarëve.</li> <li>▪ Përshkruan zhvillimin socio-ekonomik dhe urbanistik të qyteteve arbërore/shqiptare në shekujt XVI-XIX.</li> <li>▪ Analizon shkaqet e kryengritjeve arbërore/ shqiptare kundër pushtetit osman dhe vlerëson bashkëpunimin e popujve të Ballkanit për çlirim.</li> <li>▪ Shpjegon procesin e formimit të pashallëqeve shqiptare dhe shqyrton raportin e tyre me Perandorinë Osmane dhe fuqitë e mëdha të kohës.</li> </ul>
<b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> <p>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</p>
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
<b>Zbulimet e Mëdha Gjeografike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Numëron zbulimet kryesore gjeografike dhe dallon efektet e tyre në Evropë dhe më gjerë.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon rrethanat të cilat mundësuan zbulimin e Amerikës.</li> </ul>
<b>Fillimi i kolonializmit evropian</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon krijimin e kolonive të para evropiane dhe vlerëson efektet e tyre për banorët indigjen.</li> <li>▪ Shpjegon fenomenin e skllavërisë dhe debatojnë për shtrirjen e këtij fenomeni.</li> </ul>
<b>Azia, shoqëria, ekonomia, politika</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkruan organizimin shoqëror dhe politik të Kinës në kohën e dinastisë Ming dhe Qing dhe analizon raportet me vendet evropiane.</li> <li>▪ Debaton për procesin e bashkimit të Japonisë dhe dallon shtresat shoqëror gjatë sundimit të Shogunatit Tokugava.</li> <li>▪ Përshkruan rrethanat e përgjithshme në Indi, para vendosjes së sundimit britanik.</li> <li>▪ Analizon raportet mes Evropës dhe vendeve aziatike (Kina, Japonia, India) në rrafshin kulturor, shoqëror dhe ekonomik.</li> </ul>
<b>Absolutizmi dhe parlamentarizmi në Evropë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon karakteristikat kryesore të absolutizmit në Evropë dhe krahason veçoritë e tij në vendet e ndryshme.</li> <li>▪ Shpjegon ndikimin e “Revolucioni të Lavdishëm” dhe debaton për funksionimin e monarkisë parlamentar në Angli.</li> </ul>
<b>Zhvillimet kulturore dhe zbulimet shkencore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon rrymat kryesore në rrafshin kulturor dhe arsimor në periudhën moderne.</li> <li>▪ Identifikon të arriturat kryesore shkencore në periudhën moderne dhe ndikimet e tyre në shoqëri.</li> </ul>
<b>Iluminizmi dhe Revolucionet e Mëdha</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon rrethanat në të cilat u zhvillua Iluminizmi (“Periudha e arsyes”) dhe analizon ndikimet e tij në sferat kryesore të jetës.</li> <li>▪ Shpjegon ndikimin e ideve iluministe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.</li> <li>▪ Analizon Revolucionin Borgjez Francez dhe vlerëson ndikimin e tij në botën perëndimore.</li> <li>▪ Identifikon shkaqet e Revolucionit Kombëtar Amerikan, shqyrton rezultatin dhe ndikimin e tij.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon karakteristikat kryesore të Revolucionit të vitit 1848 në Evropë.</li> </ul>
	<b>Evropa Juglindore ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon tiparet kryesore të organizimi administrativ - shtetëror dhe shoqëror të Perandorisë Osmane dhe Habsburge dhe i krahason ato.</li> <li>▪ Identifikon pozitën e popujve të Ballkanit në kuadër të Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze dhe analizon marrëdhëniet e tyre me pushtetin qendror.</li> </ul>
	<b>Epoka e Napoleonit dhe Periudha e Restaurimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon rrethanat e ngritjes së Napoleonit në krye të Francës dhe shqyrton në mënyrë kritike kurorëzimin e tij si perandor.</li> <li>▪ Radhit pushtimet e Francës në Evropë dhe jashtë saj dhe analizon ndikimin e tyre në jetën shoqërore e politike.</li> <li>▪ Shqyrton vendimet e Kongresit të Vjenës dhe gjykon ndikimin e tyre në restaurimin e sistemit konservativ (Aleanca e Shenjtë).</li> </ul>
	<b>Nacionalizmi - formimi i shteteve kombëtare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon lëvizjet për krijimin e shteteve kombëtare në Evropë.</li> <li>▪ Debaton për rrethanat e krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan.</li> </ul>
	<b>Lufta Civile dhe lëvizja për të drejtat qytetare në SHBA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon veçoritë socio-ekonomike midis shteteve veriore dhe jugore si dhe shpjegon shkaqet dhe ecurinë e Luftës Civile në SHBA.</li> <li>▪ Analizon rrethanat që sollën deri tek Proklamata e Emancipimit dhe vlerëson ndikimin e saj në emancipimin e shoqërisë amerikane.</li> <li>▪ Vlerëson Abolicionizmin dhe format tjera të lirive të njeriut dhe analizon efektet e tyre në avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.</li> </ul>
	<b>Rilindja/Lëvizja Kombëtare Shqiptare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkruan fillet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe identifikon personalitetet më të shquara shqiptare të Rilindjes dhe rolin e tyre.</li> <li>▪ Analizon rrethanat e krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe vlerëson veprimtarinë dhe programin e Lëvizjes Kombëtare.</li> <li>▪ Identifikon dhe shqyrton organizimet dhe veprimet politike e ushtarake që pasuan Lidhjen Shqiptare të</li> </ul>

		<p>Prizrenit deri në shpalljen e pavarësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon kontekstin historik të organizimit të Kuvendit të Vlorës momentin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.</li> <li>▪ Përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërisë shqiptare gjatë kësaj periudhe dhe vlerëson zhvillimet kryesore kulturore e arsimore.</li> </ul>
	<b>Imperializmi, ndarja e sferave të interesit-kolonializmi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon arsyet e zhvillimit të hovshëm industrial të Fuqive të Mëdha evropiane dhe argumenton synimet e tyre për koloni të reja.</li> <li>▪ Evidencon kontradiktat midis fuqive evropiane për sferat e interesit në botë.</li> </ul>
<b>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</b>	<b>RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b>	
	<p>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.</p> <p>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdor fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Zhvillimi i të drejtës qytetare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon dhe analizon deklaratat e të drejtave të njeriut (Bill of Rights, Deklaratën e Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, të Revolucionit Borgjez Francez).</li> <li>▪ Analizon ndikimin e Kodit Civil Freng (Kodin e Napoleonit) dhe vlerëson rëndësinë e tij për shoqërinë evropiane të shekullit XIX.</li> </ul>
<b>Vendimmarrja dhe institucionet</b>	<b>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b>	
	<p>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.</p> <p>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>



	<b>Evoluimi i vendimmarrjes shoqërore dhe institucionale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisëse të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimmarrjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi)</li> <li>▪ Vlerëson evoluimin e të drejtave qytetare dhe ndryshimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje.</li> </ul>
<b>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b>	<b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</b>  5.1. Prezanton shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Revolucioni Industrial</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon shpikjet kryesore që çuan në Revolucionin Industrial.</li> <li>▪ Identifikon anët pozitive të avancimit ingjineriko-teknologjik, si dhe ndikimet negative në mjedisin jetësor.</li> <li>▪ Shpjegon ndikimet e revolucionit industrial dhe të zhvillimeve shkencore-teknike në jetën e përditshëm të njerëzve .</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive. Rekomandohet që mësimdhënësi të lexojë me kujdes rezultatet e të nxënit për shkallë - (për kompetencë) (RNK), rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së Historisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por dhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore. Andaj, për planifikim efektiv të mësimdhënies duhet të merren në konsideratë vazhdimisht dokumentet kurrikulare.

Zbatimin praktik i planifikimit mësimor për lëndën e historisë, duhet të jetë i ndërlidhur me përdorimin adekuat të metodologjive të përzgjedhura, në harmoni me filozofinë dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës. Duke u bazuar në këtë filozofi, planifikimet ditore ose përzgjedhja e metodologjive duhet të fokusohet në mësim praktik e jo vetëm në atë teorik. Mësimdhënia dhe mësimnxënia e historisë duhet të orientohet në të zhvilluarit e shkathtësive të nxënësit si vrojtimi, hulumtimi, analiza e vendimmarrja. Kjo realizohet

duke përdorur burime dhe materiale të ndryshme mësimore, që nxisin “*të menduarit si historian*”, dhe kultivojnë aftësi, vlera dhe qëndrime individuale. Mësimdhënësi gjithmonë duhet të marrë parasysh se mësimi i historisë duhet të i ndihmojë nxënësit në zgjidhjen e konflikteve në mënyrë demokratike, në të gjykuarit në mënyrë racionale dhe në kultivimin e qytetarisë aktive demokratike. Për këtë arsye kërkohet që mësimdhënësi të respektoj stilet e ndryshme të të nxënësve, potencialet dhe kapacitetet individuale të nxënësit. Përdorimi i metodave, strategjive e teknikave të ndryshme dhe gërshetimi i tyre adekuat ndihmon që nxënësi të shfaq interesim dhe përkushtim. Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimi të diferencuar. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacioni i ri, ushtrime, punë individuale e grupore, hulumtime, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë së mësimdhënies së historisë është edhe demonstrimi. Kjo metodë është efektive në mësimdhënie dhe nxënie për shkak të ndikimit vizuel. Mësimdhënësi dhe nxënësi shpeshherë duke u përpjekur të përcjellin mendimin e tij, bëjnë lëvizje duke treguar, bërë, shpjeguar, etj. Demonstrimi kryesisht ka të bëjë me planifikimin e ndonjë loje në klasë e jashtë saj p.sh: loja në role, gara përmes asociacioneve, pantomimës, etj. Kjo metodë është e pranueshme nga nxënësi dhe ndihmon mësimdhënësin të zbulojë dhe vlerësojë shkathtësi të ndryshme të nxënësit. Gjithashtu, zhvillon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të të menduarit kreativ, menaxhimin e emocioneve, përgjegjësinë individuale dhe grupore, aftësi ndërvepruese dhe bashkëpunuese, si dhe socializmin.

Mësimdhënësi ka rol të rëndësishëm edhe në orientimin e nxënësit për shfrytëzimin racional të TIK-ut dhe medias, gjë që i ndihmon atij në thithjen e informacioneve dhe përgatitje për angazhim të suksesshëm. Organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve ka rol po ashtu të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit. Ato mundësojnë që nxënësi të zhvillojë aftësitë e vrojtimit, hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit .

Mësimdhënësi duhet të merr parasysh edhe mësimdhënien dhe të nxënësve të integruar. Duke ju përmbajtur parimeve të kurrikulës është e domosdoshme që të synohet qasja integrale, ku temat brenda lëndëve të fushës apo dhe fushave tjera të trajtohen në mënyrë të integruar. Ngjarjet, fenomene që ndodhin në shoqëri dhe mjedis nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjeshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve së historisë me mësimdhënësit e lëndëve brenda fushës por dhe me mësimdhënësit e lëndëve të fushave tjera. Kjo garanton që të nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën .

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me temat/përmbajtjet e lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedisi, ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së historisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndërkurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Këto tema mund të ndërlidhen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me program. Për shembull kur trajtohet tema për të drejtat e njeriut mund të ndërlidhet shumë mirë me rezultate që trajtojnë dokumentet si Bill of Rights, Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, të Revolucionit Borgjez Francez e ato mund të ndërlidhen me edukimin për qytetari demokratike, ku liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesëmarrja në vendimmarrje mund të shpjegohen në kontekste të kohës dhe, si ka ndodhë evoluimi i tyre etj. E njëjta qasje vlen edhe në trajtimin e temave tjera, për shembull tema/çështja e Edukimit për media mund të shërbej në kontekstin e hulumtimit të nxënësve për përmbajtje të ndryshme duke siguruar material, fotografi, harta të ndryshme etj.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkon pajtueshmëri dhe konsistencë në gjithë procesin. Mësimdhënësi duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar, synuar, ta arrijë tek nxënësi. Pra duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektin e vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Për vlerësimin e nxënësve në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, përveç llojeve të ndryshme të testimit, si ai verbal, joverbal, vlerësimi i nxënësve në punë grupore, i punës me projekte etj., mund dhe duhet të bëhen edhe vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve, dhe shkallës së rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit pikë referimi janë rezultatet e lëndës, të fushës në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve së tyre.

Qasja kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Që në këtë moshë është e rëndësishme të kultivohet shprehia e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, ku ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, si: intervistat me familjarët, punë individuale ose në grupe për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhime të tjera që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të nxënësve.

Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojnë arritje sa më të larta.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për mësimin e historisë burimet, materialet dhe evidenca historike kanë rëndësi të veçantë. Krahas teksteve shkollore bazë mund të përdoren edhe burime tjera si: tekste alternative, atlase, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm, harta, materiale të ndryshme të shkarkuara nga interneti, fotografi, artefakte, sekuenca nga filma të ndryshëm artistik dhe dokumentar, këngë me tekste epike dhe lirike, etj. Përzgjedhja e këtyre burimeve rekomandohet të jetë e përshtatshme për moshën e nxënësit dhe të kombinohen gjatë përdorimit të tyre, p.sh. një foto me një tekst përshkrues narrativ. Gjatë përzgjedhjes së burimeve alternative preferohet të ketë qasje multiperspektive, me qëllim që nxënësi të njoh këndvështrime të ndryshme dhe përmes tyre të zhvillojë vetëdijen dhe edukimin historik. Ai duhet të kuptojnë kompleksitetin e historisë, shkaktarët e ndryshëm të ngjarjeve historike, si dhe interpretimin e tyre duke nxitur pyetje shtesë për burimet dhe gjetjet tjera të së vërtetës historike. Qasja multiperspektive do ta aftësojë nxënësin të marrin në konsideratë perspektiva të ndryshme historike, që do t'i ndihmojë për t'i kuptuar rrethanat e ndërlikuara të së kaluarës. Vetëdija dhe edukimi historik duhet të jetë bazë e mendimit historik, që shprehet me shkathtësinë e hulumtimit vetanak, aftësimin e kontestimit të burimeve duke mbrojtur dhe argumentuar pikëpamjet e veta.

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Gjeografi**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## **Hyrje**

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën e tetë është ndërtuar duke respektuar Kornizën e Kurrikulës dhe Kurrikulat Bërthamë të arsimit parauniversitar, rezultatet e të nxëniet të kompetencave, Rezultatet e të nxëniet tës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, dhe planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët.

Në përputhje me metodologjinë vertikale (shtrija ndër vite e mësimit të lëndës së Gjeografisë), të respektuar ndër dekada në Kosovë, programi kurrikular i kësaj lënde vjen pas njohurive fundamentale gjeografike të arritura nga nxëniet lidhur me aspektet hapësinore, teknike dhe orientuese, njohurive fizike-gjeografike dhe njohurive humane-gjeografike të arrira në klasën paraprake.

Përmes kësaj lënde, nxëniet do të njihet me regjionet dhe kontinentet tjera ,pasiqe ne klasen e shtate nxenesit kan pervetesuar njuhurite themelore regjionale gjate shtjellimit te kontinentit te Evropes. Në përputhje me standardet e aplikueshme didaktike, pedagogjike dhe metodologjinë e promovuar edhe nga ky dokument kurrikular, duke trajtuar kontinentet si teresi te veçanta nga njera tjetra nga si dhe specifikat e tyre: nxëniet do të kuptojnë dallimet dhe ngjashmëritë, marrëdhëniet midis pjesëve dhe tërësisë, përparësitë dhe mangësitë e shfaqura në regjionet gjegjëse, zhvillimin ekonomik dhe mungesën e tij në regjione të ndryshme si dhe dallimet (orientimet) tjera politike, sociale dhe kulturore midis regjioneve, popujve dhe shteteve.

## **Qëllimi**

Qëllimi i lëndës së Gjeografisë, në këtë klasë është, që nxëniet të zhvilloj njohuri dhe shkathtësi gjeografike për kontinentet tjera perpos Evropës , për të përbashkëtat dhe diferencat, shtrirjen dhe kufizimet.

Për më tepër njohuritë e fituara në këtë klasë, nga kjo lëndë, synojnë të ndikojnë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve kritike dhe kreative të nxëniesve duke respektuar strukturën: nacionale, fetare, kulturore, sociale dhe të tjera e cila është prezente në kontinentet e botes , si vlerë e përbashkët e të gjithëve pa asnjë dallim.

## **Temat dhe rezultatet e të nxëniet**

RNL-të në këtë program mësimor, janë bazuar në temat e lëndës, në përputhje me RNF-të dhe konceptet e fushës, në harmoni me RNK. Nxëniet në klasën e tetë i arrijnë

rezultatet e të nxënit të lëndës duke respektuar obligimet, kërkesat dhe normat e caktuara në këtë dokument.

RNL-të i mundësojnë mësime të nxjerrjen e njësive mësimore duke respektuar autonominë e tij dhe të shkollës. Kjo u jep liri mësimeve, që në përputhje me kushtet konkrete, jo të barabarta (nxënësit, pajisjet, lokacioni, etj.), të mund të zgjedhin metodologji përkatëse, por duke u bazuar në RNL dhe RNF. Kjo natyrshëm nënkupton se mësime të nxjerrjen mund të përdorin literaturë aletrantive dhe informata shumë-burimore për të arrit qëllimin e ngritur me këtë program.

<b>Koncepti</b>	<b>RNF, Temat dhe RNL</b>	
<b>Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</b>	<p><b>RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to.</b></p> <p>1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.</p> <p>1.2. Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë)</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Pozita, kufijtë dhe madhësia e Azisë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton kufijtë e Azisë ndaj kontinenteve të tjera dhe të tregojë në përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike.</li> <li>▪ Krahason nga madhësia e hapësirës me kontinentet e tjera.</li> </ul>
	<b>Specifikat popullatave, kulturore dhe politiko-administrative të Azisë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon pasuritë kryesore minerale dhe burimet energjetike të Azisë dhe t'i shënojë në hartën mecece ato.</li> <li>▪ Dallon rajonet kryesore të përqendrimit të popullsisë në Azi dhe t'i tregojë shkaqet e tyre</li> <li>▪ Analizon elementet e përgjithshme demografike të Azisë</li> <li>▪ Dallon grupimet kryesore politike dhe ekonomike në Azi, veprimtaritë kryesore ekonomike dhe rajonet tipike gjeografike të Azisë</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon elementet kryesore demografike te Azisë Jugperëndimore</li> <li>▪ Identifikon qytetet më të njohura kulturore dhe religjioze të Azisë Jugperëndimore dhe të identifikohen zonat turistike.</li> <li>▪ Identifikon burimet kryesore energjetike dhe pasuritë minerare dhe degët kryesore të ekonomisë.</li> <li>▪ Dallon ngjashmëritë dhe specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike të Turqisë, Iranit dhe Arabisë Saudite.</li> <li>▪ Analizon veqorite demografike te Azise Jugore.</li> <li>▪ Analizon specifikat natyrore, popullative, kulturore, ekonomike dhe politike të shtetit të Indisë dhe Pakistanit, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.</li> <li>• Identifikon veçoritë e përbërjes etnike dhe fetare të popullsisë së Azisë Juglindore.</li> <li>• Përkufizon dhe dallon specifikat natyrore, popullative, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore-Indonezisë, Malajzisë dhe Singapurit. Analizon vecorite demografike te këtij regjioni, si dendësinë, shtimin e lartë natyror, përkatësinë e larmishme etnike e fetare.</li> <li>• Përkufizon dhe dallon specifikat natyrore, popullative, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore (Kina, Japonia dhe Korea)</li> </ul>
--	--	--



<p><b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b></p>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> <p>2.2. Shpiegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik te një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti</p>	
	<p><b>Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Azisë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon në hartë malet kryesore, rrafshlartat, ultësirat, luginat e mëdha të lumenjve, gadishujt dhe ishuj.</li> <li>▪ Shpjegon rolin e hapësirës së madhe, ndikimin e deteve dhe të oqeanëve në klimë, ndikimin e erërave monsunike, pasurinë në ujëra dhe rrjetin hidrografik.</li> <li>▪ Analizon ndryshimet e botes bimore, tajgen, stepen, makjet, savanet, xhunglat dhe t'i emërtojë kafshët e egra që jetojnë në regjionet e Azisë.</li> </ul>
	<p><b>Azia Jugperendimore, veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon rolin e pozitës gjeografike të Azisë Jug perëndimore dhe të vlerësojë rëndësinë e saj në Azi dhe në botë.</li> <li>▪ Dallon veçoritë kryesore të relievit, klimës, hidrografisë dhe botës bimore e shtazore, duke analizuar rëndësinë e tyre për jetën dhe veprimtaritë e njerëzve.</li> </ul>

<p><b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b></p> <p><b>Mjedisi resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b></p> <p><b>Individi, grupi dhe marrëdhëniet shoqërore</b></p>	<p><b>Azia Jugore, juglindore dhe lindore, veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikona veqorite e pergjitheshme fizikogjeografike te Azise Jugore-vargmalet, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.</li> <li>▪ Arsyeton tipat e klimës mes pjesëve veriore dhe jugperëndimore e jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Azisë Jugore.</li> <li>▪ Analizon veqorite hidrografike te Azise Jugore.</li> <li>▪ Identifikon elementet kryesore te perthyeshmerise bregdetare te Azise Jugore</li> <li>▪ Analizon ndikimi dhe rëndësia e deteve në këtë regjion.</li> <li>▪ Gjen në hartë sistemet malore, ultësirat e mëdha pjellore, lumenjtë dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse nëpër ishujtë e Indokinës ndodhin tërmete e vullkane.</li> <li>▪ Analizon vecorite klimatike dhe hidrografike te Azise Juglindore.</li> <li>▪ Shpjegon rolin e pozitës gjeografike dhe të evidencojë veçoritë kryesore të pozitës gjeografike.</li> <li>▪ Krahason viset perëndimore dhe lindore, kontinentale dhe ishullore nga releivi, klima dhe hidrografia.</li> </ul>
	<p><b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b></p>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> <p>2.2. Shpiegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në</p>

		mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik te një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti
	<b>Afrika–Veçoritë natyrore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Percakton kufijtë e Afrikës dhe t’i tregojë përparësitë e pozitës së saj ndaj Azisë, Amerikës dhe Australisë.</li> <li>• Identifikon ngushticat detare, gjiret detare, ishujt dhe gadishujt dhe t’i gjejë në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, ultësirat, fushat, luginat lumore më të njohura, shkretëtirat, gjysmëshkretëtirat, stepet, savanet dhe pyjet ekuatoriale.</li> <li>• Dallon tipat e klimës përmes klimogrameve dhe t’i përshkruajë dallimet themelore të tyre.</li> <li>• Analizon vecoritë hidrografike të Afrikës</li> <li>• Perkufizon regjionin e Mesdheut Afrikan dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion.</li> <li>• Përshkruan relievin malor (vargmalet), rrafshlartat malore, shkretëtirat dhe masivet malore midis shkretëtirës, vecoritë klimatike ,hidrografike dhe të botes bimore e shtazore të Mesdheut Afrikan..</li> <li>• Analizon shpërndarjen hapësirë të pasurive natyrore (naftes dhe pasurive të tjera ) në Afrikën Mesdhetare</li> <li>• Perkufizon regjionin dhe t’i identifikojë shtetet që e përbëjnë këtë regjionin dhe analizon vecoritë kryesore natyrore (relievin, klimën, ujrat )</li> <li>• Identifikon ishujt, gjirit dhe shtetet që e përbëjnë Afrikën</li> <li>• Përcakton si dhe analizon rolin e pozitës gjeografike në ngjarjet historike</li> </ul>

		<p>të Afrikës Perëndimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon vecorite natyrore( relievin ,ultësirat të pllajave dhe kodrinoro-malor) dhe shoqeroro-ekonomike te Afrikes Perendimore.</li> <li>• Ndërlidhë klimën me rritjen e pyjeve ekuatoriale dhe llojet e ndryshme të kafshëve të egra dhe të zogjve si dhe vlereson veçoritë hidroenergjetike të lumenjve të këtij regjioni</li> <li>• Përkufizon regjionin e Afrikes Qendrore identifikon shtetet e tij.</li> <li>• Analizon veqorite natyrore(relievin,klimen,ujrat ,boten bimore dhe shtazore )te Afrikes Qendrore.</li> <li>• Pershkruan poziten gjeografike te Afrikes Lindore si dhe analizon perparsite dhe mangesite e pozites gjeografike.</li> <li>• Dallon dhe të arsyeton tiparet e veçanta të klimës ekuatoriale që ndryshon në mënyrë vertikale dhe horizontale.</li> <li>• Analizon ndërlidhjen mes tipave klimatikë dhe zonave vegjetative.</li> <li>• Identifikon shtrirjen e pyjeve ekuatoriale, savanave dhe gjysmëshkretëtirave dhe përhapjen e kafshëve të egra në këtë regjion.</li> <li>• Pershkruan rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjeve dhe veçoritë specifike të lumenjve.</li> <li>• Identifikon dhe të emërton liqenet më të njohura të Afrikës Lindore.</li> <li>• Analizon poziten gjeografike dhe lidhjet komunikative te Afrikes Jugore me pjeset tjera te Afrikes dhe me kontinentet tjera te Botes.</li> <li>• Identifikonse cilat brigje të Afrikes</li> </ul>
--	--	---

		<p>Jugore lagen me ujërat e cilit oqean dhe shtetet që përbëjnë këtë regjion.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon vecorit natyrore malet, rrafshlartat, fushëgropat, shkretirat dhe fushat përgjatë brigjeve të oqeanit.</li> <li>• Arsyeton t rrjetin hidrografik te varfër, mungesa e liqeneve dhe të dallon tipat e klimës mes pjesëve perëndimore, qendrore dhe lindore të regjionit.</li> </ul>
		<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve</p> <p><b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</b></p> <p>5.1. Prezanton shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.</p> <p><b>RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</b></p> <p>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.</p> <p>1.2. Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të</p>

		<p>grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë). 1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.</p>
	<p><b>Veçoritë shoqërore ekonomike të Afrikës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon vecorite demografike dhe ekonomike te Afrikes</li> <li>• Analizon menyren e organizimit politik te shteteve te Afrike</li> <li>• Dallon grupimet politike dhe ekonomike dhe problemet me të cilat ballafaqohet popullsia e Afrikës.</li> <li>• Identifikon popujt që banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.</li> <li>• Analizon lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.</li> <li>• Identifikon veçoritë natyrore, populative, kulturore e ekonomike të Marokut dhe Egjiptit.</li> <li>• Analizon vecorite shoqeroro-ekonomike(popullsine ,pasurite natyrore ) te Afrikes Sudaneze</li> <li>• Afrika ekuatoriale- Identifikon popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike,kulturore dhe ekonomike</li> <li>• Arsyeton ndrelidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.</li> <li>• Dallon popujt në Afrikën Lindore sipas përkatësisë etnike e fetare dhe gjendjes sociale.</li> <li>• Nxjerrë konkludime të thjeshta duke krahasuar shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, populative, nivelit të arsimit, urbanizmit dhe strukturës ekonomike të tyre.</li> <li>• Dallon tiparet kryesore natyrore,</li> </ul>

		<p>popullative, kulturore e ekonomike të Tanzanisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Afrika Jugore- Pershkruan vecorite shoqeroro-ekonomike si dhe identifikon vendburimet më të njohura të arit, diamantit, uraniumit, kromit, hekurit, naftës, qymyrit etj.</li> <li>• Ben nderlidhjen mes kushteve klimatike, veçorive të ujit të detit dhe të tregon rolin e tyre në ekonomi e turizëm</li> </ul>
<b>Proceset natyrore dhe shoqërore</b>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> <p>2.2. Shpiegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik te një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti</p>	
	<p><b>Amerika si tërësi regjionale-vecorite natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon pozitën gjeografike, shtrirjen, madhësinë dhe të identifikon gadishujt, ishujt, gjiret, ngushticat dhe kanalet kryesore të Amerikësi dhe vleron rëndësinë e tyre.</li> <li>• Dallon elementet kryesore natyrore (malet , fushat, pllajtat dhe luginat lumore më të njohura.</li> <li>• Analizon veçorite e klimës përmes klimogrameve dhe ndërlidhë me tipat vegjetativë të tajgave, prerisë, makjeve, lanoseve, selvaseve, kamposeve.</li> <li>• Identifikon përmes hartës gjeografike lumenjtë dhe liqenet e njohura, detet dhe oqeanet, ujët e të cilave i lagin brigjet e Amerikës.</li> <li>• Amerika Veriore-Vlerëson pozitën gjeografike, përthyerjen e vijës bregdetare</li> </ul>

		<p>dhe daljen në Oqeanë të Amerikës Veriore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, rrafshlarta e madhe, pllaja e prerive, fushat dhe luginat lumore më të njohura.</li> <li>• Analizon dhe i komenton klimogramet dhe zonat bimore e shtazore për vendet e Amerikës Veriore dhe të arsyeton ndryshimet e theksuara midis rajoneve, roli i rrymave oqeanike në brigjet juglindore dhe juperëndimore të regjionit.</li> <li>• Identifikon lumenjtë kryesorë, prania e madhe e liqeneve natyrore, ujëvareve, kanioneve dhe arsyeton rolin e tyre në zhvillimin ekonomik të Amerikës Veriore.</li> <li>• Paraqet me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të naftës, gazit, nikelit, arit, uraniumit, plumbit, hekurit, qymyrit si dhe qendrat kryesore të industrisë.</li> <li>• Analizon rendesin e rajoneve bujqësore dhe varësinë e tyre nga zonat klimatike dhe relievo.</li> <li>• Përcakton shtrirjen hapësinore të Amerikës së Mesme dhe dallon përparësitë e pozitës së saj ndaj Amerikës Veriore dhe Amerikës Jugore.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon në hartë gadishujt, ishujt dhe detet që i lagin brigjet e Amerikës së Mesme.</li> <li>• Dallon dhe të arsyeton shtrirjen e zonave klimatiko-vegjetative mes pjesëve veriore dhe jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Amerikës së Mesme.</li> <li>• Analizon pozitën gjeografike, madhësinë e territorit dhe shtetet që e përbëjnë.</li> <li>• Dallon tërësitë e mëdha relievo: Ultësirën e Amazonit, të Orinokos,</li> </ul>
--	--	--



		<p>rrafshnaltën e Guajanës, pllajën e Brazilit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon vecorite klimatike dhe hidrografike te Amerikes Jugore..</li> <li>• Analizon shtrirjen gjeografike te mineraleve më të njohura në këtë regjion, si: hekuri, mangani, boksiti, ari, nafta, diamanti etj</li> </ul>
<p><b>Vendimmarrja dhe institucionet</b></p> <p><b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b></p>	<p><b>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b></p> <p>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme</p> <p>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlihdjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pat parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>	
	<p><b>Tema</b></p> <p><b>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon pasurite natyrore më të njohura ( metaleve, naftës, qymyrit, gazit e pasurive të tjera) dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik.</li> <li>• Komenton grafikonin e rritjes së popullsisë dhe hartën e dendësisë së popullsisë.</li> <li>• Dallon popujt dhe grupet e shumta që</li> </ul>

		<p>ndryshojnë nga raca, gjuha, kultura dhe prejardhja e tyre në Amerikë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon shkaqet që nxiten zbulimin e Amerikës dhe popullimin e saj.</li> <li>• Dallon popujt më të njohur që e përbëjnë popullsinë e SHBA-së dhe të Kanadasë sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.</li> <li>• Krahason shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, popullative, nivelit të arsimit, urbanizimit, strukturës ekonomike dhe bën dallimin e organizimit politiko-administrativ mes SHBA-së dhe Kanadasë</li> <li>• Analizon perthyshmerein e madhe bregdetare si dhe vlereson rendesin e Kanalit te Panamasë dhe përshkruan rendësinë e tij ekonomike.</li> <li>• Analizon vecorite klimatike dhe hidrografike te Amerikes se Mesme</li> <li>• Dallon popujt më të njohur në Amerikën e Mesme sipas përkatësisë etnike, racore e fetare</li> <li>• Amerika Jugore- Arsyeton strukturën e popullsisë së këtij regjioni sipas përkatësisë kombëtare, racore dhe fetare.</li> </ul>
<p><b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b></p>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasqyruar lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>	
	<p><b>Tema</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b></p>

	<p><b>Oqeania, Australia dhe Krahinat Polare</b>  <b>- Pozita gjeografike, veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon pozitën gjeografike skajore në hemisferën jugore të Australisë,vecorite natyrore ,relievin,klimen,ujrat,boten bimore dhe shtazore.</li> <li>• Identifikon vendburimet e mineraleve, si: qymyrgurit, hekurit, naftës, zinkut, plumbit, bakrit, arit etj</li> <li>• Përkufizon viset polare në globin gjeografik.</li> <li>• Analizon dallimet dhe ngjashmëritë mes Arktikut dhe Antarktikut.</li> <li>• Analizon vështirsitet e shumta natyrore pse Antarktiku është kontinenti i fundit i shkelur nga njeriu.</li> <li>• Vlereson kushtet klimatike te Arktikut me bimësinë e varfër dhe shtazët e egra të pakëta.</li> <li>• Analizon se kontinenti i Antarktidës është më i largët dhe më i izoluar në të gjithë rruzullin tokësor.</li> <li>• Vlerëson mungesën e lumenjve në këtë kontinent.</li> <li>• Shprehë varësinë e klimës, florës dhe faunës në Antarktidë</li> </ul>
<p><b>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b></p>	<p><b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</b></p> <p>5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</p> <p>5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>	
	<p><b>Tema</b></p> <p><b>Oqeania, Australia dhe Krahinat Polare, veçoritë shoqëroro-ekonomike</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon vecorite demografike te Australise.</li> <li>• Dallojn tri grupe të mëdha ishujsh: Melanezinë, Mikronezinë dhe Polinezinë.</li> <li>• Analizon menyren e formimit te ishujve</li> </ul>

		<p>si dhe ndërlydhë tipat klimatikë me zonat vegjetative.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikonë grupet kryesore që e popullojnë Oqeaninë, si: papuanët, maorët, melanezianët, mikronezianët, polinezianët, por edhe ardhacakët nga kontinentet e tjera, si: aziatikë, amerikanë, evropianë etj.</li> <li>• Përshkruan karakteristikat e përbashkëta, si: ngjyrën e errët të lëkurës, flokët e zezë, kaqurrela</li> <li>• Identifikon popujt që i banojnë ishujtë e Arktikut dhe veçoritë e tyre demografike dhe ekonomike</li> <li>• Nxjerrë konkludime për mungesën e vendbanimeve të përhershme në Antarktidë.</li> </ul>
--	--	---

## Udhëzime metodologjike

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë një ndër pikat kyçe të programit për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesimin, gjithë përfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është kompetencë profesionale e mësimdhënësve.

Për mësimdhënie të suksesshme kërkohen disa përgatitje paraprake. Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive. Rekomandohet që mësimdhënësi të lexojë me kujdes rezultatet e të nxënit për shkallë - (për kompetencë) (RNK), rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së Gjeografisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por dhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore. Andaj, për planifikim efektiv të mësimdhënies duhet te merren në konsideratë vazhdimisht dokumentet kurrikulare.

Metodologjia duhet të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, që kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme. Metododat didaktike duhet

të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me karakterin e dijeve, të rezultateve lëndore si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësuesit dhe nxënësit.

Mësuesit dhe të nxënësit, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimit, mësuesit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit
- të nxitin vërtetimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë (sa herë që është e mundur)
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve
- të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar partner të vetin dhe duke kuptuar se në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit
- të mbështesin të nxënësit e pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët, përmes punës me projekte, punës në grupe, punës individuale, etj
- të kenë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shoqëria dhe Mjedisit”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore (kjo mund të bëhet me e fuqishme nëse ka nivel më të mirë të bashkëpunimit në aktivitetet profesionale në nivel shkollor)
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por jo të vetmin për përmbushjen e kompetencave
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimit dhe të nxënësit.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësuesit e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt).
- Mësuesit jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve).
- Mësuesit me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).
- Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit).
- Mësuesit që nxitin të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.
- Të mësuarit dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit.
- Mësuesit që nxitin hulumtimin.
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në ambiente të hapura (nëse kjo nuk është e mundur atëherë sjellja reciproke e eksperiencave nga vizitat jashtë vendit të mësimit dhe nxënësve).

Për realizimin e programit, mësimdhënësi duhet ketë parasysh edhe parimet bazë të KK-se në mësimin e gjeografisë. Ai gjatë realizimit të programit të gjeografisë i udhëheq nxënësit në mënyrë që ata me aktivitetet e tyre në klasë, kabinet, etj., të mund të: njoh, vrojtojë, radhis, mat, shënojë, mbledh të dhënat, të mbikëqyr, të mendojë në mënyrë të pavarur, të mbrojë dhe argumentojë mendimet e tij, duke u nisur prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.

Në shkencën e Gjeografisë si për njohuritë teorike, ashtu dhe për njohuritë empirike dhe praktike që përmban kjo lëndë, krijohen një sërë sisteme njohurish, sikundër janë njohuritë gjeomorfo-gjeografike, klimo-gjeografike, hidro-gjeografike, bio-gjeografike, ekonomiko-gjeografike, turistiko-gjeografike, demo-gjeografike, etj.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shoqëria dhe mjedisi i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në fushën Shoqëria dhe Mjedisi për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për medie
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

### **Edukimi për medie**

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

### **Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë**

Aftësitë për jetën ndihmojnë nxënësit të marrin vendime të mirëargumentuar, të zgjidhin probleme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyra të shumëllojshme dhe të efektshme, intelektuale dhe emocionale para të tjerëve, si dhe të ndërtojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme të sigurt. Gjatë zhvillimit të kësaj çështje rrisin sigurinë e shëndetit të tij dhe të tjerëve, në mënyrë që të jenë të aftë të ndërtojnë hapa të sigurt në mjedisin e tyre dhe më gjerë.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësisë të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijesimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijesimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle. Vlerësimi u shërben mësimdhënësve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënësve si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësimdhënësi duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- Vlerësimi duhet të jetë i besueshëm dhe i paanshëm. Nxënësit duhet t'i jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
- Vlerësimi duhet t'i ndihmojë nxënësit. Ai duhet t'u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t'u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënësve.
- Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënësve dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi.

**Vlerësimi është në funksion të:**

- sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënësve
- Vlerësimit të punës praktike dhe demonstrues
- identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve
- nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve
- vetëvlerësimit të nxënësve
- përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

**Vlerësimi kërkon:**

- Rezultate të qarta mësimore
- Motivim të nxënësve
- Njohjen e përvojës dhe e aftësive të nxënësve
- Kërkesa të qarta të nxënësve dhe metoda e teknika mësimore efikase.

**Vlerësimi bazohet në:** Çka thonë, Çka shkruajnë dhe Çka bëjnë nxënësit?

**Etapat e vlerësimit:**

- Kontrolli, p.sh. çka din (çka është arritur) dhe çfarë nuk din nxënësit (çka nuk është arritur).
- Matja, ajo që kontrollohet matet.
- Vlerësimi, nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi, sasior ose cilësor bazuar në matje me notë.

**Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:**

- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.)
- Vlerësimi me shkrimë
- Vlerësimi me anë të dëgjimit
- Vlerësimi përmes punës praktikë
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve
- Vlerësimi i projekteve kurrikulare, lëndore ose ndër lëndore
- Esetë
- Portofoli
- Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar

**Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në lëndën e gjeografisë ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme, tematike, atlase, albume, foto, skica, modele, makete, diagrame, mjete grafike, filma mësimorë, kompjuter, projektor, CD, DVD etj. Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, atlase, harta, libri i mësuesit, udhëzues profesional, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi, etj.



Ndërsa mësimdhënësi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë qasje në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e njohurive në gjeografi është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, pjesëmarrje në ngjarje kulturore, sportive, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

### **Sugjerime për përdorimin e TIK-ut**

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar ueb-et për gjeografinë.
- Përdorimi i PC për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm softuerëve
- Përdorimi i grafikëve softuerëve.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Edukatë qytetare**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Lënda Edukatë Qytetare në klasën e tetë, ndryshon në përmbajtje, sepse kemi të bëjmë me fëmijë të moshës 13-14 vjeçare. Kjo lëndë e ndihmon nxënësin që të bëhet nxënës i suksesshëm, individ i shëndoshë, kontribues produktiv, e mbi të gjitha qytetar i përgjegjshëm, duke i hap vetës rrugën drejtë karrierës. Edukata Qytetare të klasës së tetë, trajtohen këto tema: mediet dhe rrjetet sociale; shëndeti, mosha dhe mënyra e jetesës; diverziteti kulturor; ligji dhe procedurat për nxjerrjen e tij; shteti i së drejtës; si dhe ruajtja e mjedisit.

Lënda përmban tema që kanë të bëjnë me raportet shoqërore, ndikimin e medieve, sjelljen dhe mënyrën e jetesës, ligjin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, duke vënë në pah të vërtetën, transparencën, lirin nga paragjykimet dhe luftimin e diskriminimit. Programi i klasës së tetë ndihmon krijimin e shprehive, duke ndërtuar raporte të mira ndërnjerëzore në shoqëri, përmes njohjes dhe respektimit të ligjit, ndikimit të mediave dhe rrjeteve sociale, në frymën e pranimit reciprok, mirëkuptimit dhe tolerancës, për të ruajtur kohezionin social dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve mes individëve dhe grupeve shoqërore.

Nxënësi i moshës 13-14 vjeçare duhet të jetë i interesuar, i motivuar, kureshtar dhe mjaft aktiv, për t'i kuptuar specifikat e vendit ku jeton, t'i krahasojë me specifikat e vendeve të tjera dhe të përpiqet të veprojë dhe të kontribuojë duke kultivuar praktika e vlera qytetare dhe humane. Duhet të kuptojë se shoqëria demokratike bazohet në ligj, në respektimin e të drejtave të njeriut, në respektimin e diverzitetit, barazinë e mundësive, transparencën, gjithpërfshirjen, solidaritetin dhe respektin e dinjitetit njerëzor. Për të gjitha këto, rëndësi të veçantë kanë edhe mediet dhe rrjetet sociale, të cilat sot konsiderohen si shtyllë qendrore e jetës shoqërore.

Edukata Qytetare mëson nxënësin për tu bërë qytetar aktiv dhe i përgjegjshëm, për t'i kuptuar dhe vlerësuar drejtë vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me vetën apo të tjerët; për t'i njohur, analizuar dhe vlerësuar ndikimin e rrjeteve sociale (dobitë dhe dëmet eventuale), funksionet dhe përgjegjësitë e tyre; pastaj, rreziqet që lidhen me faktorë të ndryshëm të jetës dhe masat për parandalimin ose mbrojtjen ndaj tyre; për mirëqenjen sociale dhe rolin e shtetit në këtë aspekt; ligjin dhe shtetin e së drejtës; diverzitetin kulturor etj. Të gjitha këto njohuri dhe shkathtësi, duke përfshirë edhe atë që kanë të bëjnë me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm kontribuojnë në krijimin e mirëqenies së nxënësit, përkatësisht qytetarit.

## Qëllimi

Qëllimi i kësaj lënde është që të ndikojë tek nxënësi që të bëhet qytetar i denjë i vendit, me dije dhe shkathtësi për të krijuar raporte të mira me njerëzit, duke manifestuar sjellje korrekte dhe kultivuar modele dhe shprehje të dobishme.

Për nxënësin e klasës së tetë, është me interes të mësohet lënda Edukatë Qytetare, sepse mosha 13-14 vjeçare paraqet një fazë delikate për zhvillimin e personalitetit, sepse është koha kur puberteti është në fazën kulmore dhe rreziku për sjellje, ndikime dhe orientime të gabuara të fëmijëve është i mundshëm. Prandaj, Edukata Qytetare e udhëzon fëmijën për sjellje dhe veprime të drejta e të dobishme, si për vetën, ashtu edhe për familjen, rrethin dhe shoqërinë.

Interesi i familjes, shkollës dhe shoqërisë është që fëmija t'i arrijë kompetencat jetësore të parashtruara në Kurrikulën Bërthamë, pra fëmija të jetë: komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, kontribues produktiv, individ i shëndosh dhe qytetar i përgjegjshëm. Qëllimi i lëndës Edukatë Qytetare është që t'i ndihmojë nxënësit për të zhvilluar këto kompetenca dhe për t'u bërë qytetar i denjë i vendit të vet.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) dhe temat janë nxjerrur nga konceptet dhe rezultatet e të nxënit të fushës (RNF). Kështu që fusha Shoqëria dhe Mjedisi, përkatësisht shkalla e katërt (IV) kurrikulare, e përcaktuar në bazë të Kurrikulën Bërthamë të arsimit të mesëm të ulët, janë paraqitur në mënyrë tabelare.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL
<b>1. Individit, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</b>	RNF: <b>1. Njeh</b> strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to. 1.1. <b>Analizon</b> çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis. 1.2. <b>Dallon</b> faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë). 1.3. <b>Debaton</b> për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.
	<b>Tema</b> <b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Tema 1</b> <b>Nxënësi:</b> • Vlerëson ndikimin e medieve në jetën private dhe publike dhe

	<b>Mediet dhe rrjetet sociale</b>	<p>nevojën për të qenë i informuar me trendet aktuale të zhvillimit të shoqërisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorë mediet për të promovuar dhe senzibilizuar aktivitete grupore për të mirën dhe interesin publik, si mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja e mjedisit, kursimi i energjisë etj.</li> <li>• Shqyrton/analizon vërtetësinë e lajmit të publikuar, duke u bazuar në dy e më shumë burime të informimit dhe reflekton mbi pasojat e lajmit të rrejshëm.</li> <li>• Merr pjesë aktive në forume dhe debate që zhvillohen në rrjetet sociale dhe angazhohet për të drejtat e njeriut, funksionimin e ligjit dhe zhvillimin e demokracisë.</li> <li>• Përdorë në mënyrë të drejtë rrjetet sociale dhe dënon abuzimin me to, me theks të veçantë dënon gjuhën fyese dhe denigruese për dinjitetin njerëzor, si dhe atë urrejtëse për grupet ose kategoritë e caktuara.</li> <li>• Viziton muzetë, kinematë, teatrot, koncertet, festivalet dhe evente tjera me qëllim të njohjes sa më të mirë me krijuesit, kultivuesit dhe promovuesit e vlerave kulturore, civilizuese dhe humane.</li> </ul>
<b>2. Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.</b></p> <p>2.1. <b>Krahason</b> ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> <p>2.2. <b>Shpjegon</b> përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</p>	
	<b>Tema</b>  <b>Tema 1</b>  <b>Shëndeti, mirëqenia dhe mënyra e jetesës</b>	<b>Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)</b>  <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron dije dhe shkathtësi për të vepruar në situata emergjente të shkaktuara nga faktorët natyrorë apo njerëzorë duke ndihmuar vetën dhe të tjerët.</li> <li>• Vlerëson punën e institucioneve të mirëqenies sociale në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të grupeve ose kategorive të rrezikuara dhe ndihmon në identifikimin e personave ose grupeve në nevojë, për t'iu ofruar ndihmën dhe kujdesin e nevojshëm.</li> <li>• Vlerëson punën e institucioneve të shëndetit publik dhe organizatave humanitare, në mbrojtjen nga epidemitë dhe</li> </ul>

		<p>sëmundjet e ndryshme, duke përfshirë edhe ato seksualisht transmetive.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson rëndësinë e sigurimit shëndetësor, sigurimit të jetës, sigurimit të pronës dhe rolin që luan institucionet dhe kompanitë e sigurisë në këtë aspekt.</li> <li>• Konstaton faktorët e rrezikut për jetën, shëndetin dhe pronën, duke dalluar qartë faktorët natyrorë nga ata njerëzorë.</li> <li>• Vlerëson nevojat njerëzore për grupe dhe kategori të veçanta shoqërore, duke dalluar mënyrën dhe kushtet e jetesës, mvarësisht nga shëndeti, mosha, vendbanimi, traditat kulturore apo bindjet personale.</li> </ul>
<p><b>3. Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</b></p>	<p><b>RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b></p> <p>3.1. <b>Shfrytëzon</b> në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.</p> <p>3.2. <b>Analizon</b> sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdor fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.</p>	
	<p><b>Tema</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)</b></p>
	<p><b>Tema 1</b></p> <p><b>Diverziteti kulturor</b></p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon përkatësitë e shumëfishta dhe identitetin në një shoqëri të përzier kulturalisht dhe të ndërlidhur globalisht.</li> <li>▪ Vlerëson rëndësinë e çlirimit nga stereotipet dhe paragjykimi, si dhe nevojën për luftimin e çdo lloj diskriminimi njerëzor.</li> <li>▪ Vlerëson rolin e fesë në bashkëjetesën paqësore dhe tolerancën mes popujve me besime dhe tradita të ndryshme fetare, si dhe gjykon çdo lloj ekstremizmi fetar.</li> <li>• Dallon vlerat kulturore dhe trashëgimore të përbashkëta dhe ato të veçanta të minoriteteve që jetojnë në Kosovë dhe më gjërë, duke shfrytëzuar burime të ndryshme të njohjes.</li> <li>• Organizon aktivitete (debate, fushata) për nevojën e gjithëpërfshirjes së minoriteteve në vendimarrje në fusha të ndryshme të jetës, si: politikë, ekonomi, arsim, kulturë etj.</li> <li>▪ Dallon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e veta dhe të tjerëve, si dhe me shembuj konkret tregon pasojat nga shkelja, mosnjohja dhe mosrespektimi i tyre.</li> </ul>
<p><b>4.Vendimma</b></p>	<p><b>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të</b></p>	

<b>rrja dhe institucionet</b>	<b>vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b>	
	4.1. <b>Arsyeton</b> llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.	
	4.2. <b>Krahason</b> llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Tema 1</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Analizon arsyeshmërinë e ligjeve të drejta dhe argumenton nevojën për rregullimit ligjor të jetës në shoqërinë demokratike.</li> <li>Vlerëson rëndësinë e respektimit të ligjit dhe pasojat që mund t'i ketë shkelja e tij për vetën, familjen, komunitetin, institucionet dhe për gjithë shoqërinë.</li> <li>Vlerëson punën e organeve ligjvënëse dhe ato ekzekutive si dhe jep shembuj e sygjerime rreth zbatueshmërisë së ligjeve në jetën e përditshme.</li> <li>Vlerëson rëndësinë e zbatimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në Kosovë dhe përgjegjësinë e instiucioneve dhe qytetarëve për ruajtjen e tyre.</li> <li>Vlerëson rolin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta për të ndërtuar insitucione dhe shoqëri vërtetë demokratike.</li> <li>Vlerëson rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe votës së dhënë në bazë të bindjes dhe vullnetit të lirë.</li> <li>Vlerëson rolin e llogaridhënies në një shoqëri demokratike dhe të sunduar nga ligji.</li> </ul>
	<b>Ligji dhe procedura t për nxjerrjen e tij</b>	
	<b>Tema 2</b>	
	<b>Shteti i së drejtës</b>	
<b>5. Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b>	<b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</b>	
	5.1. <b>Prezanton</b> shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Tema 2</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vlerëson rolin e qytetarisë aktive në parandalimin e sjelljeve negative në raport me mjedisin dhe biodiversitetin, duke kontribuar në fushata vetëdijësuese lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.</li> <li>Analizon shprehitë dhe praktikat personale në lidhje me artikujt</li> </ul>
	<b>Ruajtja e mjedisit</b>	

		<p>dhe konsumin e përditshëm dhe është në gjendje t'i ndërrojë shprehitë e veta, sidomos ato në lidhje me ushqimin, në funksion të promovimit të produkteve bio.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në mënyrë aktive në shoqata, organizata apo programe dhe aktivitete jashtë shkollore që merren me mjedisin, eficiencën, biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke dëshmuar vetën si një ekoqytetar i denj për të inicuar dhe bërë ndryshimin e mënyrës së jetesës, bazuar në vizionin ekologjik të ndërlidhjes dhe ndërvarësisë në botë.</li> </ul>
--	--	---

## Udhëzime metodologjike

Për arritjen e rezultateve të parapara për këtë klasë, është shumë më rëndësi të kuptohet qëllimi i lëndës Edukatë Qytetare e cila ndihmon shumë në paisjen e nxënësve jo vetëm me njohuri dhe shkathtësi jetësore, por edhe me vlera edukative, humane dhe intelektuale. Për këtë arsye ekzistojnë një mori metodash, strategjish dhe teknikash që mësimdhënësi duhet t'i përdorë në mësimdhënie. P.sh. tema **Mediet dhe rrjetet sociale**, nxënësi këshillohet që të hulumtojë në forma të ndryshme llojllojshmërinë e medieve, t'i nxjerr përparësitë dhe mangësitë e tyre; t'i vlerësojë dobitë dhe dëmet, madje edhe rreziqet nga ekspozimi i tepërt, apo nga abuzimi me to i grupeve të ndryshme të interesit. Po ashtu, meqenëse jetojmë në kohën e internetit, secili nxënës duhet të dijë të hulumtojë burime dhe të dhëna të dobishme, duke përfshirë edhe faqet zyrtare të institucioneve që veprojnë në Kosovë, për të sjellur materiale të ndryshme në klasë dhe për të debatuar lidhur me to. Nxënësit e ndarë në grupe mund t'i ndajnë rolet ose detyrat, p.sh., nëse është fjala për shfrytëzimin e internetit, të bëjnë debate kush është PRO dhe kush KUNDER përdorimit të plotë të informatave nga interneti, pa pasë një çasje kritike ndaj tyre. Ata do ta kenë rolin e gazetarit dhe nga aty njëherit t'a bëjnë lajmin; të diskutohet rreth nxjerrjes së lajmit të mirë dhe atij të keq etj. Kësisoj, në kushte klase do të mund të simulohet një shtëpi e vogël mediatike.

Sa i përket temës **Shëndeti, moshë dhe mënyra e jetesës**, mësimdhënësi këtë mund t'a realizojë duke e ftuar në klasë një ekspert shëndetsor për të ligjëruar për shëndetin e mirë dhe mirëqenjen, duke i ndërlidhur këto jo vetëm me mënyrën e jetesës në shoqëri moderne, por edhe me ndryshimet që lidhen me moshën dhe pubertetin. Nga informacionet që nxënësit marrin nga eksperti, u kërkohet të shkruajnë një ese 10 minutëshe, me titull: *"Puberteti - faza më e mirë e jetës"*. Paraprakisht eksperti shëndetsor ka përdorur edhe sekuenca vizuale të nxjerrura nga YouTube, që kanë të bëjnë me shëndetin, moshën, pubertetin dhe mënyrën e jetesës së grupeve ose kategorive të ndryshme shoqërore.



**Diverziteti kulturor** mund të realizohet nëpërmes vrojtimit të jetës së përditshme në mjedisin ku jeton, përmes shfrytëzimit të materialeve nga mediet, por edhe hulumtimit që nxënësi bën në internet, kuptohet në bazë të rekomandimeve të mësimdhënësit, duke krahasuar trajtimin e këtij diverziteti në ditën e sotme me dikur. Trajtimi i drejtë i diverziteti kulturor, përfshirë edhe atë fetar, është një barometër i edukimit qytetar dhe një prej elementeve përcaktuese të identitetit. Nxënësi duhet të kuptoj se nuk mund të jetohet i vetmuar dhe i izoluar vetëm në përkatësinë dhe identitetin e vet etnik, kulturor apo fetar, por në bashkëjetesë dhe interaksion të përditshëm me pjesëtarë të përkatësive dhe identiteteve tjera dhe se e bukura e të jetuarit në diverzitet, është sepse e pasuron identitetin personal, besa edhe atë kombëtar. Dallimet sigurisht se vërehen nga rajoni në rajon, sepse dihet që edhe vet struktura e nxënësve është mjaft heterogjene për sa i përket origjinave rajonale, sociale dhe kulturore. Këtë temë mësimdhënësi mund t'a realizojë duke kërkuar paraprakisht (një orë më herët) fotografi nga më të ndryshmet sa i përket llojllojshmërisë kulturore në rajonin ku jtojnë. Në këso rrethana, mësimdhënësi duhet të merr shënime, t'i shkruaj e më pastaj t'i rangojë, duke nxjerr dallimet dhe ngjashmëritë. Sigurisht se kjo na ndihmon që gradualisht të vijmë deri te analiza dhe krahasimi i kulturave të ndryshme. Domethënë, kësisoji kuptohet karakteri shumëdimensional dhe universal i multikulturalizmit, për dallim nga karakteri i ngushtë dhe i kufizuar i monokulturalizmit.

Tema **Ligji dhe procedurat për nxjerrjen e tij**, mund të realizohet asisoji që në kushte klase të simulohet një parlament i vogël. “Parlamentarët” në këtë rast, do të ishin vet nxënësit të cilët do t'i ndanin rolet sipas rekomandimit dhe ndihmës së mësimdhënësit. Qëllimi është që nxënësi t'i kuptojë procedurat e nxjerrjes së ligjeve dhe nevojën për debate për secilin ligj që aprovohet. Sado që duket teknike, nxjerrja e një ligji është proces kompleks ku janë të përfshira shumë palë dhe nxënësi është më rëndësi ta kuptojë rolin e secilës palë, pa marrë parasysh a është fjala për deputet, kryeparlamentar, grup parlamentar etj. Puna do të zhvillohej në grupe, dhe nga aty do të dalin “ligje” të propozuara të cilat mëpastaj do të miratohen me shumicë votash. E gjithë kjo zhvillohet nëpërmes aktivitetit të simuluar.

Tema **Shteti i së drejtës**, për nxënësin është e domosdoshme ta ndjejë dhe kuptojë mënyrën e funksionimit të shtetit ligjor, të organeve dhe institucioneve të tij, sepse vetëm në rrethanat e shtetit të së drejtës, kuptohet më së miri rëndësia e vlerave humane (paqa, liria, barazia, të drejtat e njeriut, e drejta humanitare, solidariteti, toleranca, bëmirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj.). Përveç se do t'i mësojë, nxënësi do të të përpiqet edhe t'i praktikojë këto në jetën e përditshme. Si mund të realizohet kjo? Kjo mund të bëhet edhe gjatë orës mësimore, por edhe jashtë orës mësimore. Meqenëse kemi të bëjmë me nxënës/fëmijë, mësimdhënësi sjell në klasë “Konventën mbi te Drejtat e Fëmijëve” që ka të bëjë mbi barazinë, lirinë, solidaritetin, mbrojtjen dhe në bazë të njohurive për këto vlera dhe të drejta, ata kuptojnë rëndësinë e shtetit të së drejtës. Ndërsa jashtë klasës, por në ambiente të shkollës, mund të

organizohen akcione të ndryshme vullnetare, kuptohet me ndihmën e mësimitdhënësve dhe tërë stafit shkollor. P.sh., çdo 9 Prill, me rastin e ditës së Kushtetutës së Kosovës, nxënësit organizojnë diskutim publik me temën: “Drejtësia, mbron çdo njeri dhe vendos rend dhe rregull në shoqëri”. Audiencia e këtij diskutimi do të përbëhet prej mësimitdhënësve, prindërve si dhe ndonjë të ftuari eventual nga strukturat qeverisëse të vendit apo organizatat ndërkombëtare.

Sa i përket temës **Ruajtja e mjedisit**, nxënësi nëse është i informuar mirë me përgjegjësitë e tij, ai do të jetë aktiv edhe në vendimmarrje në baza personale dhe grupore. P.sh, vendimet që merren në nivel klase, gjenerate, shkolle, komuniteti, apo edhe në nivel të pushtetit lokal dhe qendror, e senzibilizojnë atë për rëndësinë e mbjelljes së fidaneve, luleve, drunjëve etj., për estetizimin e hapësirës dhe për mbrojtjen jo vetëm shëndetin personal dhe publik. Në anën tjetër edhe pamja fizike e mjedisit do të dukej më e bukur dhe do t’iu sillte kënaqësi dhe lehtësi sidomos fëmijëve dhe të moshuarëve. Këto elemente i kontribuojnë jashtëzakonisht shumë edukatës dhe kulturës mjedisore në përgjithësi. E gjithë kjo do të mund të realizohet së bashku me këshillat e nxënësve, të prindërve, drejtuesve profesionalë të shkollës, përgjegjësve të komunitetit etj. Për këto, mësimitdhënësi duhet të bëjë plane në gjithëpërfshirjen e nxënësve, duke ua përshtatur aftësive për çka ata janë në gjendje të marrin vendime, p.sh, organizimet e ekskurzioneve me karakter mjedisor, marrja pjesë në aksione për pastrimin e mjedisit, gjelbërimin e hapësirave të pagjelbëruara, mbjelljen e luleve dhe fidaneve, apo edhe turniret, garat dhe aktivitetet tjera shkollore me fokus të veçantë mjedisin. Sigurisht se paraprakisht në shkollë është formuar dhe funksionon ndonjë klub ambientalist apo i riciklimit, higjienës etj. i cili me programin e Edukatës Qytetare të klasës së shtatë, ka qenë i paraparë të formohet.

Pra kompleksi apo paketa e llojllojshme e metodave dhe teknikave, përbën strategjinë e mësimitdhënies dhe se është në funksion të parimeve të kurrikulës gjithmonë duke pasur parasysh potencialet, interesat, stilet e të nxënësve të nxënësve dhe mundësinë e lidhjes së temave mësimore me situata dhe realitete jetësore.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Çështjet ndërkurrikulare janë tema që domosdo duhet ndërlidhur me rezultatet e fushës/lëndës mësimore andaj duhet t’i kushtohet vëmendje trajtimit adekuat të tyre. Nga mësimitdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e lëndës, temat dhe njësitë mësimore dhe të parashih se me cilat çështje ndërkurrikulare të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë të arsimit të mesëm të ulët ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi i tyre. Temat ndërkurrikulare që mund të përfshihen në lëndën Edukatë qytetare janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizmi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Temat mësimore që janë përcaktuar në programin lëndor të Edukatës qytetare natyrshëm lidhen me Çështjet ndërkurrikulare të përcaktuara në Kurrikulën bërthamë të arsimit të mesëm të ulët. Mësuesit i mbetet të identifikoj ato dhe të ndërlidhjet me temat, RNL-të dhe njësitë mësimore të përcaktuara sipas përmbajtjeve të seciles klasë.

## **Udhëzimet për vlerësim**

Vlerësimi bëhet me qëllim të përcjelljes së nxënësit, përparimit të tij dhe ndjekjes në progresin e nxënjes, shkathtësisë dhe veprimeve të cilat e ndihmojnë atë në krijimin e qëndrimeve, në bazë të vlerave të cilat shkolla detyrimisht duhet t'i kultivojë tek nxënësi. Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë, mjetet didaktike të nevojshme dhe kërkon konsistencë në gjithë procesin. Ajo realizohet në forma të ndryshme, njësoj si mësimdhënja, p.sh. testet e ndryshme si: teste verbale dhe joverbale, objektive dhe subjektive, vlerësim formativ dhe sumativ, prezantime të projekteve të ndryshme, aktivitete grupore etj. Mbi të gjitha qëllimi është të vëzhgohet përvetësimi i njohurive, sjelljeve, qëndrimeve dhe shkallës së arritjes së shkathtësive dhe aftësive të nxënësit, e në fund të fundit të vetëvlerësimit që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojë arritje sa më të lart.

Mendohet se vlerësimi është pjesa më e vështirë në tërë procesin e sistemit arsimor. Nëse koordinimit dhe planifikimit i qasemi jo vetëm në mënyrë obligative, por edhe me përgjegjësi, dinjitet dhe dashuri, atëherë sistemi i vlerësimit thuhet të gërshëtohet vetvetiu dhe sukseset nuk mungojnë. Varësisht nga nevojat, secili mësimdhënës duhet të jetë strateg i mirë i gjetjes së formave të vlerësimit të drejtë dhe adekuat, e të cilat gjithmonë janë të shumta. E nëse këto mungojnë, atëherë duhet që në mënyrë tabelare të paraqitet një pasqyrë e aspekteve të ndryshme të vlerësimit, në mënyrë që të shihet kur nxënësi ka nevojë për përmirësim, kur është i realizuar dhe kur është në nivel.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Edukata Qytetare mund të realizohet përmes një 'oqeani' burimesh dhe materialesh të ndryshme mësimore. Jo vetëm teksti bazë, por ka edhe shumë burime dhe mjete tjera në dispozicion, si: libra për ushtrime, fletore pune, broshura, gazeta, revista, postera, blogje,

faqe interneti, harta të ndryshme, leksikone, enciklopedi, gazeta ditore dhe periodike, programe radio-televizive, YouTube, projekte të ndryshme, raporte të publikuara, posterë të aktiviteteve publike, programe softverike, intervista me personalitete të shquara, vizita mësimore, vizita në terren, ekskursionë, bashkëpunime ndërinstytucionale, vizita të ekspertëve në klasë, vizita në teatër, në kinema, në koncert, festival filmi etj.

Natyrisht se të gjitha këto burime duhet t'i sigurojë mësimdhënësi në bashkëpunim me stafin e shkollës, stafin prindëror etj. Këtu hyjnë edhe materialet tjera nga UNICEF-i, UNESCO, Këshilli i Evropës dhe organizata tjera të njohura ndërkombëtare. Me ndihmën e mësimdhënësit, gjithashtu nxënësi mund të jetë ndihmëtar shumë i denjë në sigurimin e këtyre materialeve punuese. Ai duhet angazhuar që të hulumtojë sa më shumë në mënyrë të pavarur individuale ose në grup, për tema të caktuara dhe me interes për lëndën.

**FUSHA KURRIKULARE: EDUKATË  
FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**  
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Programi i lëndës mësimore Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti është njëra nga shtatë fushat e KK-së e cila është pjesë e nivelit të dytë dhe shkallës së katërt të Kornizës kurrikulare të Kosovës dhe Kurrikulës Bërthamë.

Lënda edukatë Fizike, sportet dhe shëndeti ndihmon nxënësit që të kuptojnë rëndësinë e aktiviteteve fizike, sportive dhe shëndetësore dhe rekomandohet që nxënësit të angazhohen në nivelin e duhur dhe të përshtatshëm në realizimin e aktivitetit fizik gjatë gjithë jetës së tyre. Aktivitetet fizike në mënyrë të rregullt kthehen në mjet të rëndësishëm për përmirësimin e shëndetit në përgjithësi, fizik, psikik, emocional dhe social.

Aktiviteti fizik nuk është vetëm marrja me sport, por çdo lëvizje trupore e prodhuar nga muskujt skeletor, që kërkon shpenzime të energjisë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për të qenë të shëndetshëm, njerëzit kanë nevojë për aktivitet fizik të moderuar.

## Qëllimi

Qëllimi i lëndës Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti është të kontribohet në arritjen e rezultateve të kompetencave për shkallën e katërt si dhe arritjen e rezultateve të programit lëndor ku nëpërmjet tyre kontribuojmë në arritjen e rezultateve të fushës për shkallën e katërt të planifikuara në Kurrikulën Bërthamë.

Nëpërmjet programit lëndor të Edukatës fizike, sporte dhe shëndeti nxënësit ndihmohen të zhvillojnë njohuritë, shkathësitë, shprehitë, vlera, qëndrimet dhe kompetencat e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

- Lojërat elementare dhe shërbimet profesionale
- Antropometria dhe motorika
- Gjimnastika dhe Atletika
- Tekniko-taktika e sporteve kolektive dhe individuale
- Ushqimi dhe prejidhja e tij
- Veprimi i substancave që krijojnë varshmëri
- Mjedisi dhe ndikimi i njeriut

<b>Koncepti</b>	<b>RNF, TEMA dhe RNL</b>	
<b>Mirëqenie e plote fizike, psikike, emocionale dhe sociale</b>	<i>1. Identifikon persona dhe shërbime në mjedisin ku jeton dhe di ku të kërkoje shërbime dhe mbështetje profesionale për të ruajtur mirëqenien fizike, psikike, sociale dhe emocionale</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Lojërat elementare dhe shërbimet profesionale</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon personat dhe shërbimet profesionale që përkrahin në edukimin shëndetësor dhe sportiv.</li> <li>• Praktikon aktivitete, lojëra të ndryshme elementare sportive që kontribuojnë në ruajtjen e shëndetit fizik, psikik, emocional dhe social.</li> </ul>
<b>Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive</b>	<i>1. Merr pjesë aktive në disiplina të ndryshme sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) aplikon përvoja e fituara në mënyrë të rregullte përmes aktiviteteve fizike dhe krijon kombinime lëvizore me përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.</i>	
	<i>2. Përshkruan, zbaton dhe ndërlidh rregullat e sporteve kolektive duke përforcuar shprehitë motorike dhe shkathtësitë lëvizore gjatë ushtrimit të taktikave të sportet kolektiveshme të lëvizjes.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Antropometria dhe motorika</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan rezultatet antropometrike, krahason me ato paraprake si dhe paraqet hapat për të ardhmen</li> <li>• Demonstron shkathtësi gjatë matjeve motorike, krahason rezultatet e arritura me rezultatet paraprake dhe harton plan për përmirësimin e tyre</li> </ul>
<b>Gjimnastika dhe Atletika</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan diciplinat e gjimnastikës ritmike sportive dhe realizon kompozim ushtrimesh të ndryshme në parter, pa vegla, me vegla dhe mbi vegla</li> <li>• Kompon valle popullore dhe moderne të trevave të ndryshme</li> <li>• Përshkruan diciplinat e atletikës dhe shpjegon fazat e</li> </ul>	



		realizimit të teknikave gjatë zhvillimit të shkathtësive dhe demonstrimit të tyre
	<b>Tekniko-taktika e sporteve kolektive dhe individuale</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbaton rregullat e përgjithshme gjatë demonstrimit të elementeve tekniko - taktike dhe lojës të sportet kolektive si basketboll, volejboll, futboll dhe hendboll</li> <li>• Zbaton rregullat e përgjithshme gjatë demonstrimit të elementeve tekniko - taktike të sportet individuale si pingpong, tenis, badminton, not, ski dhe sportet luftarake</li> </ul>
<b>Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm te jetës</b>	<i>1. Identifikon nëpërmjet aktiviteteve praktike , përbërësit kryesor të ushqimit, prejardhjen (burimin) e tyre, funksionin dhe përshkruan lidhjen ne mes të energjetikës, ushqimit dhe shëndetit fizik</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Ushqimi dhe prejardhja e tij</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon përbërësit kryesor të ushqimit dhe prejardhjen e tij</li> <li>• Përshkruan lidhjen mes energjetikës, ushqimit dhe shëndetit fizik</li> <li>• Eksploron rëndësinë e ushqimeve kryesore për shumë njerëz në mbarë botën</li> <li>• Hulumton për ndikimin që ka ushqimi dhe uji i kontaminuar si burim i sëmundjeve</li> </ul>
<b>Vetëdijesimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri</b>	<i>1.Kupton efektet pozitive që disa substanca mund të ketë në mendjen dhe trupin, por gjithashtu është i vetëdijshëm për pasojat negative dhe të rënda fizike, mendore, emocionale, sociale dhe juridike që ka keqpërdorimi i substancave.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Veprimi i substancave që krijojnë varshmëri</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton efektet e veprimit të substancave që krijojnë varshmëri</li> <li>• Përshkruan ndryshimet fizike, mendore, emocionale dhe sociale nga perdorimi i substancave</li> </ul>
<b>Edukimi mbi mjedisin dhe</b>	<i>1.Përdor burimet natyrore për zhvillimin e aftësive fizike dhe shëndetit duke u kujdesur për respektuar mjedisin ku vepron</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>

<b>zhvillimin e qëndrueshëm</b>	<b>Mjedisi dhe ndikimi i njeriut</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullon të dhënat për mjedisin në rrethin ku jeton</li> <li>• Përshkruan ndryshimet mjedisore në nivel lokal dhe global</li> <li>• Hulumton për mënyrën se si mjediset janë përkeqësuar dhe janë përmirësuar në nivel lokal dhe global?</li> </ul>
---------------------------------	--------------------------------------	--

## Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjes në Lëndën Edukate Fizike Sportet dhe Shëndeti për klasën e tetë mësimdhënësi duhet të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të cilat janë në përputhje me moshën e nxënësve por edhe t'i përshtaten përmbajtjes në mënyrë që të arrihen rezultatet e përcaktuara me program.

Realizimi përmbajtjes së lëndës duhet të zhvillojnë dhe stimulojnë tek nxënësit një shëndet sa më të plotë në aspektin fizik, psikologjik, shpirtëror dhe shoqëror; formojnë aftësi dhe shprehje lëvizore të vlefshme për të gjithë jetën, si dhe një model të jetës aktive. Për këtë është në detyrën e mësimdhënësit që gjatë planifikimit të përzgjedhë ato aktivitete lëvizore dhe sportive që, së pari, sigurojnë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve (si të djemve, ashtu dhe të vajzave) dhe së dyti, këto aktivitete të sigurojnë pjesëmarrje të motivuar duke respektuar interesat lëvizore, estetike dhe sportive të nxënësve të tyre.

Në klasën e tetë theksi vihet edhe në promovimin e stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës duke përfshirë edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në fitimin e praktikave të sigurta dhe shprehive të nxënësit në mënyrë që të ndiqen gjatë jetës së tyre duke i mbrojtur ata në të ardhmen.

Mësimdhënia në vetvete është një proces ndërveprues, dhe ka të bëjë me faktin se funksioni dhe qëllimi kryesor i kësaj mësimdhënieje është të nxënit. Kjo është karakteristika më themelore e të gjithë metodave dhe teknikave me në qendër nxënësin përfshi edhe metoda tjera të cilat sigurojnë mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit siç janë: metoda verbale e cila ka përdorim të gjërë në mësimin e edukatës fizike, sportet dhe shëndeti, pastaj metoda e demonstrimit është shumë efikase për përvetësimin e lëvizjeve të reja nga ana e nxënësve, metoda integrale (e tërësisë) e ushtrimit praktik përdoret për paraqitjen e ushtrimit në tërësi me të gjitha pjesët përbërëse të tij, metoda analitike (e pjeshme) ndihmon në përvetësimin e ushtrimeve komplekse dhe më të vështira, diskutimi, stuhi mendimesh (brainstorming), prezantimet, punëtoritë, etj., ka edhe metoda tjera të cilat mësimdhënësi i përzgjedh në varësi nga përmbajtja e tematikave.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike duke pasur gjithnjë parasysh dhe sigurinë e nxënësve.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të fushës është një aspekt me shumë rëndësi pasi mundëson integrimin e fushave kurrikulare me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare ndihmon zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në këtë nivel janë:

- **Globalizimi dhe ndërvarësia** (i referohet bashkëveprimit, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha)
- **Edukimi për medie** (i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes medieve tradicionale dhe digjitale, kritikën ndaj medieve, gjuhën e medieve dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediet dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurt)
- **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm** (i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global).

Në përgjithësi rezultatet e fushës i prekin çështjet ndërkurrikulare andaj kujdes do t'i kushtohet trajtimit adekuat në njësitë mësimore. Megjithatë parësore është puna e mësimitdhënësit i cili gjatë punës t'i kushtoj kujdes çështjeve ndërkurrikulare që në fazën e planifikimit të analizojnë njësitë mësimore me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen në mënyrë që të sigurohet të nxënit i integruar cili synon përfshirjen e të gjitha aspekteve të rëndësishme shoqërore të trajtohen nga lëndë të ndryshme dhe me këndvështrime të ndryshme që mundësojnë edhe arritjen e kompetencave të përcaktuara me KK.

## **Udhëzimet për vlerësim**

Vlerësimi ka për qëllim mbledhjen sistematike të informatave të arritjeve të nxënësit gjatë procesit të të nxënit, përkrahjen e nxënësit në zotërimin e rezultateve të të nxënit, përcaktimin e nivelit të performancës për secilin nxënë. Vlerësimi i bazuar në kompetenca, në vete përmban informata të hollësishme kthyesë të sakta dhe kritike përmbajtësore e konstruktive për të ndihmuar nxënësin në arritjen e rezultateve të të nxënit dhe në zotërimin e kompetencave.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet dhe vlerat e nxënësve. Mësimdhënësi/ja zhvillon një larmi mënyrash vlerësimi për shembull:

- Përshkrim gojor të lëvizjeve që duhet përmirësuar.
- Përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit.
- Testi me shkrim i standardizuar
- Pjesëmarrja aktive gjatë orës mësimore
- Ese ( hulumtim individual apo grupor për temat e edukimit shëndetësor )
- Prezantim rasti
- Video incizimet

Ndërkaq të edukimi fizik dhe sportet fokusi i mësimdhënësit duhet të jete në vlerësimin e këtyre elementeve:

- Korrigjim me takt i lëvizjeve të gabuara
- Lista e kontrollit
- Pjesëmarrja aktive ne lojërat elementare gjatë orës mësimore
- Me zgjedhjen e nxënësve më të shpejt në vrapim
- Me kompozim ushtrimesh fizike dhe me pikë
- Me sistem pikësh për ushtrimet e veçanta
- Me sistem pikësh për vallëzimin e kompozuar
- Me pikë për veprime individuale
- Me pikë për grupin me të mirë gjate lojës apo garës
- Me pikë për skemat lëvizore të vrapimeve të ndryshme.

Këtyre vlerësimeve mund t'u shtohen edhe vlerësimet mbi aktivizimin në veprimtaritë e ndryshme sportive.

Portfolio e nxënësve është mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi, është një përmbledhje e performances gjatë vitit shkollor për një fushë të caktuar. Mund të përmbajë detyra tematike praktike, foto dhe CD të demonstrimit të aftësive lëvizore për linja të ndryshme të programit, angazhime në veprimtari të ndryshme shkollore, etj.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që i motivojnë fëmijët dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të krijojnë shprehi dhe shkathtësi të nevojshme për jetë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet, librat e aktiviteteve dhe të

ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Mësimdhënësi dhe nxënësit mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

# **FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE PUNA**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor  
Teknologji me TIK**

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Teknologji me TIK**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## **Hyrje**

Fusha Jeta dhe Puna përbëhet nga lëndët kryesore Teknologji me TIK dhe konceptet tjera në fushë.

Lënda Teknologji me TIK në klasën e VIII synon të zhvillojë shkathtësitë praktike teknologjike tek nxënësit duke filluar me paraqitjen e trupave, përdorimin e metaleve, njohjen e motorëve, llojet e transmetuesve, funksionin e mekanizmave, teknologjinë e materialeve makinerike, përdorimin e pajisjeve teknike, trafiku, paraqitja e rolit të simuluesve si dhe përpunimi dhe llogaritja e të dhënave me program kompjuterik duke zhvilluar të menduarit kritik gjatë krijimit të projekteve praktike teknologjike.

Në kuadër të lëndës Teknologji me TIK do të zhvillohen module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 4 si: Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Puna dhe Edukimi për ndërmarrësi si dhe Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për të arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna.

Përmes Teknologjisë dhe TIK-ut, ndërmarrësisë, orientimit në karrierë, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do ta zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin për ekzistimin e mundësive të orientimit profesional (përzgjedhja e profesionit), përdorimit të TIK-ut etj.

## **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë të menduarit kritik tek nxënësit duke i aftësuar ata në zgjidhje të problemeve praktike, marrjen e vendimeve, punën e pavarur, punën me projekte me përdorimin e TIK-ut, shkathtësitë për jetë, si dhe i orienton ata drejt qëllimeve të veta.

## **Temat dhe rezultatet e të nxënit**

Nxënësit në klasën e tetë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Jeta dhe Puna, të shkallës së katërt të kurrikulës (Shk 4) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.



Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Teknologji duke përfshirë TIK-un	<p><b>RNF:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup</li> <li>1.2 Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.</li> </ol> </li> <li><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>2.1 Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje orientimi në karrierë.</li> </ol> </li> <li><b>3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>3.1 Përdor vegla, pajisje dhe makina punuese bazuar në udhëzime dhe doracakë për përdorim.</li> <li>3.2 Përshkruan procesin teknologjik të shfrytëzimit të burimeve natyrore të energjisë.</li> </ol> </li> <li><b>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>4.1 Zbaton njohuri nga TIK për prezantimin e proceseve të caktuara.</li> <li>4.2 Përdor programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore.</li> </ol> </li> <li><b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>6.1 Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon.</li> </ol> </li> <li><b>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>7.1 Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.</li> </ol> </li> <li><b>8. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>8.1 Zhvillon aktivitete për çështjet e drejtësisë sociale, etikën dhe mirëqenien, duke lidhur me faktorët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë.</li> <li>8.2 Analizon dhe vlerëson përparësitë e përdorimit të llojeve të ndryshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit ku jeton.</li> </ol> </li> </ol>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Tema 1 - Shkathtësië e dizajnit (Paraqitja e trupave)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Nxënësi/nxënësja:</b></li> <li>• Identifikon elementet e vizatimit teknik të objekteve.</li> <li>• Tregon llojet e prerjeve të paraqitura në materialin shkollor.</li> <li>• Përshkruan paraqitjen e thjeshtësuar dhe skematike të detaleve makinerike.</li> <li>• Vizaton projeksionet aksonometrike, izometrike, dymetrike, të pjerrët.</li> <li>• Shpjegon projeksionet aksonometrike, izometrike,</li> </ul>

		<p>dymetrike, të pjerrët dhe si paraqiten ato.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ilustron shpalosjen e sipërfaqeve të formave të ndryshme.</li> <li>• Paraqet skema të thjeshta të dhëmbëzorëve.</li> <li>• Krijon sipërfaqe të ndryshme të shpalosura me të cilat krijohet një objekt.</li> <li>• Paraqet trupat 2D dhe 3D me vizatim teknik me vegla dhe programe kompjuterike.</li> </ul>
	<p><b>Tema 2 - Teknologjia e materialeve - Materialet makinerike</b></p>	<p><b>Nxënësi/nxënësj:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqet llojet e veglave për përpunim të materialeve makinerike.</li> <li>• Harton masat mbrojtëse në punë për përdorimin e materialeve makinerike.</li> <li>• Tregon vetitë e materialeve makinerike (fizike, kimike, teknologjike), rëndësinë që ato kanë dhe përdorimin e tyre në teknologji.</li> <li>• Përshkruan si prodhohen dhe përpunohen metalet dhe legurat (aliazhet) (lëmimi, pastrimi, farkimi, derdhja, ngjitja, mbrojtja sipërfaqësore etj.) përmes proceseve teknologjike.</li> <li>• Përshkruan përdorimin e metaleve bakri, zinku, plumbi, ari etj., si dhe krahason ato me materialet plastike.</li> <li>• Diskuton dhe përshkruan përpunimin e metaleve: përgatitjen teknike (bën planifikimin), matjen dhe kontrollin, shkruarjen, lëmimin, farkimin, pastrimin, ngjitja, mbrojtja sipërfaqësore.</li> <li>• Identifikon llojet e profileve të plota dhe të zbrazëta nga materiali i çelikut dhe hekurit.</li> <li>• Përshkruan proceset e matjes së materileve makinerike përmes matësve të ndryshëm.</li> <li>• Përshkruan llojet dhe funksionin e makinave për përpunimin e metaleve (shpuese, zdrukthtuese, frezuese, ratifikuese, tornuese, me drejtim numerik etj.).</li> <li>• Përshkruan pjesët përbërëse dhe funksionin e robotit.</li> <li>• Përshkruan funksionin e Lego robotit si makinë programuese dhe e ndërton atë përmes programit kompjuterik.</li> </ul>

	<p><b>Tema 3 - Mekanizmat dhe transmetuesit</b></p>	<p><b>Nxënësi/nxënësj:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon llojet e mekanizmave lëvizës dhe transmetuesve bazuar në literaturën shkollore.</li> <li>• Përshkruan parimin e punës dhe funksionin e mekanizmave, makinave lëvizëse, trasnmetuesve, motorëve dhe përbërjen e tyre.</li> <li>• Ndërton mekanizma të ndryshëm me leva, me gungë me materiale: druri, plastike, letër, metal.</li> <li>• Krijon transmetuesit me rripa me dy rrota udhëzuese me diamtër të ndryshëm.</li> <li>• Tregon disa lloje të motorëve me djegie të brendshme.</li> <li>• Përshkruan funksionin e motorëve me djegie të brendshme dhe të jashtme.</li> <li>• Analizon funksionin e motorëve me djegie të brendshme dhe të jashtme.</li> </ul>
	<p><b>Tema 4 – Pajisjet teknike</b></p>	<p><b>Nxënësi/nxënësj:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon paisjet teknike per ngrohje dhe ftohje.</li> <li>• Përshkruan veglat për punë dhe pajisjet për mësimdhënie.</li> <li>• Demonstron me shembuj konstruktin e lavatriçes, bojlerit, ujtisë, mikserit dhe të pajisjeve tjera si dhe përdorimin e tyre në praktikë.</li> <li>• Kryen aktivitete praktike me anë të paisjeve teknike për mësimdhënie që ndodhen në kabinet.</li> <li>• Dallon pajisjet teknike shtëpiake nga ato që përdoren për mësimdhënie në shkollë.</li> <li>• Tregon konstruksionin e shporetit elektrik, frigoriferit dhe pajisjet tjera si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.</li> <li>• Tregon konstruksionin e stufës termoakumuluese, klima pajisjes dhe mënyrën e përdorimit të tyre.</li> <li>• Demonstron me shembuj konstruktin e lavatriçes, bojlerit, ujtisë, mikserit dhe përdorimin e tyre.</li> <li>• Tregon ndërtimin e shtëpizës dhe monitorit të kompjuterit.</li> <li>• Përshkruan ndërtimin e një aparati digjital, projektori, TV i mençur, telefoni i mençur.</li> <li>• Diskuton punën që kryen makina rrobalarëse, bojleri,</li> </ul>

		<p>hekuri, mikseri etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan masat mbrotjese në punë me çdo pajisje teknike.</li> </ul>
	<p><b>6. Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit</b></p>	<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor në mënyrë të pavarur programin për llogaritje të të dhënave.</li> <li>• Tregon rolin dhe funksionin e programit për llogaritje.</li> <li>• Krijon detyra të ndryshme me llogaritje përmes programit kompjuterik.</li> <li>• Inserton objekte të ndryshme për krijimin e prezentimeve dhe projekteve shkollore.</li> <li>• Krijon tabela, grafikone të thjeshta dhe smart art për paraqitjen e të dhënave të ndryshme përmes programit kompjuterik.</li> <li>• Krijon projekte të ndryshme digjitale për teknologjinë, mjedisin, materialet, bazë të dhënash etj., përmes programeve për llogaritjen e të dhënave.</li> <li>• Përdor programin për kalkulim me shembuj të gatshëm për krijimin e kalendarëve, tabelës për projekt, orarin e punës etj.</li> <li>• Përpunon, modifikon dhe komprimon fotografi përmes programeve kompjuterike.</li> <li>• Krijon kolazhe të ndryshme me fotografi përmes programeve profesionale duke i modifikuar dhe ndryshuar sipas neovjës.</li> <li>• Përpunon dhe organizon dokumente të ndryshme në formatin PDF.</li> <li>• Përshkruan rolin e simuluesve (simulatorëve) digjitalë në mësimdhënie efektive.</li> <li>• Përdor simulatorë të ndryshëm për simulimin e aktiviteve të ndryshme teknologjike.</li> <li>• Krijon simulatorë të ndryshëm përmes programeve kompjuterike.</li> </ul>
<p><b>Këshilli m dhe orientim në karrierë</b></p>	<p><b>RNF</b></p> <p><b>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.</b></p> <p><b>1.1. Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin.</b></p> <p><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b></p>	

	<p>2.1. Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje orientimi në karrierë.</p> <p><b>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</b></p> <p>7.1. Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar me dëshirat, njohuritë dhe shkathtësitë personale.</p> <p><b>8. Komunikimi në / për jetë dhe punë</b></p> <p>8.1. Hulumton dhe përdorë burime të ndryshme të informimit për arsimim, aftësim për tregun e punës me qëllim të përzgjedhjes së opsioneve për orientim në karrierë.</p>				
	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="367 537 586 569">Tema</th> <th data-bbox="586 537 1448 569">Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="367 569 586 1077"><b>7. Karriera ime</b></td> <td data-bbox="586 569 1448 1077"> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon shërbimet vullnetare në rrethin e tij ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare.</li> <li>• Identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm.</li> <li>• Krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij të ardhshme.</li> <li>• Analizon dhe përdor burimet e ndryshme të informimit për karrierë.</li> <li>• Hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj.</li> </ul> </td> </tr> </tbody> </table>	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	<b>7. Karriera ime</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon shërbimet vullnetare në rrethin e tij ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare.</li> <li>• Identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm.</li> <li>• Krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij të ardhshme.</li> <li>• Analizon dhe përdor burimet e ndryshme të informimit për karrierë.</li> <li>• Hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj.</li> </ul>
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)				
<b>7. Karriera ime</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon shërbimet vullnetare në rrethin e tij ku jeton dhe analizon mënyrën e punës vullnetare.</li> <li>• Identifikon dhe vlerëson interesat, shkathtësitë dhe aftësitë për profesionin e tij të ardhshëm.</li> <li>• Krijon dhe zbaton planin e projektit, përmes aktiviteteve për të zhvilluar shkathtësitë për karrierën e tij të ardhshme.</li> <li>• Analizon dhe përdor burimet e ndryshme të informimit për karrierë.</li> <li>• Hulumton tregun e punës dhe profesionet më të kërkuara në vitet e fundit dhe përzgjedh disa prej tyre, në bazë të aftësive dhe shkathtësive të tij/saj.</li> </ul>				
<p><b>Puna dhe edukimi për ndërmar rësi</b></p>	<p><b>RNF:</b></p> <p><b>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b></p> <p>1.1 Analizon punën vullnetare, punësimin dhe vetëpunësimin.</p> <p>1.2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup.</p> <p>1.3 Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.</p> <p><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b></p> <p>2.1 Demonstron shkathtësitë e nevojshme për qasje orientimi në karrierë.</p> <p><b>3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b></p> <p>3.1 Përdor vegla, pajisje dhe makina punuese bazuar në udhëzime dhe doracakë për përdorim.</p> <p>3.2 Përshkruan procesin teknologjik të shfrytëzimit të burimeve natyrore të energjisë.</p> <p><b>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p>4.1 Zbaton njohuri nga TIK për prezantimin e proceseve të caktuara.</p> <p>4.2 Përdor programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore.</p>				

	<p><b>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit</b></p> <p>5.1 Analizon tregun e punës dhe përgatit pilot plane të biznesit, individualisht apo në grup dhe i prezanton ato përmes formave të ndryshme të komunikimit.</p> <p><b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b></p> <p>6.1 Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon.</p> <p><b>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</b></p> <p>7.1 Analizon preferencat e profesionit të dëshiruar, duke e argumentuar, me dëshirat, njohuritë dhe shkathhtësitë personale.</p> <p><b>8. Komunikimi në / për jetë dhe punë</b></p> <p>8.1 Hulumton dhe përdor burime të ndryshme të informimit për arsimim, aftësim për tregun e punës me qëllim të përzgjedhjes së opsioneve për orientim në karrierë.</p> <p><b>9. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi</b></p> <p>9.1 Zhvillon aktivitete për çështjet e drejtësisë sociale, etikën dhe mirëqenien, duke lidhur me faktorët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë.</p> <p>9.2 Analizon dhe vlerëson përparësitë e përdorimit të llojeve të ndryshme të energjisë në ruajtjen e mjedisit ku jeton.</p>				
	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="367 951 630 993">Tema</th> <th data-bbox="630 951 1458 993">Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="367 993 630 1430"><b>8. Ndërmarrësi i ri</b></td> <td data-bbox="630 993 1458 1430"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon llojet e tregut vendor.</li> <li>• Identifikon interesat dhe nevojat.</li> <li>• Përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes.</li> <li>• Krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur)</li> <li>• Përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara.</li> <li>• Përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).</li> </ul> </td> </tr> </tbody> </table>	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	<b>8. Ndërmarrësi i ri</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon llojet e tregut vendor.</li> <li>• Identifikon interesat dhe nevojat.</li> <li>• Përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes.</li> <li>• Krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur)</li> <li>• Përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara.</li> <li>• Përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).</li> </ul>
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)				
<b>8. Ndërmarrësi i ri</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon llojet e tregut vendor.</li> <li>• Identifikon interesat dhe nevojat.</li> <li>• Përshkruan punën e ndërmarrësit në biznes.</li> <li>• Krijon ide të reja për nxitjen e shpirtit ndërmarrës (20 euro në rrugën e duhur)</li> <li>• Përpilon plan biznesi të thjeshtë (simple) me idetë e planifikuara.</li> <li>• Përdor pako të ndryshme për të kuptuar funksionin e ndërmarrësisë (loja e monopolit, shkëmbimi i valutave, imitimi i tregut).</li> </ul>				
<p><b>Edukim për zhvillim të qëndrueshëm</b></p>	<p><b>RNF:</b></p> <p><b>1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b></p> <p>1.2 Planifikon, organizon dhe merr pjesë në aktivitetet praktike individuale dhe në grup.</p> <p>1.3 Planifikon dhe zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.</p> <p><b>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p>4.1 Zbaton njohuri nga TIK për prezantimin e proceseve të caktuara.</p> <p>4.3 Përdor programe kompjuterike për zbatimin praktik të njësive dhe temave mësimore.</p>				

<p><b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b></p> <p>6.1 Identifikon dhe parandalon rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndodhin në vendin ku punon.</p> <p><b>8. Komunikimi në / për jetë dhe punë</b></p> <p>8.1 Hulumton dhe përdor burime të ndryshme të informimit për arsimim, aftësim për tregun e punës me qëllim të përzgjedhjes së opsioneve për orientim në karrierë.</p> <p><b>9. Zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe mjedisi</b></p> <p>9.1 Zhvillon aktivitete për çështjet e drejtësisë sociale, etikën dhe mirëqenien, duke lidhur me faktorët socialë, ekonomikë dhe ekologjikë.</p>	
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)</b>
<b>5. Teknologjia e transportit - Trafiku</b>	<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon llojet e transportit tokësor, ujor dhe ajror.</li> <li>• Përshkruan rëndësinë e transportit dhe mjeteve të transportit.</li> <li>• Paraqet grafikisht shenjat kryesore të trafikut dhe rolin e tyre në komunikacion.</li> <li>• Përshkruan rëndësinë e respektimit të rregullave në trafik.</li> <li>• Përshkruan përparësitë e disa llojeve të veçanta të transportit.</li> <li>• Identifikon rreziqet e mundshme në trafik.</li> <li>• Tregon detyrat që kryejnë sistemet drejtuese në transport.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies përkufizohet si: sistem i strategjive, metodave, mënyrave e parimeve, mjeteve e teknikave, të cilat na shërbejnë si bazë për ndërtimin e konceptit të mësimin ose për organizimin e dhënies së mësimin në shkollë.

Në KK-në e re metodologjitë bazë të mësimdhënies janë:

Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen: që si pjesë e saj në Teknologji me TIK mësimdhënësi/ja duhet të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes, i cili merr parasysh dhe adreson stilet e ndryshme të të nxënës, mënyrën dhe shpejtësinë me të cilën mësojnë nxënësit, si dhe aspektet e tjera të diversitetit të nxënësve, duke përfshirë gjininë, moshën, kulturën, prejardhjen shoqërore dhe ekonomike, si dhe nevojat e veçanta të nxënësve, qoftë për aspektet e nxënies plotësuese qoftë për ato të nxënies shtesë.

Si metodologji tjetër me rëndësi të madhe është dhe mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca ku përmes aktiviteteve praktike, instrumenteve në orë mësimore mund të aplikojmë në zhvillimin e kompetencave si mendimtar kreativ, nxënës i sukseshëm etj.

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar - nxënësit në këtë pjesë synohet të angazhohen në forma sipas stileve të të nxënës dhe formave të paraqitjes së ideve të tyre. Duke planifikuar mësimin, aktivitetin, instrumentet në formën e individit, jo grupit, atëherë themi se kemi analizuar secilin nxënës në orë duke arritur nxënien e diferencuar.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

*Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të realizohet përmes:*

- Gjetjes së korrelacioneve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim të realizimit të ndonjëris nga kompetencat, p.sh., nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, ajo ndërlidhet edhe me çështje gjuhësore, letrare, teknologjike por edhe me matematikë, edukatë qytetare etj. (shih në KB).

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në çështjet jashtëkurrikulare - një metodë ku nxënësit mund të zhvillojnë aktivitete jashtëmësimore p.sh.: vizita në laboratore të mekatronikës, në pyje, në fabrikë tekstili etj.

Metodologjia ndërlidhë përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve në të nxënës e fushave mësimore me rezultatet e të nxënës të kompetencave kryesore – për shkallë dhe nivele.

Thuajse, e gjithë veprimtaria e fushës Jeta dhe Puna bazohet në punën praktike. Metodatat që përdoren te kjo fushë duhet të mundësojnë konkretizimin e teorisë në praktikë.

Të nxënës në bashkëpunim bën të mundur që nxënësit të nxënë në mënyrë aktive dhe të shprehin shkathtësitë e tyre praktike. Të nxënës në bashkëpunim nxit të menduarit e rendit të lartë, ngre motivimin dhe moralin, mësohen shprehitë ndërvejtjake, nxit mirëkuptimin midis nxënësve dhe grupeve etj.

Gjatë zbërthimit dhe përdorimit të metodologjive në orët mësimore, mund të përdoren dhe shumë teknika mësimore që përshtaten me pjesën hyrëse, realizimin e aktivitetit (përmabjtjes) dhe pjesën reflektuese me përdorimin e të menduarit kritik dhe përshtatjes së aktiviteve: Organizuesi veprues, Insert, Demonstrim, Shqyrtimi i përbashkët etj.

Të gjitha këto teknika mund të modifikohen varësisht nga njësia dhe kërkesa e përmbajtjes.

Është me rëndësi që secili mësimdhënës në lëndën Teknologji me TIK varërisht nga numri i nxënësve dhe njohuritë e tyre të identifikojnë drejtë përdorimin e secilës metodologji që dërgon deri te arritja e rezultateve.

## **Çështje ndërkurrikulare**



Në kuadër të fushës kurrikulare Jeta dhe Puna, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj është realizimi i çështjeve ndërkurrikulare. Kjo do të ndihmojë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medias;
- Zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;
- Barazia gjinore dhe toleranca;
- Puna vullnetare;
- Edukimi për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore;
- Shkathtësitë për jetë;
- Komunikimi ndërkurrikular përmes TIK-ut;
- Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie.

Më shumë për këto çështje konsultoni Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

## **Udhëzime për vlerësim**

Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënësve në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNK-kompetencat dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime, duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KK, respektivisht KB-të (Kapitulli VII).

Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e vlerësimit të vazhdueshëm, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor, bëhet vlerësimi përfundimtar në nivel klase dhe për secilën fushë kurrikulare, lëndë mësimore, nxënësit i vendoset nota shkronjë/numër, siç është paraparë në KB-të. Me të njëjtën procedurë duhet vazhduar me vlerësimin edhe në klasat pasuese përbrenda shkollës së caktuar kurrikulare dhe kështu për të arritur te vlerësimi përmbyllës në nivel shkalle kurrikulare (lexo procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe përmbyllës në KB-të, kapitulli VII).

Vlerësimi tashmë duhet të bazohet në UA 08.2016 i cili përcakton qartë ndarjen e vlerësimit në periudha, gjithashtu vlerësimin e bazuar në shkollën përkatëse.

Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari, për fushën e caktuar kurrikulare, përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Pastaj përcaktojmë nivelin e arritjes të kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës dhe nuk janë të zërthyer (kujto zërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë!). Shih pjesën e udhëzuesit II.3.1, Rezultatet e të nxënit për shkallë–kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre shembullin e zërthimit të rezultatit III.3, IV.1 (niveli III) dhe IV.1. (niveli II);
- Më pas caktohet tema apo njësia mësimore përmes së cilës matim rezultatin e kompetencës;
- Në fund caktohen kriteret e vlerësimit dhe teknikat e instrumentet adekuate përmes së cilave maten rezultatet e kompetencave (RNK).

*Një shembull i duhur për matjen e RNK-së:*

KOMPETENC A I.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Komunikues efektiv	AKTIVITETI	NIVELI I ARRITJES SË NXËNËSIT					KOMENTE	LLOJET E PÛRKRAHJES PÛR NXËNËSIN			
		1	2	3	4	5		PÛrkrahja pÛr mirÛsuese	MÛnyra	PÛrkrahja pÛr tÛ talentuarin	MÛnyra
II.Harton planin e punes per realizimin e nje krijimi/detyre duke percaktuar fazat kryesore sipas fushes mesimore (letrar, shkencor, artistik).	I.Skicimi i objekteve tÛ ndryshme me pÛrmasa tÛ zvogÛluara nÛ perspektive							UdhÛzimi i drejt nÛ format e skicimit, paraqitjes objekteve me dorÛ tÛ lirÛ dhÛnia e nÛj shembulli nga vet mÛsimdhÛnÛsi	Forma grupore duke nxitur bashkÛpunimi min drejtÛ pÛr mirÛsimin nÛ skicim tÛ drejtÛ tÛ objekteve.	Skicimi i dy apo mÛ shumÛ modeleve tÛ objekteve me forma dhe pÛrmasa tÛ ndryshme.	Forma individuale qÛ nxjerr nÛ pah nxÛnÛsit mÛ tÛ talentuar.

*Si mund tÛ bÛhet vlerÛsimi i arritjes sÛ rezultateve tÛ tÛ nxÛnit pÛrmes njÛsisÛ mÛsimore?*

Pasi keni pÛrzgjedhur njÛsinÛ mÛsimore qÛ do tÛ zhvilloni nÛ ditÛt nÛ vijim, hartoni njÛ plan vlerÛsimi pÛr kÛtÛ njÛsi. PÛrcaktoni rezultatet e tÛ nxÛnit mbi bazÛn e RNSH dhe RNF (RNL), zgjidhni njÛ teknikÛ tÛ vlerÛsimit dhe caktoni kriteret e suksesit (kujto planifikimin e orÛs mÛsimore).

NjÛra ndrÛ strategjitÛ pÛr vlerÛsim ÛshtÛ edhe **Rubrika** qÛ mund tÛ pÛrdoret nga vetÛ nxÛnÛsit pÛr matjen e nivelit tÛ arritjes sÛ tyre. Kjo strategji e vlerÛsimit bazohet kryesisht nÛ rezultatet e tÛ nxÛnit tÛ orÛs mÛsimore (plani i orÛs mÛsimor). Arritja e rezultateve demonstron nÛ bazÛ tÛ shkallÛs sÛ pÛrmbushjes sÛ aktiviteteve. Secila shkallÛ e arritjes pÛrcaktohet sipas ngjyrave.

## Dosja (portfolio)

Është një koleksion i qëllimshëm i punimeve të nxënësve, që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në fushën mësimore të caktuar. Këtu përfshihet pjesëmarrja e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriteret e vlerësimit për të dëshmuar për meritat dhe dëshmitë e vetëreflektimit të nxënësit.

Ky lloj i vlerësimit është vlerësim për të nxënë (vlerësim formativ), pasi që për një kohë të gjatë vazhdimisht mblidhen informata për zhvillimin e nxënësit.

Gjithashtu rezultatet duhet të maten në bazë të kërkesës dhe formës së realizimit të tyre. Sugjerohet që të bëhet matja në formë të vazhdueshme sipas dosjes së vlerësimit të nxënësve duke përcaktuar angazhimin me përqindje për secilin element që duhet vlerësuar në lëndën përkatëse.

Shembull një model vlerësimi		
Tek fusha e VP1 marrin vetëm ato instrumente të vlerësimit dhe u japim përqindje sipas dëshirës së mësimdhënësit të lëndës:		
Punë praktike	15%	3
Projekt	15%	5
Vlerësim me test	30%	4
Aktivtete në klasë	20%	5
Angazhime në detyra shtesë	20%	3
Për të nxjerr notën e parë pra VP1 veprim kështu:		
$3 * 0.15 + 5 * 0.15 + 4 * 0.30 + 5 * 0.20 + 3 * 0.20 = 0.45 + 0.75 + 1.20 + 1.0 + 0.60 = 4$ pra nota e parë në ditarë VP1 është 4		
Sqarim: nota e parë VP1 ka instrumente të vlerësimit të vazhdueshëm pra nota nuk duhet të bartet në ditar menjëherë pas 1 muaji apo edhe pas 1.5 muaji, po duhet ta përfshij vlerësimin gati të gjithë periudhës.		
Test përmblidhës	100%	psh nota në këtë vlerësim pra VP2 është 5
Sqarim : pra nota e cila del nga ky vlerësim përshkruhet menjëherë në ditarë dhe vendoset si notë e dytë pra VP2		
Marrim notën e VP1 * 0.60 + VP2 * 0.40 = 4 * 0.60 + 5 * 0.40 = 2.4 + 2.0 = 4.4 ~ 4 pra mbyllet në periudhë nota 4		
Nota e përfundimtare e një lënde mësimore formohet nga mesatarja aritmetike e notave të mbyllura në tri periudhat mësimore.		

VP1 është vlerësim përmblidhës, mësimdhënësi i lëndës i përzgjedh sipas nevojës së lëndës fushat për vlerësim në tabelën e dhënë, pra nga të gjitha fushat në VP1 përzgjedh disa nga instrumentet më të nevojshme.

VP2 është vlerësim përmblidhës, mësimdhënësi përzgjedh vetëm njërin nga instrumentet për vlerësim në fushat e VP2.

## Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësimdhënësve të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mësimore.

Mësimdhënësit, mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies, përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuarra dhe parimeve të KK-së. Përzgjedhja adekuatë e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.

Sot, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për të gjithë nxënësit/et të së njëjtës moshë sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuarra. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit, ***kujto të nxënit duke vepruar!***

Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale ricikluese, si letër, gazeta, pjesë nga pajisjet e vjetra shtëpiake, ambalazhe të ushqimeve, copëza të drurit, litarë, llamarinë, metale... etj., respektivisht me gjëra të cilat mund t'i ketë çdo shtëpi dhe që nuk i përdor më. Gjithashtu, në disa raste mësimdhënësit së bashku me nxënës mund t'i riciklojnë edhe vetë.

Si materiale për klasën e tetë mund të përdoren druri, letra, ngjitësi, plastika, metali, pastaj mjetet e punës duhet të përshtaten moshës së nxënësve dhe të sigurohet forma e parandalimit të rrezikut në punë praktike.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara mësimdhënësi mund të përdorë burime të ndryshme, qoftë elektronike, por edhe të shkruara, si: librat të punës, broshura, atllase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza etj.

Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme didaktike përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

### **Temat në programin lëndor:**

Në klasën VIII tek në temën “Teknologji e Informimit dhe Komunikimit” mund të përdoret programi i Excel ose ndonjë program tjetër që afrohet me kërkesat për llogaritje dhe arritje të rezultateve.

Gjithashtu për përpunimin, modifikimin e fotove dhe krijimin e kolazhit për foto mund të përdoret Photoshop i cili është një program i avancuar për fotografi.

Mund të përdoren dhe programe tjera të cilat mundësojnë arritjen e rezultateve të temës së caktuar, sugjerohet të jenë të hapur pa pagesë që të kenë qasje të lehtë dhe nxënësit dhe të gjithë mësimdhënësit.